



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

RAPORT

PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2015



Prishtinë
Janar 2016

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në bazë të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ”Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli”.

Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

1. Miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme.
2. Vendos ta ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë.
3. Shpall referendum, në pajtim me ligjin.
4. Ratifikon traktate ndërkombëtare.
5. Miraton buxhetin e Republikës së Kosovës.
6. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.
7. Zgjedh dhe mund ta shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën.
8. Zgjedh Qeverinë dhe mund të shprehë mosbesimin ndaj saj.
9. Mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve i raportojnë Kuvendit.
10. Zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në përputhje me Kushtetutën.
11. Propozon gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese.
12. Mbikëqyr politikën e jashtme dhe politikën e sigurisë.
13. Jep pëlqimin për dekretin e Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.
14. Vendos për çështjet e interesit të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.
15. Jep amnisti me ligj perkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputeteve.

PËRBËRJA E KUVENDIT

Sipas nenit 64, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Kuvendi i ka 120 (njëqind e njëzet) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen ndërmjet të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin”.

100 (njëqind) prej 120 vendeve të Kuvendit shpërndahen ndërmjet të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme, që i kanë fituar ata në zgjedhjet për Kuvend.

20 (njëzet) prej 120 vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

10 vende iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që kanë deklaruar vetë se e përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës,
 10 vende u ndahen komuniteteve të tjera, si vijon:

- 4 vende romëve, ashkalinjve dhe komunitetit egjiptian,
- 3 vende komunitetit boshnjak,
- 2 vende komunitetit turk, dhe
- 1 vend komunitetit goran.



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR VITIN 2015, përfshin aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kryesise se Kuvendit, Seanca Plenare, Komisionet Parlamentare), në ushtrimin e funksionit ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.


1. Kryesia e Kuvendit

Kryesia e Kuvendit, në kuadër të kompetencave, në bazë të nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, ka mbajtur 51 mbledhje, me pjesëmarrje edhe të kryetarëve të grupeve parlamentare, në të cilat ka përgatitur rendin e ditës për 52 seanca plenare, ka miratuar 220 vendime, ka nxjerrë 40 përfundime, si dhe është marrë me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, organeve të tij dhe të Administratës së Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit	Nr.
Mbledhje të mbajtura	51
Vendime të miratuara	220
Përfundime të nxjerrura	40

2. Seanca Plenare

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në ushtrimin e funksionit të tij ligjvënës, funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe funksionin përfaqësues, ka mbajtur 52 seanca plenare (prej tyre 2 seanca solemne, 5 seanca të veçanta dhe 5 seanca të jashtëzakonshme).



I. AKTIVITETI LIGJVËNËS

1. Ligjet

• Projektligje të proceduara nga Qeveria	77
• Projektligje të proceduara nga komisionet parlamentare	3
• Projektligje të proceduara nga deputetët	1
• Projektligje të proceduara nga qytetarët	1
• Ligje të miratuara	47
(prej tyre 6 marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj)	
• Projektligje të gatshme për miratim.....	3
(tri (3) Marrëveshje ndërkombëtare, vetëm për votim)	
• Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komisione parlamentare.....	16
• Projektligje që presin për shqyrtim të parë	7
• Projektligje të pa miratuara	4
• Projektligje të tërhequra nga Qeveria	5

2. Miratimi i Amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës Amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në procedurë vetëm për votim)

3. Rezoluta të miratuara 4

4. Vendime të miratuara të seancës plenare 211

5. Rekomandime të miratuara.....6

Aktiviteti ligjvënës i Kuvendit të Kosovës

Projektligje të proceduara nga Qeveria	77
Projektligje të proceduara nga komisionet parlamentare	3
Projektligje të proceduara nga deputetët	1
Projektligje të proceduara nga qytetarët	1
Ligje të miratuara (prej tyre 6 marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj)	47
Projektligje të gatshme për miratim (tre (3) Marrëveshje ndërkombëtare, vetëm për votim)	3
Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komisione parlamentare	16
Projektligje që presin për shqyrtim të parë	7
Projektligje të pa miratuara	4
Projektligje të tërhequra nga Qeveria	5
Miratimi i Amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës Amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në procedurë vetëm për votim)	
Rezoluta të miratuara	4
Vendime të miratuara të seancës plenare	211
Rekomandime të miratuara	6

II. AKTIVITETI MBIKËQYRËS I KUVENDIT

Mbikëqyrje e punës së Qeverisë dhe e zbatimit të Ligjit

1. Pyetjet parlamentare	297
(105 pyetje nuk kanë marrë përgjigje)	
2. Interpelancat e mbajtura	3
3. Debatet parlamentare të zhvilluara	7
4. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve	6
5. Raporte të organeve të pavarura, të miratuara.....	18
6. Raporte të organeve të pavarura, të pa miratuara.....	2

Aktiviteti mbikëqyrës i Kuvendit të Kosovës

Pyetjet parlamentare:	<i>192 kanë marrë përgjigje</i> <i>105 nuk kanë marrë përgjigje</i>	297
Interpelancat e mbajtura		3
Debatet parlamentare të zhvilluara		7
Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve		6
Raporte të organeve të pavarura, të miratuara		18
Raporte të organeve të pavarura, të pa miratuara		2

Ligjet e miratuara:

1. Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2015,
2. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre,
3. Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit,
4. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme,
5. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore,
6. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike,
7. Ligji për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës,
8. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve, FATCA,
9. Ligji për Avokatin e Popullit,
10. Ligji për barazi gjinore,
11. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi,

12. Ligji për përgjimin e telekomunikimeve,
13. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat,
14. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
15. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit,
16. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
17. Ligji për kompensimin e viktimave të krimit,
18. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Kosovës për vitin 2015,
19. Ligji për faljen e borxheve publike,
20. Ligji për tatimin në të ardhurat personale,
21. Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave,
22. Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar,
23. Ligji për armë,
24. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
25. Ligji për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore,
26. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patenta,
27. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare,
28. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar,
29. Ligji për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencialë në proceset gjyqësore në dhomat e specializuara,
30. Ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
31. Ligji për shëndetin mendor,
32. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike,
33. Ligji për letërnjoftimin,
34. Ligji për sigurimet,
35. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës”,
36. Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut mbi Projektin e bashkëpunimit për zhvillim „KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (faza II)“,
37. Ligji për provimin e maturës shtetërore,
38. Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
39. Ligji për rregullimin e shërbimeve të ujit,
40. Ligji për treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës,
41. Ligji për energjinë termike,
42. Ligji për themelimin e Fondit Kosovar për garanci kreditore,
43. Ligji për dizajnin industrial,
44. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr.03/L-221dhe nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194,
45. Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237,
46. Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2016 dhe
47. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115.

Debatet e zhvilluara parlamentare:

1. Migrimi ilegal i qytetarëve të Kosovës,
2. Puna dhe funksionimi i Radiotelevizionit të Kosovës,
3. 100 ditët e Qeverisë Mustafa,
4. Gjendja në arsim në Luginën e Preshevës,
5. Peticioni kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike,
6. Peticioni për zbardhjen e fatit të Ukshin Hoti dhe personave të tjerë të pagjetur,
7. Veprimtaria e misionit të BE në Kosovë dhe skandalet e publikuara në mediet publike vendore.

Interpelancat e mbajtura:

1. Interpelancë me kryeministrin Isa Mustafa për përgjegjësinë kushtetuese të Qeverisë për themelimin e Gjykatës Speciale,
2. Interpelancë me kryeministrin Isa Mustafa për përgjegjësinë për ushtrimin e kompetencave kushtetuese neni 94, paragrafi 1, pika 3 e Kushtetutës së Kosovës,
3. Interpelancë me ministrin e Jashtëm Hashim Thaçi, lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit Kosovë - Mali i Zi.

Rezolutat e miratuara:

1. Rezolutë për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës,
2. Rezolutë lidhur me ndalimin në Lubjanë nga autoritetet shlovene të deputetit të Kosovës, përkatësisht ish-kryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe kryetarit të AAK, z. Ramush Haradinaj,
3. Rezolutë lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi,
4. Rezolutë lidhur me veprimtarinë e Misionit të BE në Republikën e Kosovës.

III. ZGJEDHJA E ANËTARËVE NË ORGANET E PAVARURA

1. Propozimi i tre (3) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese,
2. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
3. Zgjedhja e nëntë (9) anëtarëve të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
4. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
5. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
6. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës,
7. Zgjedhja e katër (4) anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,
8. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim,
9. Formimi i Komisionit për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës,
10. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Bordit të RTK-së,
11. Zgjedhja e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor,
12. Zgjedhja e Kryetarit dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.
13. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,

14. Zgjedhja e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
15. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Fondit të Kursimeve Pensionale,
16. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
17. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit për Energji,
18. Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të Autoritetit për Komunikime Elektronike dhe Postare dhe
19. Zgjedhja e tetë anëtarëve (8) të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

IV. AKTIVITETI PËRMBLEDHËS I KOMISIONEVE PARLAMENTARE

I. Aktiviteti i përmbledhur i komisioneve parlamentare

Nr	Indikatorët	Rezultati
1	Takime të Kryetarit të Kuvendit me kryetaret e komisioneve parlamentare	2
2	Mbledhje të mbajtura të komisioneve parlamentare	417
3	Procesverbale të hartuara	412
4	Amendamente të propozuara në Projektligje	862
5	Amendamente të shqyrtuara nga komisionet e përhershme	2189
6	Projektligje të shqyrtuara dhe të amendamentuara	45
7	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komisione	20 + 4 Marrëveshje Ndërkombëtare
8	Raportet e hartuara me rekomandime për projektligje (në cilësi të komisionit funksional)	65
9	Raportet e hartuara me rekomandime për projektligje (në cilësi të komisionit të përhershëm)	142
10	Numri i grupeve punuese të formuara	84
11	Numri i takimeve të grupeve punuese	171
12	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve	7
13	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve në procedurë	11
14	Shqyrtimi i raporteve vjetore të agjencive të pavarura	24
15	Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituara	75
16	Vizitat jashtë vendit	35
17	Vizitat brenda vendit	101
18	Dëgjime publike	38
19	Peticione të shqyrtuara	9
20	Tryeza të mbajtura	11
21	Raportime të ministrave	62

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Nr.	Indikatorët	Rezultatet
1.	Mbledhje të mbajtura	10
2.	Procesverbale të hartuara	10

3.	Tryeza të mbajtura	1
-----------	--------------------	---

Komisionet ad-hoc

Nr.	Indikatorët	Rezultatet
1.	Mbledhje të mbajtura	8
2.	Kandidatët e propozuar	116
3.	Rekomandimet e komisioneve për seancë	6

V. Aktivitetet sipas komisioneve parlamentare

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Përmbajtja

- I. Përbërja dhe struktura e Komisionit
 - II. Hyrje
 - III. Fushëveprimtaria e Komisionit
 - IV. Aktivitetet e Komisionit
1. Mbledhjet e Komisionit
 2. Shqyrtimi i projektligjeve
 - 2.1. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional
 - 2.1.1. *Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015*
 - 2.1.2. *Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015*
 - 2.1.3. *Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016*
 - 2.2. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit të Përhershëm
 3. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese
 4. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private
 5. Mbajtja e dëgjimeve publike
 6. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
 - 6.1. *Monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës*
 - 6.2. *Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit*
 7. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

8. Raportimi i ministrave dhe udhëheqësve të organizatave buxhetore
 - 8.1. *Raportim nga drejtori i Doganave të Kosovës dhe drejtori i Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015*
 - 8.2. *Informatë nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, në lidhje me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë*
 - 8.3. *Raportim nga Ministria e Financave lidhur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018*
 - 8.4. *Informatë lidhur me marrëveshjen e negociuar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për Programin e ri*
9. Themelimi i Sistemit të Raportimit – caktimi i deputetëve raportues
10. Takim në mes Komisionit dhe Misionit të Asistencës Teknike të FMN-së
11. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit
12. Rezyme e punës së komisionit

I. Përbërja dhe struktura e Komisionit:

1.	Naser Osmani	kryetar	LDK
2.	Safete Hadergjonaj	zëvendëskryetare e parë	PDK
3.	Jelena Bontić	zëvendëskryetare e dytë	LS
4.	Latif Gashi	anëtar	PDK
5.	Labinotë Demi-Murtezi	anëtare	PDK
6.	Besa Gaxherri	anëtare	LDK
7.	Bardhyl Meta	anëtar	LDK
8.	Ilir Deda	anëtar	VV
9.	Bali Muharremaj	anëtar	AAK
10	Fikrim Damka	anëtar	GP 6+
11	Enver Hoti	anëtar	Nisma

II. Hyrje

Raporti i punës për vitin 2015, përmban të dhëna, informacione dhe shënime që pasqyrojnë aktivitetet e komisionit, të realizuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2015¹, në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit dhe Planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2015.

III. Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni për Buxhet e Financa është komision i përhershëm. Kompetencat e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë paraparë në shtojcën nr. 2, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit shqyrton:

- Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
- Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim, që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend;
- Shqyrton raportet periodike të Ministrisë së Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;
- Raporton kohë pas kohe, më iniciativën e vet ose me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje plenare për çështjet nga fushëveprimi i tij;
- Angazhohet për shqyrtimin e programit të Qeverisë, mënyrën dhe nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me financat publike;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe me Qeverinë, që është e detyruar t'i ofrojë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ana e Komisionit, përfshirë edhe raportimet e ministrit dhe të personave të tjerë të autorizuar të Ministrisë;
- Shqyrton legjislacionin në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave;
- Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;
- Shqyrton projektligjet dhe mocionet, përmbajtjesore lidhur me koston buxhetore, si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin e tij;
- Komisioni ushtron edhe veprimtari të tjera, të cilat përcaktohen me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Shqyrton e çështje të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çështjet, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me Ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha Ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

¹ Ne raport janë të përfshirë të dhënat edhe për punën e Komisionit në muajin dhjetor 2014, pas konstituimit të Legjislaturës V.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit në vitin 2015, kanë qenë si në vijim:

1. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, pas konstituimit të Kuvendit në Legjislaturën e pestë, mbledhjen e parë e ka mbajtur më 19.12.2014, ndërkaq në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2015, Komisioni miratoi planin dhe programin e punës për vitin 2015, i cili plan ishte i harmonizuar me strategjinë legislative për vitin 2015.

Komisioni gjatë vitit 2015, ka mbajtur 41 mbledhje, 6 takime tjera të natyrës së punëtorive dhe 3 takime me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare. Gjatë punës së vetë, Komisioni, ka zbatuar rregullat dhe procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit, gjatë kohës së shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve, shqyrtimit të çështjeve të parashtruara para komisionit, po ashtu edhe gjatë hartimit të raporteve dhe rekomandimeve për Kuvendin. Në këtë drejtim, Komisioni ka realizuar edhe këto aktivitete:

- Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve dhe çështjeve tjera me interes;
- Aktivizimi i grupit punues në shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;
- Themelimi i sistemit të raportimit – caktimi i deputetëve raportues dhe mbajtja e dëgjimeve buxhetore me Ministrinë e resorit përkatës;
- Shqyrtimi i projektligjeve dhe raporteve me amendamente të komisioneve tjera funksionale, në aspekt të vlerësimit të ndikimit buxhetor të tyre;
- Monitorimi i zbatimit të implementimit të rekomandimeve për Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
- Organizimi i takimeve me Doganat e Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave buxhetore për vitin 2015;
- Informatë nga guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë, sipas kërkesës së komisionit;
- Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018 dhe nxjerrja e rekomandimeve për Ministrinë e Financave;
- Dhënia e rekomandimeve dhe mendimeve komisioneve tjera;
- Dhënia e rekomandimeve, përfundimeve dhe njoftimeve për institucionet dhe organizatat e caktuara buxhetore;
- Hartimi i raporteve me rekomandime, njoftimeve për Kryesinë dhe Kuvendin.

Në Komision ka mbizotëruar një frymë kolegjiale, është punuar me seriozitet dhe profesionalizëm, ku për çështje me rëndësi dhe përmbajtjesore ka pasur konsensus në marrjen e vendimeve. Me ftesë të Komisionit, në takime kanë prezantuar përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, përfaqësues të autorizuar të institucioneve), të agjencive dhe institucioneve të pavarura dhe përfaqësues të organizatave tjera buxhetore. Për të qenë sa më efektiv në punën e tij, Komisioni gjatë vitit 2015, ka formuar 9 grupe punuese, nga një grup për secilën çështje të parashtruar për shqyrtim. Numri i takimeve të grupeve punuese ishin 18. Komisioni me mbështetjen e Projektit për Reformën e Sistemit të Financave Publike në Kosovë - GIZ, themeloi sistemin e raportimit – caktimi i deputetëve raportues për sektorët e caktuar, të cilët gjatë fazës së shqyrtimit të Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016, ka organizuar 6 dëgjime buxhetore me Ministrinë e

resorit përkatës.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e Komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e USAID-it, Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, OSBE-së, NDI-së, KDI-së, organizata të shoqërisë civile, asociacione dhe organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, puna e Komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe elektronike.

2. Shqyrtimi i projektligjeve

2.1. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional

Në cilësinë e Komisionit Funkcional, komisioni ka shqyrtuar 10 projektligje², për të cilat ka hartuar raportet me rekomandime dhe ka propozuar 354 amendamente. Po ashtu, Komisioni ka shqyrtuar 1 projektligj në parim, për të cilat ka hartuar raportet me rekomandime për Kuvend. Projektligjet e shqyrtuara, në cilësinë e Komisionit Funkcional, janë si në vijim:

- *Projektligji nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.*
- *Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale.*
- *Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.*
- *Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.*
- *Projektligji për Faljen e Borxheve Publike.*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare (Komisioni ka shqyrtuar projektligjin në parim dhe i njëjti është miratuar në lexim të parë në Kuvend dhe është në procedurë të shqyrtimit në Komision).*
- *Projektligji nr.05/L-045 për Sigurimet.*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194;*
- *Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237.*
- *Projektligji nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.*

Komisioni ka shqyrtuar 8 Projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ka hartuar raportet me rekomandime për Kuvendin, si në vijim:

- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Reformën Shëndetësore.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtërishme.*

²Në numrin e përgjithshëm të Projektligjeve është përfshirë edhe Projektligji nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: “KSV/018, mbështetje institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës”.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: “KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (faza II)”.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë.*
- ◆ *Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për Financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.*

2.1.1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, e ka shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. Komisioni ka mbajtur katër takime, në të cilat kanë marrë pjesë ministri i Financave dhe përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, të cilët janë përgjigjur dhe kanë ofruar sqarimet e nevojshme në pyetjet e anëtarëve të komisionit. Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin, kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore dhe amendamentet e propozuara nga deputetët, grupet parlamentare dhe komisionet funksionale, që i janë dërguar Komisionit.

Në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2014, Komisioni ka miratuar Raportin final me amendamente për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, dhe raportin me amendamente e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Mbështetje profesionale dhe teknike gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, Komisionit i është ofruara nga stafi i Njësisë mbështetëse të Komisionit dhe stafi i Projektit-GIZ.

2.2.2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, ka caktuar një grup punues. Grupi Punues ka mbajtur një takim më datën 13.7.2015, në të cilin ka marrë pjesë Ministri i Financave, zëvendësministri i Financave dhe përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, të cilët janë përgjigjur dhe kanë ofruar sqarimet e nevojshme në pyetjet e anëtarëve të komisionit. Grupi punues

ka shqyrtuar Projektligjin, kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore dhe amendamentet e dorëzuara, dhe ka hartuar raportin me amendamente për Komisionin.

Në mbledhjen e mbajtur më 14.07.2015, Komisioni ka miratuar amendamentet e propozuara nga grupi punues me disa ndryshime, ndërkaq, Komisioni nuk ka përkrahur amendamentet e propozuara nga deputetët dhe grupi parlamentar. Ndërkaq, në mbledhjen e mbajtur më 15.7.2015, Komisioni miratoi raportin përfundimtar me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2015, dhe të njëjtin e procedoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Mbështetje profesionale dhe teknike gjatë shqyrtimit të Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2015, Komisionit i është ofruar nga stafi i Njësisë mbështetëse të Komisionit. Komisioni gjatë kësaj faze kishte mbështetjen nga një ekspert të jashtëm, i angazhuar nga GIZ-i, i cila ka përgatitur një analizë për anëtarët e Komisionit, lidhur me dokumentin e Rishikimit e Buxhetit 2015, krahasimet me Buxhetin 2015 të miratuar dhe me planin e realizimit të të hyrave, si dhe ndërlidhjen me draft marrëveshjen e Qeverisë me FMN-në dhe ndikimeve të obligimeve të marrëveshjes në proceset buxhetore në vazhdim.

2.2.3 Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në disa mbledhje të mbajtura, ka shqyrtuar pjesën tekstuale të projektligjit dhe pjesën tabelore të Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016, kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore, si dhe amendamentet, që i janë dërguar komisionit, para përfundimit të punës së tij. Komisioni gjithsej ka shqyrtuar 64 kërkesa buxhetore, prej të cilave 12 të institucioneve dhe agjencive të pavarura, 17 të institucioneve qendrore apo ministrive (përfshirë 4 kërkesa të ndërmarrjeve publike), 21 të komunave, 5 kërkesa të parashtruara nga deputetët dhe 1 kërkesë nga Grupi Parlamentar 6+. Po ashtu, janë shqyrtuar edhe 5 amendamente, nga të cilat 3 të amendamente të propozuara nga Komisioni parlamentar për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, 1 amendament të Grupit 6+, 1 amendament të grupit të disa deputetëve dhe 1, të deputetit Qerim Bajrami.

Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit të buxhetit, ka aplikuar sistemin e raportimit përmes deputetëve raportues, të cilët kanë organizuar pesë dëgjime buxhetore me ministrinë e resorit përkatës, që janë ndër shpenzuesit më të mëdhenj të buxhetit. Në mbledhjet e komisionit, ka marrë pjesë ministri i financave, zëvendësministri i financave dhe përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, të cilët janë përgjigjur dhe kanë ofruar sqarimet e nevojshme në pyetjet e anëtarëve të komisionit.

Në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2015, Komisioni miratoi raportin përfundimtar me amendamente për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2016 dhe Kuvendit i procedoi për miratim 56 amendamente, të cilat u miratuan në Seancën Plenare, së bashku me Projektligjin.

Mbështetje profesionale dhe teknike të shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Komisionit i është ofruar nga stafi i Njësisë mbështetëse të Komisionit. Po ashtu mbështetje profesionale në procesin buxhetor, Komisionit i është ofruar edhe nga Projekti GIZ, përmes angazhimit të ekspertëve, analizave të përgatitura dhe prezantimit të tyre para anëtarëve të Komisionit, analizave specifike për dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, të disa Projektligjeve në fushën e financave publike, të ndërlidhura me procesin buxhetor, si dhe në fazën e organizimit të dëgjimeve buxhetore për vitin 2016, në kuadër të sistemit të raportimit.

2.2. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit të Përhershëm

Në cilësinë e Komisionit të Përhershëm, Komisioni ka shqyrtuar 31 projektligje, për të cilat ka hartuar raportet me rekomandime për komisionet funksionale dhe për Kuvendin.

3. Shqyrtimi i raporteve vjetore dhe financiare të institucioneve dhe agjencive raportuese

Me qëllim të përmbushjes së detyrave të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, Komisioni, gjatë punës së tij, ka shqyrtuar raportet vjetore të punës dhe raporte vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive raportuese për vitin 2014. Gjithsej janë shqyrtuar 4 raporte vjetore të punës dhe 16 raporte vjetore financiare, 1 raport vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës, 4 raporte financiare të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës dhe atë si në vijim:

- *Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014.*
- *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2015.*
- *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.*
- *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2015.*

Komisioni lidhur me këto raporte nxori rekomandime, të cilat ishin objekt shqyrtimi dhe votimi në Kuvend, respektivisht në Kryesinë e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Gjatë periudhës raportues, Komisionit ka shqyrtuar kërkesa, propozim-vendime, për të cilat ka nxjerr rekomandime për Kuvendin, përkatësisht Kryesinë e Kuvendit dhe institucioneve parashtruese të kërkesave. Ndër rekomandimet e rëndësishme të Komisionit, drejtuar Kuvendit dhe/apo Kryesisë së Kuvendit, ishin:

- *Rekomandimi lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar nga data 1.1.2015 deri më 31.12.2015.*
- *Rekomandim lidhur me Propozimin e Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e dy pozitave për anëtarë joekzekutiv të Bordit të BQK-së.*
- *Rekomandim lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2016-2018.*
- *Rekomandim lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2016/01.*
- *Rekomandim lidhur me kërkesat e Kuvendit të Kosovës për rishikimin e buxhetit për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me kërkesën për transferin e mjeteve nga Buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në Buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2015.*
- *Përfundim lidhur me Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e normave të tatimit të akcizës, dt. 24.3.2015.*
- *Rekomandim lidhur me Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me Buxhetin e Komunës së veriut të Mitrovicës, për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me Buxhetin e Komunës së Leposaviqit për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me Buxhetin e Komunës së Zubin Potokut për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me Buxhetin e Komunës së Zveçanit për vitin 2015.*
- *Raport me rekomandime lidhur me Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të Energjisë Elektrike.*
- *Kërkesat Buxhetore të Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura, institucioneve qendrore, institucioneve lokale, deputetëve, grupeve parlamentare lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.*
- *Rekomandim lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018 (rekomandimi i është dërguar Ministrisë së Financave).*
- *Përfundim lidhur me Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e normave të tatimit të akcizës, dt. 22.7.2015.*
- *Rekomandim lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe dy anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimi Publik.*
- *Përfundim lidhur me Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e normave të tatimit të akcizës, dt. 25.9.2015.*
- *Rekomandim lidhur me Propozimin e Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së.*

- *Shqyrtimi i Propozimeve të Komisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.*
- *Kërkesat Buxhetore të Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura, institucioneve qendrore, institucioneve lokale, deputetëve, grupeve parlamentare, lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.*
- *Përfundim lidhur me Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e normave të tatimit të akcizës në duhan, dt. 16.12.2015.*

5. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni nuk ka organizuar ndonjë dëgjim publik për Projektligje.

6. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

6.1. Monitorimi e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 27.2.2015, në pajtim me Planin e punës së Komisionit për vitin 2015, ka caktuar grupin punues për të bërë monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Grupi Punues në pajtim me planin e veprimit, ka komunikuar me institucionet përgjegjëse të cilave i janë adresuar rekomandimet, siç janë: Kryeministria, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe ka arritur të mbledh informata dhe të dhëna të mjaftueshme mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit për Ligjin nr. 04/L-042 për e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Bazuar në informatat dhe të dhënat e grumbulluara, duke pasur parasysh faktin se shumica e rekomandimeve, kanë të bëjnë me nevojën për rregullimin e çështjeve të caktuara, përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit, Grupi Punues, ka vlerësuar dhe i ka rekomanduar Komisionit, që të pres procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik, për të parë përfshirjen e rekomandimeve nga Qeveria, në draft-ligjin e ri, që do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Komisioni ka miratuar rekomandimet e grupit punues. Gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237, Komisioni ka vlerësuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve nga procesi i monitorimit, janë marrë parasysh nga qeveria.

6.2. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit

Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve të përcaktuar me nenin 73 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe në pajtim me planin vjetor të punës, kishte vendosur të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit. Për këtë qëllim, komisioni formoi një grup punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte angazhuar në mbikëqyrjen e këtij ligji. Grupi Punues, ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit, në të cilin janë përcaktuar aktivitetet, institucionet që do të vizitoheshin dhe afatet kohore për realizimin e këtyre vizitave. Grupi Punues, ka vendosur që aktivitetet në kuadër të procesit të mbikëqyrjes ti vazhdojë në vitin 2016.

7. Vizitat brenda vendit dhe jashtë vendit

Komisioni nuk ka realizuar ndonjë vizitë brenda dhe jashtë vendit.

8. Raportimi i ministrave dhe udhëheqësve të organizatave buxhetore

Numri i përgjithshëm i ministrave/zv.ministrave, udhëheqësve të institucioneve dhe/apo agjencive të pavarura dhe institucioneve tjera që kanë raportuar në Komision ishte 53. Në kuadër të kësaj, në mbledhjet e Komisionit për të dhënë arsytetime në çështjet që kanë qenë objekt shqyrtimi nga Komisioni, ka raportuar ministri i financave, zëvendësministri i financave dhe përfaqësues të organizatave buxhetore, respektivisht të institucioneve dhe agjencive të pavarura. Ministri i Financave ka raportuar 17 herë në komision, ndërsa zëvendësministri i financave 7 herë; ministrat tjerë kanë raportuar 5 herë në komision. Përveç, ministrave dhe zëvendësministrave, në komision kanë raportuar udhëheqësit e institucioneve dhe/apo agjencive të pavarura, dhe atë 22 herë, me rastin e arsytimeve të raporteve vjetore dhe financiare të institucioneve dhe/apo agjencive që udhëheqin për vitin paraprak dhe për çështjet tjera sipas kërkesës së komisionit. Po ashtu, në Komision ka raportuar 1 herë drejtori i Doganave të Kosovës dhe 1 herë drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, kurse me kërkesë të Komisionit, Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, ka informuar Komisionin në lidhje me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë.

8.1. Raportim i drejtorit të Doganave të Kosovës dhe drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015

Në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 13.5.2015, ka raportuar drejtori i Doganave dhe drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës. Ata kanë raportuar në lidhje me realizimin e planit të të hyrave të këtyre institucioneve për tremujorin e parë të vitit 2015. Përfaqësuesit e Doganave dhe ATK-së, informuan për trendët në realizimin e të hyrave, masat që janë marrë dhe sfidat në të ardhmen. Në përgatitjen e takimeve me Doganat dhe ATK-në, mbështetje profesionale dhe teknike, Komisionit i është ofruar nga stafi i Njesisë mbështetëse dhe Projekti i GIZ-it.

8.2. Informatë nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, në lidhje me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë

Në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 20.5.2015, Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës ka informuar Komisionin në lidhje me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë. Guvernatori njoftoi për gjendjen aktuale të Kosovës, vështirësitë dhe përpjekjet institucionale, në relacion me anëtarësimin në Byronë për Kartonin e Gjellbër në Bruksel. Guvernatori po ashtu informoi komisionin për angazhimin e Byrosë Kosovare për zbritjen e taksës kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë dhe me zotimin e BQK-së për miratimin e propozimet eventuale të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, për zbritjen e taksës kufitare.

8.3. Raportim nga Ministri i Financave lidhur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018

Me kërkesë të Komisionit, në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 17.6.2015, ministri i Financave raportoi dhe dha sqarime për anëtarët e Komisionit, lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018. Pas diskutimeve dhe çështjeve të ngritura, Komisioni vendosi që Ministrisë së Financave, ti dërgojë rekomandimet konkrete me shkrim, që të merren parasysh, me rastin e përgatitjes së Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019. Projekti i GIZ-it për nevojat e Komisionit ka angazhuar një ekspert të jashtëm, i cili ka prezantuar ekspertizën para anëtarëve të Komisionit, lidhur

me përmbajtjen e KASH-it 2016-2018, përparësitë dhe mangësitë e dokumentit, dhe i njëjti ka ndihmuar në hartimin e rekomandimeve që Komisioni i ka dërguar me shkrim Ministrisë së Financave.

8.4. Informatë lidhur me marrëveshjen e negociuar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për Programin e ri

Në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 8.7.2015, Ministria e Financave dhe Përfaqësues i Përhershëm i Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë, informuan Komisionin lidhur me pajtueshmërinë për marrëveshjen në mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, për Programin e ri 22 mujor. Anëtarët e Komisionit u njoftuan për kushtet dhe kërkesat, obligimet dhe përgjegjësitë institucionale-shtetërore dhe benefitet, që dalin nga ky program.

9. Themelimi i Sistemit të Raportimit – caktimi i deputetëve raportues

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2015, vendosi të krijojë sistemin e raportimit, përmes emërimit të deputetëve raportues në sektorë të caktuar për organizatat e ndryshme buxhetore, në mënyrë që procesi i shqyrtimit dhe mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit të jetë më i efektshëm. Detyrat e raportuesve janë prezantimi i draft buxheteve të secilës organizatë buxhetore në Komision. Këtu përfshihet prezantimi i përgjithshëm i sektorit: zhvillimi buxhetor gjatë viteve të fundit, planifikimi vjetor dhe afatmesëm i buxhetit, si dhe mbikëqyrjen e implementimit të buxhetit. Komisioni caktoi 10 deputetë raportues, përgjegjës për raportim për sektorë të caktuar, respektivisht për organizatat e caktuara buxhetore. Gjatë fazës së shqyrtimit të buxhetit, raportuesit kanë organizuar *5 dëgjime buxhetore*, me Ministrinë e resorit përkatës, që janë ndër shpenzuesit më të mëdhenj të buxhetit. Një sistemi i tillë i punës së monitorimit buxhetit, është menduar që të vazhdojë të aplikohet nga Komisioni me qëllim të monitorimit të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2016.

Mbështetje profesionale dhe teknike, në procesin e themelimit të sistemit të raportimit, ka ofruar Projekti GIZ. Në këtë aspekt, me qëllim të funksionalizimit dhe angazhimit të deputetëve raportues, me mbështetjen e Projektit GIZ është angazhuar një ekspert i jashtëm, që e ndihmoi Komisionin në procesin e formulimit të koncept idesë së themelimit të sistemit të raportimit bazuar edhe në përvojat e ngjashme të një sistemi të tillë që aplikohet në Komisionin për Buxhet të Parlamentit të Bavarisë. Po ashtu, me mbështetjen e GIZ-it, raportuesit e caktuar, patën mbështetjen e asistentëve hulumtues që përgatitjen analizat për rrjedhën e buxhetit të Ministrive të caktuara, që ndihmuan raportuesit në procesin e organizimit të dëgjimeve buxhetore me Ministrinë e resorit përkatës.

10. Takim në mes Komisionit dhe Misionit të Asistencës Teknike të FMN-së

Komisioni me 24.11.2015, zhvilloi një takim me një delegacion të Misionit të Asistencës Teknike të FMN-së. Në këtë takim u diskutua për koncept-idenë për bashkimin e funksioneve të Doganave të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës. Bashkëbiseduesit u pajtuan në parim me idenë për bashkimin e funksioneve të përbashkëta të të dy agjencive të mbledhjes së të hyrave, që do të ndihmojë në efikasitetin e të hyrave dhe luftimin e evazionit fiskal. Gjithashtu u potencua se fuzionimi i funksioneve të përbashkëta të këtyre dy administratave duhet të bëhet hap pas hapi, me një rregullim të qartë ligjor të përgjegjësive dhe kompetencave të reja, duke shmangur mundësitë e kolizionit me legjislacionin në fuqi, si dhe duke pasur kujdes edhe për funksionet që nuk duhet të barten, pra të mbesin nën kompetencën e pavarur të të dy agjencive. Një sfidë e veçantë që duhet të trajtohet është nevoja për trajnimin e zyrtarëve për detyrat dhe përgjegjësitë e reja, që do të dalin nga

ky proces i riorganizimit të ri.

11. Takimet e kryetari të Komisionit

Mbledhje konsultative dhe aktivitete të tjera të kryetarit të Komisionit, të ndërlidhura me kompetencat e tij dhe të Komisionit:

- Takim në mes zëvendëskryetares së parë të Komisionit, dhe Shefit të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën Mr. Jacques Miniane dhe stafit shoqërues të misionit të FMN-së. Temë diskutimi: Buxheti dhe realizimi i të hyrave për vitin 2015.
- Pjesëmarrja dhe kontributi i anëtares së Komisionit, znj. Besa Gaxherri në Konferencën e nivelit të lartë në Transparencën Buxhetore, organizuar nga GIZ-i.
- Takimi me Ambasadorën e Zvicrës në Prishtinë, znj. Krystyna Marty Lang dhe zëvendës drejtorin e Swisscontact. Temë diskutimi: Bashkëpunimi në mes Ambasadës dhe Komisionit.
- Takim i përbashkët në mes ekspertëve të misionit të SIGMA/Departamenti për Zgjerim i Komisionit Evropian dhe kryetareve dhe zëvendëskryetarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Temë diskutimi: Monitorimi i funksionimit të sistemit të financave publike në Kosovë dhe roli dhe përgjegjësitë e Kuvendit, respektivisht të Komisionit për Buxhet dhe Financa në këtë aspekt.
- Takim në mes kryetarit të Komisionit, me përfaqësues të Zyrës së NDI-së në Kosovë. Temë diskutimi: Përfshirja e komisioneve funksionale në shqyrtimin e buxhetit dhe raportin e shpenzimeve në fushën që mbulojnë dhe njoftimi lidhur me iniciativën për themelimin e Njësisë për analiza buxhetore dhe financiare.
- Takim në mes kryetarit të Komisionit dhe Shefit të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën Mr. Jacques Miniane dhe stafit shoqërues të misionit të FMN-së. Temë diskutimi: Diskutimi i politikave fiskale: buxheti dhe të hyrat për vitin 2015 dhe marrëveshja e mundshme në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.
- Pjesëmarrja e kryetarit të Komisionit z. Naser Osmani, në takimin e përbashkët me Kryetarin e Kuvendit, Shefit të Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Samuel Zhbogar dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, kryetaret e Komisioneve parlamentare dhe shefat e grupeve parlamentare. Temë diskutimi: Shqyrtimi i projekteve të Kuvendit lidhur me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.
- Takim në mes Kryetarit të Komisionit, me përfaqësues të Ekipit të PEFA-s. Temë diskutimi: Vlerësimi i jashtëm i Financave Publike, për periudhën 2012-2014, për Qeverinë e Kosovës, i iniciuar dhe financuar nga Bashkimi Evropian dhe ofrimi i informatave dhe inputeve nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me këtë proces.
- Takim në mes Kryetarit të Komisionit dhe Shefit të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Mr. Jacques Miniane dhe stafit shoqërues të misionit të FMN-së. Temë diskutimi: Diskutimi i politikave fiskale: buxheti dhe të hyrat për vitin 2015 dhe marrëveshja e mundshme në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.
- Takim në mes kryetarit të Komisionit, zëvendëskryetares së parë, me z. Johan Ketelers dhe Alket Gradeci, Drejtor Ekzekutiv i Institucionit Mikrofinanciar KEP Trust. Temë diskutimi: Draft Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, iniciuar për hartim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.
- Takim në mes kryetarit të Komisionit dhe përfaqësuesve të Programit për Përmbarrim dhe Legjislacion Komercial në Kosovë i USAID, si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Temë

diskutimi: Buxhetit për themelimin e Qendrave të ndërmjetësimit nëpër Gjykatat themelore të Kosovës.

•

12. Rezyme e punës së komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhje të mbajtura ³	41
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	225
3.	Procesverbale të hartuara	41
4.	Projektligje ⁴ të shqyrtuara dhe amendamentuara (në cilësi të Komisionit FunkSIONAL)	10
5.	Projektligje të shqyrtuar në parim (në cilësi të Komisionit FunkSIONAL)	1
6.	Projektligje për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare	8
7.	Projektligje të shqyrtuara (në cilësi të komisionit të përhershëm)	31
8.	Numri i amendamente të propozuara	354
9.	Numri i amendamente të shqyrtuara	452
10.	Numri i raporteve tjera të hartuara për projektligje (në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL) për miratim në parim në Kuvend	11
11.	Numri i raporteve tjera të hartuara për projektligje (në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL) për komisionet e përhershme	10
12.	Numri final i raporteve të hartuara për projektligje (në cilësi të Komisionit FunkSIONAL) për miratim në Kuvend	10
13.	Numri i Raporteve me rekomandime për Projektligjet për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare	8
14.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje (në cilësi të Komisionit të Përhershëm)	31
15.	Numri i grupeve punuese të formuara	9
16.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	18
17.	Sistemi i Raportimit – caktimi i deputetëve raportues	10
18.	Takimet e deputetëve raportues	5
19.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	2
20.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve dhe agjencive të pavarura	4
21.	Shqyrtimi i raporteve vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura	16
22.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	91
23.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	19
24.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	-
25.	Vizitat e realizuara brenda vendit	-
26.	Dëgjime publike	-
27.	Monitorimi i ligjeve (monitorimi i zbatimit të implementimit të rekomandimeve të Komisionit për Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës)	1
28.	Raportimi i ministrave dhe/apo zëvendësministrave në Komision	29

³Përfshirë katër mbledhje të mbajtura në muajin dhjetor 2014.

⁴ Përfshirë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 (që është miratuar në fund të muajit dhjetor 2014).

29.	Raportimi i udhëheqësve të institucioneve dhe/apo agjencive të pavarura në Komision	21
30.	Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës	1
31.	Raportim nga ministri e Financave lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018	1
32.	Raportim nga drejtori i Doganave të Kosovës për realizimin e planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015	1
33.	Raportim nga Administrata Tatimore e Kosovës për realizimin e planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015	1
34.	Informatë nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës në lidhje me taksën kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë	1
35.	Shqyrtimi i raporteve financiare, kërkesave buxhetore të Administratës së Kuvendit të Kosovës dhe raportimi për Kryesinë e Kuvendit	7
36.	Raporte me rekomandime për zgjedhjen e anëtarëve të bordit të institucioneve dhe agjencive të pavarura	4
37.	Rekomandime, njoftime dhe përfundime për Kryesinë e Kuvendit sipas përfundimit të Kryesisë	1
38.	Mbledhje të përbashkëta me komisionet tjera parlamentare	-
39.	Takime tjera të mbajtura nga Komisioni	6
40.	Takim me institucione ndërkombëtare	3

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Përmbajtja:

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushveprimi i Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit
- IV. Strategjia legislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015
- V. Shqyrtimi i projektligjeve
- VI. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
 - A. Seancat Dëgjimore mbikqyrëse
 - A.a) Mbikqyrja e Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit
 - A.b) Mbikqyrja e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës
 - B. Vizita e grupit punues në terren
 - C. Takimet punuese dhe raportimi i mistrave
- VII. Organizatat e ndryshme për mbështetjen e punës së Komisionit
- VIII. Rezyme e punës

Tabela A - Pasqyrë e përgjithshme e punës së Komisionit në periudhën janar-dhjetor 2015.

Përbërja dhe struktura Komisionit:

1. Jasmina Živković,	kryetare	(GP – LS , komuniteti serb)
2. Agim Çeku,	nënkryetar i parë	(GP –PDK, komuniteti shqiptar)
3. Mufera Sinik,	nënkryetare e dytë	(GP 6+, komuniteti turk),
4. Agim Kikaj,	anëtar	(GP – LDK, komuniteti shqiptar),
5. Fisnik Ismaili,	anëtar	(GP – VV, komuniteti shqiptar),
6. Rrustem Berisha,	anëtar	(GP AAK , komuniteti shqiptar),
7. Milka Vuletić,	anëtare	(G P– LS, komuniteti serb),
8. Slavko Simić,	anëtar	(G P– LS, komuniteti serb),
9. Saša Milosavlječić,	anëtar	(GP – LS, komuniteti serb),
10. Ćerim Bajrami,	anëtar	(PG 6+, komuniteti boshnjak),
11. Veton Berisha,	anëtar	(GP – LDK. komuniteti egjiptian),
12. Danush Ademi,	anëtar	(PG 6+, komuniteti ashkali).

I. Hyrje

Me qëllim të prezantimit të punës një vjeçare, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka hartuar raportin e punës së tij, i cili përmban të dhëna dhe informata të cilat paraqesin punën e kryer në periudhën janar – dhjetor 2015.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Fushëveprimi i punës së Komisionit për të Drejtat, Interesat e komuniteteve dhe kthim është përcaktuar me shtojcën nr. 2. pika 2 të Rregullores së punës së Kuvendit, e cila është në fuqi.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim si komision i përhershëm, në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësive që i ka, shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Fushëveprimi i punës së komisionit përfshinë:

- Shqyrtimin e projektligjeve nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve,
- Të drejtë për të vendosur me shumicën e votave dhe anëtarëve të tij lidhur me projektligjet, me qëllim të adresimit adekuat dhe të drejtë të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Deklarimi i tillë mund ti drejtohet edhe komisionit përkatës funksional të Kuvendit ose Kuvendit, sipas rastit,

- Të drejtën për të propozuar projektligje dhe masa të ngjashme, në kuadër të përgjegjësisë të Kuvendit, kurdo që e konsideron të nevojshme që të trajtojnë problemet e komuniteteve,
- Të drejtën që me kërkesë të një anëtarit të Kryesisë së Kuvendit që çdo projektligj të dërgohet për shqyrtim në Komisionin për të Drejtat, interesat e komuniteteve dhe Kthim me shumicën e votave, vendosë dhe paraqet amendamente në projektligjeve;
- Dhënien e mendimeve këshillimore, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, një komisioni, ose një grupi të përbërë nga së paku dhjet (10) deputet të Kuvendit, lidhur me ndonjë çështje.

III. Aktivitetet e Komisionit

Seanca e parë e komisionit është mbajtur më 26 dhjetor 2014. Në muajin janar, Komisioni ka hartuar planin e punës për vitin vijues, në bazë të së cilit ka zhvilluar aktivitetet e veta, e që ka rezultuar me shumë seanca të rëndësishme të mbajtura dhe me rezultate të arritura. Me qëllim të vlerësimit të punës dhe të planifikimit të sajë për gjysmë vjetorin e dytë të vitit, komisioni herë pas here ka analizuar planin e tij.

Gjatë kryerjes së detyrave të planifikuara, komisioni ka zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e punës së Kuvendit, gjatë ndryshimeve dhe plotësimeve të projektligjeve, si dhe gjatë hartimit të raporteve me rekomandime për Kuvend dhe në këtë aspekt ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- shqyrtimi i projektligjit dhe raportit me amendamente të komisioneve funksionale,
- dhënien e mendimeve dhe qëndrimeve për komisionet tjera,
- hartimin e raporteve me rekomandime për Kuvend,
- mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në funksion të mbrojtjes dhe realizimit të drejtave dhe interesave të komuniteteve,
- mbajtjet e takimeve konsultative,
- takime me institucionet lokale,
- bashkëpunim me Qeverinë, OSBE-në, KKK-në, Ambasadën Amerikane.
- bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile: ECMI (Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë); YIHK -Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut; OHCHR - Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe NDI-Instituti Nacional Demokratik.

Pjesëmarrja e deputetëve në punën e komisionit ka qenë në nivel të kënaqshëm, gjë që tregon se punës i është qasur në mënyrë shumë profesionale dhe serioze në të cilën ka dominuar një atmosferë kolegjiale. Për çështje të rëndësishme vendimet janë nxjerrë unanimisht me konsensus.

Me ftesë të Komisionit, në punën e tij kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontributin e tyre përfaqësuesit e ministrive e linjes.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë të hapura për publikun. Gjithashtu, puna e Komisionit është prezentuar në formë elektronike në web faqe të Kuvendit. .

IV. Strategjia legislative e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2015

Strategjia ligjdhënëse e Qeverisë nuk parasheh asnjë ligj për shqyrtim, në cilësinë e Komisionit funksional. Komisioni shqyrton dhe i procedon të gjitha ligjet, në cilësinë e Komisionit funksional nga aspekti i mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve të strategjisë, Komisioni ka për kompetencë që periodikisht të kontrollojë planin e vetë të punës dhe aktivitetet dhe të njëjtat t'i harmonizojë me kërkesat dhe nevojat.

V. Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni shqyrton dhe procedon të gjitha projektligjet në cilësinë e Komisionit të përhershëm, nga aspekti i mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Komisioni në cilësi të komisionit të përhershëm ka shqyrtuar 41 projektligje, për të cilat ka hartuar raportet me rekomandime dhe të njëjtat i ka proceduar për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

VI. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Nga fushëveprimi i kompetencave dhe përgjegjësi të veta, Komisioni është i autorizuar të bëjë mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve nga ana e Qeverisë, përkatësisht ministrive në mënyrën e sigurimit të transparencës, barazisë, mundësi të barabarta dhe ndarjes së barabartë të buxhetit për të gjitha komunitetet (neni 73 i Rregullores për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës).

Në këtë kontekst, Komisioni realizon bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Komunitetet dhe Kthim, me ministrinë relevante, Zyrën për çështje të Komuniteteve pran Kryeministrisë dhe përfaqësuesit e tij kompetentë, duke i ftuar të njëjtit për pjesëmarrje në mbledhjet e veta dhe vizitat në teren, për ofrimin e informatave të nevojshme, mendimeve, sugjerimeve për çështjet në rend dite, në funksion të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të Komuniteteve.

Mbikëqyrja do të bazohet në Planin akcional të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet Evropian (Çështje që dalin nga ligjet e që janë të lidhura me të drejta dhe interesat e Komuniteteve dhe mbrojtjen e tyre).

Gjithashtu, bazohet në të dhënat nga dëgjimet e institucioneve relevante, si dhe nga vizitat në terren.

Komisioni, formoi grupet punuese në mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve:

1. Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe
2. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit
3. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (posaçërisht neni 11)
4. Ligji për Vetëqverisje lokale
5. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrja buxhetore).

A. Seanca Dëgjimore mbikëqyrëse

Komisioni Parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka organizuar Dëgjime Publik dhe takime të rregullta konsultative, me zëvendësministrin e Ministrisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetarin e KK Prizren, kryetarin e KK Rahovec, drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm të KK Prizren dhe të KK Rrahovec, kryetarin e

Këshillit për Trashëgimin Kulturore të Prizrenit, kryetarin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ambasadës Zvicrane.

Në kuadër të procesit mbikqyrës, Komisioni në bashkëpunim me OSBE-në , ka organizuar dy Dëgjime Publike :

1. Ligji Nr. 04/L-062 për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit,
2. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

a.a) Mbikqyrja e Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në kuadër të përgjegjësiave për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit, mori vendim të fillojë mbikqyrjen e këtyre ligjeve, për arsye të ngjashmërisë së tyre dhe kompatibilitetit në drejtim të qëllimeve dhe rëndësisë së shumëfishtë për trashëgiminë kulturore, fetare dhe historike, ngase të dy ligjet mundësojnë dhe garantojnë të drejtat e komuniteteve, ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit kolektiv, përmes formimit të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike në Prizren dhe të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe, si mekanizëm i ruajtjes, mbikqyrjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Komisioni kishte për qëllim që përmes mbikqyrjes së Ligjit nr. 04/L-062 për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike në Prizren, të identifikojë mundësinë e aplikimit të tyre në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, si dhe në fushën e planifikimit rural, të definuar si zonë e mbrojtur e veçantë, me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i mbikqyrjes për zbatimin e Ligjeve është vlerësimi i zbatimit në praktikë të këtyre Ligjeve dhe sigurimi i të dhënave të mjaftueshme lidhur me problemet gjatë zbatimit të ligjit, duke u bazuar në vizita në terren dhe të dhënat e institucioneve relevante, të siguruara gjatë debateve publike, si dhe vlerësimi nëse Qeveria i përmbush obligimet që rrjedhin nga ligji.

Në kuadër të planit përfundimtar të aktiviteteve, grupi punues ka hartuar raport përfundimtar lidhur me Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit i cili do të shqyrtohet në Komision dhe i njejtë pritet të miratohet në Kuvend, në muajin janar 2016.

a.b) Mbikqyrja e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Në kuadër të zbatimit të Ligjit, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, monitoron veprimet për përfaqësimin e drejtë të komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në shërbimin publik të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, Komisioni realizon bashkëpunim me institucionet përkatëse të sistemit, me qëllim të informimit autentik dhe posedimit të të dhënave zyrtare.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim formoi grupin punues për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal.

Përkitazi me këtë, grupi punues ka pas bashkëpunim të ngushtë me të gjitha organet relevante, për grumbullimin e informacioneve të nevojshme zyrtare për nivelin e zbatimit të të njëjtit dhe vlerësimin se a janë duke u përmbushur obligimet të cilat rrjedhin nga Ligji.

Për të gjeturat e deritashme, grupi punues vlerëson se përqindja e përfaqësimit minimal prej 10 %, për integrimin e komunitetit jo shumicë në sferën e administratës publik, nuk respektohen siq parashihet me Ligj.

Aktivitetet e planifikuar të grupit punues, në procesin e mbikqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do ti vazhdojë në vitin 2016.

B. Vizitat e grupit punues në terren

Në kuadër të procesit të monitorimit të Ligjit Nr. 04/L-062 për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, grupi punues ka realizuar 2 (dy vizita) në teren, KK në Prizren dhe KK në Rahovec.

C. Takimet punuese dhe raportimi i mistrave

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka organizuar takim pune, me temat si në vijim:

- 1. Takim me zëvendësministrin e Ministrisë së Drejtësisë, Lirak Çelaj, me temën: Raportimi i Ministrisë për strukturë e gjyqëtarëve dhe prokurorëve në sistemin e gjyqësorit, në bazë të dialogut Prishtinë- Beograd*
- 2. Raportimi i ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim z. Dalibor Jectic lidhur me politikat zhvillimore të MKK-së për integrimin e komunitetit pakicë në Kosovë, ndarja proporcionale e fondeve për komunitete dhe struktura e punësimit në MKK-në.*
- 3. Takim informues i Ambasadorit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Jean-Claude Schlumberger, me temën: Mbikëqyrja, implementimi i ligjeve dhe mbrojtja e interesave të komuniteteve që jetojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.*
- 4. Raportimi i ministrit të MASHKR, z. Arsim Bajrami dhe rektorit të UP-së z. Ramadan Zejnullahu lidhur me procedurat e pranimit të kandidatëve të komuniutetit jo shumicë për regjistrim në nivel univerzitar, për vitin 2015/16.*
- 5. Raportim i ministrit të MAP, z. Mahir Yagcilar dhe sekretarit të përgjithshëm, z. Fitim Sadiku lidhur me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11.*

VII. Organizatat të cilat i kane ofruar mbështetje punës së Komisionit

OSBE-ja është njëra nga organizatat kryesore, e cila mbështetë punën e Komisionit që nga viti 2006. Mbështetja e OSBE-së, nga aspekti i organizimit, është i përhershëm në sferën e shqyrtimit të projektligjeve, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, organizimit të dëgjimeve publike dhe tryezave të rumbullakëta, si dhe bashkëpunimit ndërparlamentar.

OSBE-ja ka një numër të madh ekspertësh nga lëmi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve dhe nga ky aspekt, mund t'i ofrojë ndihmë Komisionit në çdo kohë.

VIII. Rezyme e punës - Pasqyrë e përgjithshme për periudhën janar-dhjetor 2015.

Nr.	Aktivitetet e Komisionit	Total
1	Mbledhjet e mbajtura	30
2	Mbledhjet e kryetarit të kuvendit me kryetarët e komisioneve parlamentare	
3	Procesverbalet e hartuara	29
4	Projektligje të hartuara nga komisioni	/
5	Numri i projektligjeve të shqyrtuara	41
6	Projektligje të kthyer për ripunim	/
7	Numri i grupeve të punës	4
8	Takimet e grupeve punuese	9
9	Numri i amendamenteve të propozuara	5
10	Raportet e hartuara me rekomandime për projektligjet në cilësi të komisionit funksional dhe të përhershëm	41
11	Monitorimi i zbatimit të ligjeve në procedurë	4
12	Shqyrtimi i raporteve vjetore të agjencive të pavarura	/
13	Vendime dhe rekomandime	1
14	Vizitat jashtë vendit	/
15	Vizitat në vend	2
16	Brifingje– tryeza të rumbullakëta	1
17	Seanca Dëgjimore	2
18	Propozime, kërkesa, informata për kryesinë e Kuvendit dhe përgjigjet në shkresa të organeve tjera	2

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushëveprimtaria e Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit;
 - a. Mbledhjet e Komisionit,
 - b. Shqyrtimi i projektligjeve;
 1. *Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit kryesor,*
 2. *Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funksional,*
 3. *Shqyrtimi i amendamenteve Kushtetuese.*
 - c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese,
 - d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private,
 - e. Mbajtja e dëgjimeve publike,
 - f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve,
 - g. Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit
 - h. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe),
 - i. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit.

IV. Rezime e punës së Komisionit

I. Hyrje

Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është formuar në pajtim me nenin 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 69 të Rregullores së Kuvendit. Aktivitetin e ka zhvilluar në pajtim me Kushtetutën dhe fushëveprimin e vet, të miratuar në vitin 2015, duke u bazuar në rregullat e Rregullores së punës të Kuvendit.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni për Legjislacion, si Komision i përhershëm, e shqyrton bazën juridike dhe kushtetuese për nxjerrjen e çdo ligji të Kuvendit të Kosovës. Në këtë kontekst, Komisioni në mënyrë të veçantë:

- Analizon dhe vlerëson përshtatshmërinë e akteve, të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës me Kushtetutën;
- Në raste të caktuara propozon, propozim - ligj, amendament në ligj, ose në aktin të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës;
- Shqyrton projektligjet në aspektin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë;
- Shqyrton deklarata politike, rezoluta dhe akte të tjera nënligjore në miratim nga Kuvendi i Kosovës nga aspekti i kushtetutshmërisë së tyre;
- Shqyrton çështjet parimore të harmonizimit të legjislacionit me Kushtetutën;
- Shqyrton propozimet për ndryshime kushtetuese;
- I kërkon Qeverisë amendamentimin e ligjeve, me qëllim të e legjislacionin tjetër, në raste të veçanta edhe vetë amendamenton ligje për këtë qëllim;
- Shqyrton çështjet që lidhen me metodologjinë dhe me teknikën unike të hartimit të legjislacionit;
- Shqyrton çështjet e gjyqësisë në Kosovë;
- Mbikëqyrë zbatimin e ligjeve në fushën e gjyqësisë në përgjithësi;
- Shqyrton çështjet e tjera të përcaktuara me këtë rregullore dhe çështjet të cilat me vendim të veçantë, i barten këtij Komisioni;
- Angazhon ekspertë për çështje të caktuara të fushëveprimit të Komisionit;
- Organizon dëgjime publike për çështje të caktuara në fushën e legjislacionit;
- Formon grupe të punës, për shqyrtimin e çështjeve të caktuara të fushëveprimit të Komisionit;
- Ushtron mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës;
- Komisioni kontakton me komisionet e tjera të Kuvendit, për t'i njoftuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

Perberja e Komisionit

ALBULENA HAXHIU, kryetare,	GP - VV
SELVIJE HALIMI, zëvendëskryetare e parë,	GP - PDK
DANUSH ADEMI, zëvendëskryetar i dytë, AGIM ALIU, anëtar,	GP - 6+
NEZIR ÇOÇAJ, anëtar	GP - PDK
AGIM ADEMAJ, anëtar,	GP - LDK
ARMEND ZEMAJ, anëtar,	GP - LDK
DORUNTINË MALOKU, anëtare,	GP - LDK
DONIKA KADAJ-BUJUPI, anëtare,	GP - AAK
VALDETE BAJRAMI, anëtare,	GP - NISMA
MILENA MILIÇEVIQ, anëtare	GP - LS

III. Aktivitetet e Komisionit

a. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për ta ushtruar funksionin e përcaktuar me rregullat e Rregullores së Kuvendit, në periudhën raportuese i ka shqyrtuar 11 projektligje, në cilësi të Komisionit Funkcional, 33 projektligje për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ia ka propozuar Kuvendit për miratim, 104 amendamente. Ka mbajtur 3 dëgjime publike dhe ka formuar 14 grupe të punës. Këto grupe, në periudhën e raportimit, mbajtën 25 takime. Komisioni ka monitoruar Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit kryesor

Në cilësinë e Komisionit kryesor, komisioni ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e këtyre projektligjeve:

1. Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;
2. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
3. Projektligjin nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konfliktet të armatosura jashtë territorit të vendit;

4. Projektligjin nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike;
5. Projektligjin nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit;
6. Projektligjin nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore;
7. Projektligjin nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga diskriminimi;
8. Projektligjin nr. 05/L-30 për Përgjimin e telekomunikimeve;
9. Projektligjin nr. 05/L-22 për Armë;
10. Projektligjin nr. 03/L-246 për Pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri;
11. Projektligjin nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;
12. Projektligjin nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale;
13. Projektligjin nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;
14. Projektligjin nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
15. Projektligjin nr. 05/L-27 për dixhitalimin e transmetimeve radio-difuzive tokësore;
16. Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;
17. Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
18. Projektligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin mendor;
19. Projektligjin nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;
20. Projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për patenta;
21. Projektligjin nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare;
22. Projektligjinnr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
23. Projektligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet;
24. Projektligjin nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore;
25. Projektligjin nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
26. Projektligjin nr. 05/L-57 për themelimin e Fondit Kosovar për garanci kreditore;
27. Projektligjin nr. 05/L-58 për Dizajnin Industrial;
28. Projektligjin nr. 05/L-51 për treguesit gjeografikë dhe për emërimet e origjinës;
29. Projektligjin nr. 05/L-52 për Energjinë termike;
30. Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016;
31. Projektligjin nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësit, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L 221,nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194;
32. Projektligjin nr. 05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L237;
33. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.

Shqyrtimi i amendamenteve Kushtetuese

Komisioni në periudhën raportuese ka shqyrtuar amendamentet Kushtetuese si vijon:

1. Amendamenti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ta bëjë me krijimin e Gjykatës Speciale,
2. Amendamentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës,që kanë të bëjnë me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,

3. Amendamenti kushtetues që ka të bëjë me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 1 dhe 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL

Në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL, ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e këtyre projektligjeve:

1. *Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës;*
2. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat;*
3. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;*
4. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;*
5. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;*
6. *Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit;*
7. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (i tërhequr nga propozuesi më dt. 6.5.2015);*
8. *Projektligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;*
9. *Projektligjin nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara;*
10. *Projektligjin nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 Këshillin Prokurorial të Kosovës;*
11. *Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni, në periudhën raportuese, ka shqyrtuar raportet vjetore të institucioneve dhe agjencive të pavarura si vijon:

1. Raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014;
2. Raportin vjetor të Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2014;
3. Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014;
4. Raportin vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014;
5. Raportin vjetor të Agjencisë së Pronave për vitin 2014.

d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Komisioni, në periudhën raportuese, ka shqyrtuar kërkesat e subjekteve si vijon:

1. Kërkesën e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, për formimin e një grupi të punës, për monitorimin e zbatimit të Ligjit për financimin e partive politike.
2. Kërkesën e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/39, për shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz, me interes të veçantë nacional.
3. Kërkesa e organizatës “Çohu” për sqarime rreth çështjes së vetëdeklarimit dhe vetë-kontrollit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit.
4. Kërkesën e deputetes Puhie Demaku.

5. Kërkesa e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për heqjen e imunitetit për Enver Hasanin dhe Arta Rama- Hajrizi.
6. Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
7. Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
8. Shkresa e Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD), e datës 20 korrik 2015, ZPD/15/zp/444;
9. Shkresa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e datës 6. 11.2015, nr. 1/652.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni, në periudhën raportuese, ka mbajtur dëgjime publike për:

1. Krijimin e Gjykatës Speciale, procesi i përgatitjes së legjislacionit dhe kushtetutshmëria e saj;
2. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-225 për Prokurorin e Shtetit;
3. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, në periudhën raportuese, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale.

g. Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit

Komisioni, në periudhën raportuese, ka bërë vizita brenda vendit, në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe Qendrën Korrektuese në Dubravë. Kurse jashtë vendit, në Republikën e Shqipërisë dhe në Mal të Zi.

h. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Komisioni, në periudhën raportuese, nuk ka pritur ndonjë delegacion parlamentar homolog.

i. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit

Komisioni, në periudhën raportuese, ka mbajtur takimet si vijon:

1. Takimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Hasan Preteni;
2. Takim i përbashkët i Komisionit me një grup nxënësish nga shkollat e mesme të Prishtinës;
3. Takimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit me përfaqësuesin e Këshillit Prokurorial, z. Shqipdon Fazliu, prokuror;
4. Takimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit me presidenten e vendit, Atifete Jahjaga;
5. Takim me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit Disiplinor;

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	48
2	Numri i pikave të rendit të ditës	168
3	Procesverbale të hartuara	48
4	Projektligje të shqyrtuara në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL	11
5	Projektligje të shqyrtuara në cilësinë e Komisionit kryesor	33
6	Shqyrtimi i amendamenteve Kushtetuese	18
7	Numri i grupeve punuese të formuara	14
8	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	25
9	Numri i amendamenteve të propozuara	104
10	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit kryesor	737
11	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	11
12	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	-
13	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	5
14	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	9
15	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	18
16	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2
17	Vizitat e realizuara brenda vendit	2
18	Dëgjime publike	3
19	Monitorimi i ligjeve	1

Tabela B – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	10
2	Procesverbale të hartuara	10
3	Numri i pikave të rendit të ditës	12
4	Punëtori të mbajtura	1

Të gjitha çështjet e diskutuara në takimet e Nënkomisionit, i janë nënshtruar shqyrtimit në Komision, para procedimit dhe miratimit.

Komisioni për Integritime Evropiane

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Komisioni për Integritime Evropiane ka njëmbëdhjetë anëtarë, me këtë përbërje:

1.	<i>Teuta Sahatqija</i>	(LDK)	<i>kryetare</i>
2.	<i>Valdete Bajrami</i>	(NISMA),	<i>nënkryetare</i>
3.	<i>Slobodan Petroviq</i>	(LS),	<i>nënkryetar</i>
4.	<i>Xhavit Haliti</i>	(PDK),	<i>anëtar</i>
5.	<i>Rrustem Mustafa</i>	(PDK)	<i>anëtar</i>
6.	<i>Luljeta Gutaj – Veselaj</i>	(PDK)	<i>anëtare</i>
7.	<i>Vjosa Osmani</i>	(LDK),	<i>anëtare</i>
8.	<i>Arben Gashi</i>	(LDK),	<i>anëtar</i>
9.	<i>Ilir Deda</i>	(VETËVENDOSJE)	<i>anëtar</i>
10.	<i>Time Kadriaj</i>	(AAK)	<i>anëtare</i>
11.	<i>Kujtim Paçaku</i>	(6+)	<i>anëtar</i>

I. Hyrje

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisionit për Integritime Evropiane ka hartuar planin e punës për vitin 2015.

Bazuar në Planin e Punës së Komisionit për Integritime Evropiane, Komisioni, si aktivitete kryesore ka pasur shqyrtimin e projektligjeve, monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në kompetencë të komisionit, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, si dhe aktivitete të tjera që mbulojnë fushën e këtij komisioni.

Komisioni ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare dhe ka bashkëpunuar me organizatat joqeveritare vendore e ndërkombëtare në fushën e integritimit evropian.

Komisioni për Integritime Evropiane, paraqet raportin e punës për aktivitetet e komisionit për vitin 2015.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

- Mbikëqyrja e procesit të harmonizimit të sistemit juridik të Kosovës, me sistemin juridik të Bashkimit Evropian;
- Mbikëqyrja e procesit të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit të Kosovës, me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përkatësisht me “*Acquis*” të BE-së;
- Shqyrtimin e projektligjeve të proceduara për miratim në Kuvend, nga aspekti i përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, përkatësisht me “*Acquis*” të BE-së;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me institucionet e BE-së;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me shtetet e BE-së, si dhe me shtetet e tjera për integritim në BE;

- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet evropiane në Kosovë: Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Këshillin e Evropës, Misionin EULEX-it në Kosovë, Kryesinë e BE-së dhe përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së (Ambasadave dhe Zyrave ndërlidhëse) në Kosovë;
- Mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të marra nga institucionet e Kosovës dhe sidomos detyrimet e Kuvendit ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian.

III. Aktivitetet e Komisionit

a) Mbledhjet e Komisionit

1) Komisioni për Integritet Evropian, për vitin 2015 ka mbajtur 34 mbledhje.

Mbledhja e parë e Komisionit, është mbajtur më 24 dhjetor 2014;
Mbledhja e fundit e Komisionit, është mbajtur më 14 dhjetor 2015.

2) Në Komision kanë raportuar:

- a) Ministri i Integritetit Evropian;
- b) Ministri i Punëve të Brendshme;
- c) Ministri i Drejtësisë;
- d) Ministri i Administratës Publike;
- e) Zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Komisioni për Integritet Evropian, po ashtu, ka zhvilluar takim me z. Samuel Zhbogar, udhëheqës i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovës, znj. Ulrike Lunacek- Raportuese për Kosovën, si dhe me z. Primoz Vehar, ekspert për përafrim të legjislacionit i angazhuar nga GIZ-i.

b) Shqyrtimi i projektligjeve;

a) Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e komisionit kryesor.

Komisioni ka shqyrtuar 39 projektligje me amendamente të komisioneve funksionale, në cilësinë e komisionit kryesor si vijon:

1. *Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
2. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
3. *Projektligjin nr. 05/L-09, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
4. *Projektligjin nr. 05/L-03, për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për lirim me kusht, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
5. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;*

6. Projektligjin Nr. 05/L-19, për Avokatin e Popullit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
7. Projektligjin Nr. 05/L-20, për Barazi Gjinore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
8. Projektligjin Nr. 05/L-21, për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
9. Projektligjin Nr. 05/L-32, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-199, për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
10. Projektligjin Nr. 05/L-33, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-223, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
11. Projektligjin Nr. 05/L-35, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;
12. Projektligjin Nr. 05/L-34, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225, për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
13. Projektligjin Nr. 05/L-36, për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
14. Projektligjin 05/L-28, për Tatimin në të Ardhurat Personale, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
15. Projektligjin 05/L-29, për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
16. Projektligjin 05/L-37, për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
17. Projektligjin Nr. 05/L-27, për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
18. Projektligjin 05/L-15, për Letërnjoftim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
19. Projektligjin 05/L-22 për Armë me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
20. Projektligjin 03/L-246, për Pajisje me Armë, Municion dhe pajisje përkatëse të Sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
21. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
22. Projektligjin nr. 05/L-043, për faljen e borxheve publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
23. Projektligjin për shëndetin mendor, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
24. Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
25. Projektligjin Nr. 05/L-39 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për Patenta, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
26. Projektligjin Nr.05/L/-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
27. Projektligjin Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

28. *Projektligjin Nr. 05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
29. *Projektligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
30. *Projektligjin Nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
31. *Projektligjin Nr. 05/L-57 për themelimin e Fondit Kosovar për garanci kreditore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
32. *Projektligjin Nr. 05/L-51 për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
33. *Projektligjin Nr. 05/L-58 për dizajnin industrial, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
34. *Projektligjin Nr. 05/L-052 për energjinë termike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
35. *Projektligjin Nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
36. *Projektligjin nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
37. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
38. *Projektligjin nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
39. *Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.*

b) Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional;

Në cilësinë e Komisionit Funkcional, Komisioni ka shqyrtuar dy projektligje;

1) Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve.

Për këtë projektligj janë bërë 22 (njëzet e dy) amendamente, ndërsa dy propozim- amendamente kanë ardhur nga dy deputetë. Këto propozim - amendamente të deputetëve nuk janë përkrahur nga Komisioni.

2) Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike në anën tjetër.

Për këtë projektligj Komisioni ka bërë 1(një) amendament.

c. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni ka mbajtur 2 (dy) dëgjime publike:

- 1) Për shqyrtimin e Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve dhe

2) për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

d. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Me vendim të Komisionit janë themeluar dy grupe të punës për monitorimin e zbatimit të dy ligjeve:

- 1) Ligjit Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me veprë penale dhe
- 2) Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Komisioni më 7 dhjetor 2015, ka miratuar raportin me rekomandime të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe të njëjtin raport me rekomandime e ka proceduar për miratim ne seancë plenare. Në seancën e datës 14 dhjetor 2015, është miratuar raporti me rekomandime

e. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

1) Vizitat brenda vendit 12 (dymbëdhjetë)

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-140, për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me veprë penale, janë vizituar këto institucione:

- a) Policia e Kosovës;
- b) Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar;
- c) Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike;
- d) Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- e) Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ndërsa në kuadër të monitorimit të zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-218, për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, janë vizituar këto institucione:

- a) Ministria e Punëve të Brendshme;
- b) Policia e Kosovës;
- c) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- d) Strehimorja për Strehimin e Viktimave të Trafikimit në Lipjan;
- e) Dy organizata (OJQ) që merren me mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore;
- f) Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- g) Këshilli Gjyqësor i Kosovës

2) Jashtë vendit 5 (pesë) vizita:

- a) Vizitë në Senatin dhe Dhomën e Përfaqësuesve Italian;
- b) Pjesëmarrja si mysafir special në mbledhjen Plenare të COSAC-ut- nënkryetarja me një deputet;
- c) Pjesëmarrja në COSAP;
- d) Vizitë në Këshillin e Evropës,
- e) Pjesëmarrja në COSAP.

f. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Komisioni gjatë këtij viti ka pritur këto delegacione:

- a) Grupin e Miqësisë së Francës,
- b) Senatorët Italianë dhe
- c) Ulrike Lunacek- Raportuese për Kosovën.

g. Takimet individuale të kryetares dhe anëtarëve të tjerë të komisionit

Duke pasur parasysh natyrën e punës së Komisionit, kryetarja e Komisionit gjatë këtij sesioni, ka realizuar një sërë takimesh individuale me ambasadorët e akredituar në Kosovë dhe më përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë:

- a) Takim me ambasadoren e Francës;
- b) Takim me ambasadoren e Turqisë;
- c) Takim me ambasadorin e Holandës;
- d) Takim me ambasadorin e Britanisë së Madhe;
- e) Takim me ambasadorin e Gjermanisë;
- f) Takim me përfaqësues të Misionit të OSBE-së;
- g) Takim me përfaqësues të UNDP-së;
- h) Takim me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës;
- i) Takim me përfaqësuesit e GIZ-it;
- j) Takim me përfaqësues nga NPC/ĒFD;
- k) Takim me Cindy Van den Boogert, nga njësi për Kosovën në Drejtorinë për Zgjerim në Bruksel.

h) Organizimi i konferencës

Më 16 qershor 2015, Komisioni ka organizuar Konferencën gjithëpërfshirëse mbi “Rolin e Kuvendit në procesin e integritit evropian”.

Konferenca ka zhvilluar punimet në dy pjesë. Pjesa plenare ka qenë e dedikuar për vështrim të përgjithshëm mbi rrugën e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian, ndërsa pjesa e dytë, diskutim i fushave të rëndësishme për procesin e Integritit në BE, që ka pasur si bazë tri fusha tematike: *sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe bashkëpunimi rajonal.*

h. Rezyme

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	34
2	Numri i pikave të rendit të ditës	142
3	Procesverbale të hartuara	34
4	Projektligje të shqyrtuara	41
5	Numri i grupeve punuese të formuara	3
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	5
7	Numri i amendamente të propozuara	23

8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	959
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	2
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	6
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	/
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
13	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	4
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	5
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	12
16	Dëgjime publike	2
17	Monitorimi i ligjeve në procedurë	1
18	Monitorimi i ligjeve të përfunduara	1
19	<i>Konferencë</i>	1
20	<i>Raportimet e ministrave</i>	7

Komisioni për Punë të Jashtme

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

I. Hyrje

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

III. Aktivitetet e Komisionit

- a. *Mbledhjet e Komisionit*
- b. *Shqyrtimi i projektligjit*
- c. *Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit*
- d. *Formimi i grupeve të miqësisë*
- e. *Bashkëpunimi ndërparlamentarë, avancimi i diplomacisë parlamentare*
- f. *Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë*
- g. *Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit*
- h. *Pritja e delegacioneve të huaja parlamentare*
- i. *Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të komisionit*

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Përbërja dhe struktura e Komisionit:

Komisioni për Punë të Jashtme, gjatë sesionit pranveror të vitit 2015, ka funksionuar në përbërje të plotë prej 9 (nëntë) anëtarëve:

Përbërja dhe struktura e Komisionit:

Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit	PDK
Teuta Rugova, nënkryetare e parë e Komisionit	LDK
Qerim Bajrami, nënkryetar i dytë i Komisionit	GP 6+
Blerta Deliu Kodra, anëtare	PDK

Elmi Reçica, anëtar	PDK
Ismet Beqiri, anëtar	LDK
Puhie Demaku, anëtare	VV
Ramush Haradinaj, anëtar	AAK
Zafir Berisha, anëtar	NISMA

Gjatë sesionit vjeshtor, z. Ramush Haradinaj deputet nga radha e GP i AAK-së, është tërheqë nga përbërja e Komisionit për Punë të Jashtme e po ashtu edhe znj. Puhie Demaku, anëtare e Komisionit nga radha e GP i VV-së, është zëvendësuar me deputetin Glauk Konjufca.

I. Hyrje

Ky raport pasqyron punën e Komisionit për Punë të Jashtme, gjatë vitit 2015, ku janë përfshi aktivitetet dhe punët që ka realizuar Komisioni, konform detyrave dhe përgjegjësi që i ka të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Fushëveprimi dhe kompetencat e Komisionit për Punë të Jashtme, janë përcaktuar në shtojcën 2, të Rregullores së Kuvendit:

Komisioni për Punë të Jashtme është Komision Funkcional.

Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësi, e ndërton bashkëpunimin me parlamentet e shteteve dhe e promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare.

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshinë:

- Në koordinim me Kryetarin dhe me Kryesinë e Kuvendit, ndërtimin e bashkëpunimit me parlamentet e shteteve dhe e promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare;
- Shoqërimin e Kryetarit të Kuvendit, në takimet parlamentare ndërkombëtare;
- Ratifikimin në bllok ose ndaras të traktateve ekzistuese, që Kosova dëshiron t'i nënshkruajë;
- Përcjelljen e negociatave të udhëhequra nga Qeveria për bashkëpjesëmarrje të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve për punë të jashtme dhe për imunitetet diplomatike;
- Mbikëqyrjen e veprimeve të Qeverisë në planin e politikës së jashtme;
- Shoqërimin e ministrit të Punëve Jashtme në takime të caktuara, të rëndësishme;
- Bashkëpunimin me komisionet homologe, të parlamenteve të vendeve të tjera;
- Promovimin e diplomacisë parlamentare të Kuvendit;
- Shqyrtimin e projektligjeve të propozuara nga Ministria e Punëve të Jashtme;
- Shqyrtimin e Projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të Ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, që me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës, me rrjetin diplomatik të Kosovës dhe me të gjitha ministrinë tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit gjatë vitit 2015:

a. Mbledhjet e Komisionit

Gjatë vitit 2015, Komisioni për Punë të Jashtme, aktivitetet e tij i ka mbështetur në Planin dhe programin e tij të punës.

Prioritet në Planin dhe programin e punës së Komisionit ishte përmbushja e obligimeve nga fushëveprimtaria e Komisionit, zbatimi i programeve legjislative të Qeverisë, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, raportimi i ministrave dhe ekzekutivit në mbledhjet e Komisionit, avancimi i diplomacisë parlamentare dhe takimet e Komisionit me delegacione të huaja parlamentare.

Komisioni ka zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për shërbimin e jashtëm, mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës dhe gjatë hartimit të raporteve të ndryshme e rekomandimeve për Kuvendin.

Pjesë e punës së Komisionit ishte edhe përmbushja e obligimeve ligjore nga fusha e punëve të jashtme, siç ishte dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë.

Komisioni po ashtu u angazhua për ngritjen e bashkëpunimit ndërparlamentarë.

Parime themelore të punës së Komisionit kanë qenë përmbushja e obligimeve të tija dhe në raste të nevojshme ka formuar grupe të punës për realizimin e detyrave të caktuara.

Anëtarët e Komisionit kanë qenë të rregullt në takimet e tyre, gjë që dëshmohet edhe me faktin se gjatë tërë vitit, nuk ka dështuar asnjë takim i Komisionit në mungesë të kuorumit.

Mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar të hapura dhe janë përcjellë nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare.

Për çdo takim të Komisionit, është mbajtur evidenca mbi pjesëmarrjen e vëzhguesve të punës së Komisionit.

Komisioni në raste të veçanta të përcaktuara me ligj, takimet e tij i ka zhvilluar të mbyllura për pjesëmarrësit e tjerë dhe nuk i ka publikuar procesverbalet nga takimet e mbyllura, gjë që mund të ndikojë në mospasqyrimin e saktë të punës së Komisionit.

Puna e Komisionit shpeshherë është përcjellë edhe nga mediat dhe ka pasur hapësirë të mjaftueshme si në media të shkruara ashtu edhe në ato elektronike.

Kryetari i Komisionit, në koordinim me zëvendëskryetaren, kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Kryetari i Kuvendit, me kryetarët e të gjitha komisioneve parlamentare.

Duke pasur parasysh aktivitetet e zhvilluara, Komisioni ka arritur në masë të madhe të përmbushë çështjet e parapara në Planin dhe programin e punës së tij, gjatë këtij viti.

Temat themelore të trajtuara në Komision - Komisioni gjatë punës së tij ka realizuar këto aktivitete:

- Konstituimi i Komisionit për Punë të Jashtme;
- Shqyrtimi i draft-planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2015;
- Formimi i grupeve të miqësisë;
- Raportimi i ministrit të FSK-së, z. Haki Demolli;
- Miratimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2015;
- Raportimi i ministrit të MD-së, z. Valon Murati;
- Shqyrtimi i shkresës për formimin e grupeve të miqësisë;
- Takim i Komisionit me delegacionin nga Qiproja;
- Raportimi i ministres për dialog, znj. Edita Tahiri;
- Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës;
- Bashkëpunimi parlamentar;
- Takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë të Asamblesë Nationale të Francës;
- Anëtarësimi i Kuvendit në organizatat parlamentare;
- Grupet e miqësisë në mes të Kuvendit të Kosovës dhe parlamenteve të tjera;
- Vizita e Komisionit jashtë vendit;
- Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë;
- Raportimi i Komisionit Shtetëror për shënjimin e kufirit me Malin e Zi.

b. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional

Në Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2015, në kompetencë të Komisionit për Punë të Jashtme, ishte paraparë që të procedohet për shqyrtim Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.

Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, i është proceduar Kuvendit për shqyrtim më 14.9.2015. Komisioni për Punë të Jashtme në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2015, e ka përkrahur miratimin në parim të këtij projektligji. Projektligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, është miratuar në parim në seancën e mbajtur më 30 nëntor. Grupi punues i Komisionit gjendet në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjit.

c. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit

Komisionit për Punë të Jashtme, formoi Grupin e Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në përbërje: Puhie Demaku, kryesuese e grupit, Teuta Rugova, Blerta Deliu-Kodra, Zafir Berisha e Qerim Bajrami, anëtarë.

Grupi i punës, me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të ligjit, ka zhvilluar dy vizita zyrtare jashtë vendit dhe ka mbajtur takime me persona përgjegjës për zbatimin e ligjit në MPJ-së, MPB-së dhe MD-së

Pas miratimit të raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës nga Komisioni, raporti është përcjellë për shqyrtim në seancë plenare.

Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2015, shqyrtoi dhe miratoi Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike e Konsullore të Republikës së Kosovës.

d. Formimi i grupeve të miqësisë

Bazuar në Rregulloren për formimin e Grupeve të miqësisë nr. 03-228 të datës 10 nëntor 2009 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komisionit, me shkresën e datës 13 janar 2015, njoftoi të gjithë deputetët e Kuvendit për mundësinë e paraqitjes së propozimeve për formimin e grupeve të miqësisë.

Komisioni për Punë të Jashtme me qëllim të krijimit të rrjetit të marrëdhënieve në mes të kuvendarëve të Kuvendit të Kosovës dhe homologëve të shteteve të huaj, në mbledhjen e mbajtur më 9 shkurt 2015, Kryesisë së Kuvendit i propozoi formimin e grupeve të miqësisë dhe riformimin në fillim të mandatit të ri parlamentar.

Në propozim të Kryesisë së Kuvendit, Komisioni sërish shqyrtoi listën e deputetëve për formimin e grupeve të miqësisë, bazuar në deklaratimet e deputetëve për anëtarë të grupeve të miqësisë.

e. Bashkëpunimi ndërparlamentarë e avancimi i diplomacisë parlamentare

Komisioni për Punë të Jashtme, u angazhua edhe për avancimin e bashkëpunimit ndërparlamentarë dhe avancimin e diplomacisë parlamentare. Komisioni diskutoi mbi nevojën e anëtarësimit të Kuvendit në organizata parlamentare dhe në këtë drejtim kërkoi ndihmën e Drejtorisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll të Kuvendit.

f. Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë

Bazuar në Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Komisioni për Punë të Jashtme ka për detyrë që të dëgjojë në seanca të mbyllura kandidatët e propozuar nga MPJ-ja për postin e ambasadorit.

Komisioni gjatë këtij sesiioni ka dëgjuar në seanca të mbyllura dëgjimore shtatë kandidatë të propozuar për ambasadorë dhe raportet nga dëgjimi i tyre, në besim, i janë dërguar Presidentes, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme.

g. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Komisioni për Punë të Jashtme, gjegjësisht delegacionet e tij, gjatë kësaj periudhe kanë pasur tri vizita zyrtare, jashtë vendit. Një vizitë është realizuar në Çeki, dhe dy vizita janë realizuar në funksion të zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në Gjermani dhe Zvicër.

Po ashtu, Grupi i Punës i Komisionit ka pasur tri vizita pune jashtë Kuvendit, në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, dhe ato në MPJ, në MPB dhe MD.

h. Pritja e delegacioneve të huaja parlamentare

Gjatë këtij viti, Komisioni për Punë të Jashtme është takuar me delegacionin nga Qiproja dhe me Grupin e Miqësisë të Asamblesë Nationale të Francës. Anëtarët e Komisionit në këto takime kanë falënderuar delegacionet për vizitat dhe kanë kërkuar mbështetjen nga vendet e tyre, për zhvillimin dhe integrimin e Kosovës.

i. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit

Kryetari i Komisionit, z. Enver Hoxhaj, në mungesë të tij, nënkryetarja znj. Teuta Rugova, ka marrë pjesë në takimet me kryetarët e komisioneve parlamentare. Kryetari i komisionit ka pasur takime të shumta individuale.

Nënkryetarët e Komisionit për Punë të Jashtme znj. Teuta Rugova dhe z. Qerim Bajrami dhe nënkryetarja e Komisionit për Integritet evropian znj. Valdete Bajrami, më 23 shkurt 2015, u takuan me delegacionin e Parlamentit të Suedisë.

IV. Rezume e punës së Komisionit për Punë të Jashtme

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	20
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	66
3.	Procesverbale të hartuara	20
4.	Projektligje në procedurë	1
5.	Numri i grupeve punuese të formuara	2
6.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	6
7.	Numri i raportimeve të ministrave dhe të Komisionit Shtetëror	4
8.	Numri i raporteve të hartuara nga puna e grupit punues	6
9.	Kërkesa e njoftime Kryesisë së Kuvendit	12
10.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	3
11.	Vizitat e realizuara brenda vendit	3
12.	Shqyrtimi i kërkesave nga MPJ-ja	7
13.	Dëgjime të kandidateve për ambasadorë	7
14.	Monitorimi i ligjit	1
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	0
16.	Raporte për Presidenten, për dëgjimin e kandidatëve për ambasadorë	7
17.	Raporte për Kryeministrin, për dëgjimin e kandidatëve për ambasadorë	7
18.	Raporte për MPJ, për dëgjimin e kandidatëve për ambasadorë	7
19.	Shkresa deputetëve shqiptarë të Luginës së Preshevës, Malit të Zi dhe të Maqedonisë	3
20.	Shkresa kryetarëve të komisioneve homologe për bashkëpunim parlamentar	35
21.	Ftesa për raportim të ministrave	9

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushëveprimtaria e Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit
 - a. *Mbledhjet e Komisionit*
 - b. *Shqyrtimi i projektligjeve*
 - c. *Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e organeve të pavarura*
 - d. *Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private*
 - e. *Mbajtja e dëgjimeve publike*
 - f. *Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve*

- g. Vizitat e Komisionit
 - h. Pritja e delegacioneve të huaja parlamentare
 - i. Raportimi i udhëheqësve të institucioneve në Komision
 - j. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të Komisionit
- IV. Rezume e punës së Komisionit

Tabela A

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në përbërjen e vet numëron 9 (nëntë) anëtarë. Përfaqësimi i subjekteve politike në Komision është si vijon:

1	Nait Hasani	kryetar	G/P - PDK
2	Salih Morina	zëvendëskryetar i parë	G/P - LDK
3	Srdjan Popovic	zëvendëskryetar i dytë	G/P - LS
4	Bekim Haxhiu	anëtar	G/P - PDK
5	Shpejtim Bulliqi	anëtar	G/P - LDK
6	Ismajl Kurteshi	anëtar	G/P - VV
7	Teuta Haxhiu	anëtare	G/ P - AAK
8	Shukrije Bytyçi	anëtare	G/P - NISMA
9	Mufera Sinik	anëtare	G/ P - 6 +

Shenim:

Me propozimin e Grupit Parlamentar “Lista Serbe”, dhe me Vendimin e Kuvendit nr. 05-V-077 të datës 15 maj 2015, deputeti Sërxfan Popovic, është emërar anëtar në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini e Sport, në vend të deputetes Jelena Bontiq.

I. Hyrje

Komisioni, përmes këtij raporti paraqet punën e realizuar gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2015, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që i ka të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Fushëveprimi i Komisionit përfshinë :

- Shqyrtimin e legjislacionit arsimor në të gjitha nivelet arsimore, të shkencës, teknologjisë, kulturës, rinisë dhe të sportit;
- Çështjet që lidhen me planifikimin e zhvillimit strategjik dhe politikës zhvillimore në lëmin e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit;
- Çështjet që ndërlidhen me buxhetin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, të Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport si dhe të Ministrisë së Diasporës ;
- Çështjet që lidhen me procesin e reformimit dhe të ngritjes së cilësisë të të gjitha niveleve arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë ;
- Pozitën materiale të institucioneve arsimore, kulturore dhe shkencore të të punësuarve në këto institucione;
- Çështjet që lidhen me zhvillimin e teknologjive të reja dhe të inovacioneve në menaxhimin e resurseve publike dhe private ;
- Politikën e bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës në lëmin e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës, rinisë dhe sportit ;
- Shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën, përfshirë ministrinë përkatëse për Diasporë;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive të resorit përkatës, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i tij ;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me Rregullore dhe të çështjeve të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni, gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, është angazhuar në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi, si vijon :

a. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, ka mbajtur gjithsej 35 (tridhjetëepesë) mbledhje. Mbledhja e parë e vitit është mbajtur me datën 21.1.2015, ndërsa mbledhja e fundit për këtë periudhë raportuese është mbajtur me datën 9.12.2015.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë të hapura për përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, shoqërisë civile, media dhe grupet e interesit që kanë shprehur interesim për çështjet e caktuara që janë shqyrtuar.

Komisioni, pjesërisht ka realizuar planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2015, që ndërlidhet me monitorimin e ligjeve dhe shqyrtimin e projektligjeve të proceduara nga Qeveria.

b. Shqyrtimi i Projektligjeve

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, Komisioni ka shqyrtuar 8 (tetë) projektligje, të proceduara nga Qeveria. Qeveria me vendim nr.11/27 të datës 6.5.2015, ka tërhequr nga shqyrtimi në Kuvend Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Janë miratuar dy (2) projektligje në seancën e mbajtur me datë 14.12.2015, janë në proces të

shqyrtimit dhe amendamentimit katër (4) projektligje, ndërsa një (1) projektligjëshe të shqyrtuar në Komision para miratimit në parim dhe është proceduar për lexim të parë në Kuvend.

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional:

1. *Projektligjinr.05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (është miratuar në lexim të dytë në Kuvend më 14.12.2015);*
2. *Projektligji nr.05/L-026 për Trashëgiminë Kulturore (Qeveria me vendim e ka tërhequr nga shqyrtimi në Kuvend);*
3. *Projektligjinr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (është miratuar në lexim të dytë në Kuvend më 14.12.2015);*
4. *Projektligji nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta (në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit);*
5. *Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë (në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit);*
6. *Projektligji nr.05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës (në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit);*
7. *Projektligji nr.05/L-074 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (është proceduar në Kuvend për lexim të parë);*
8. *Projektligji nr.05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës në Ngjarjet Sportive (është miratuar në parim në Kuvend më 14.12.2015)*

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur me datën 22.7.2015, ka shqyrtuar Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar që të mos e miratojë Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2014.

d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

- ***Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore*** - Komisioni, ka shqyrtuar shkresën e MKRS-së, lidhur me emërimin 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në mbledhjen e mbajtur më 8.4.2015, ka bërë përzgjedhjen e 7 (shtatë) anëtarëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar të bëjë emërimin e tyre.
Kuvendi në mbledhjen plenare të mbajtur më 23.7.2015, emëroi anëtarët Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me mandat trevjeçar.
- ***Këshilli Kombëtar i Shkencës*** – Komisioni më 29.7.2015, ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë nr.04/37, të datës 8.7.2015 për emërimin e 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar të mos bëjë emërimin e tyre.
- ***Universiteti Publik i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj*** – Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 15.7.2015, ka shqyrtuar Vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe Kuvendit i ka rekomanduar ratifikimin e Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

e. Dëgjime publike

Komisioni ka mbajtur gjithsej 11(njëmbëdhjetë) dëgjime publike :

- **8 (tetë)** dëgjime publike lidhur me Projektligjinnr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (*dëgjimet publike janë mbajtur në Kuvend, në Hotel Sirius, dy dëgjime publike, të mbështetura nga D4D dhe KDI-ja, si dhe në Kuvendet Komunale në Gjilan, Mitrovicë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe në Pejë*);
- 1 (**një**) dëgjim publik lidhur me Projektligjinnr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
- **1(një)** dëgjim publik lidhur me Projektligjin nr.05/L-050 për Kinematografinë;
- **1 (një)** dëgjim publik lidhur me Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065, për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisionin në kuadër të planit të punës për vitin 2015, ka paraparë monitorimin e pesë ligjeve nga fushëveprimtaria e tij. Në mbledhjen e mbajtur më 15.4.2015, nxori Vendim për formimin e Grupeve Punuese për monitorim të këtyre ligjeve :

- Ligji për Arsimin Parauniversitar - është përgatitur plani i veprimit për monitorim, është hartuar pyetësori, i cili u është dërguar institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit, janë realizuar vizita në MASHT, janë vizituar shkolla publike dhe private, janë realizuar takime me përfaqësues të GIZ-it, sipas planit të veprimit për monitorim të ligjit, ka mbetur të organizohet një dëgjim publik dhe të hartohet raporti me rekomandime ;
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, procesi i monitorimit nuk është filluar;
- Ligji për Sport dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sport, Grupi i Punës nuk ka nisur monitorimin;
- Ligji për Diasporën dhe Mërgatën, procesi i monitorimit nuk është filluar.

g. Vizitat e Komisionit

Vizita brenda vendit -Komisioni, në kuadër të aktiviteteve të punëska realizuar 20 (njëzet) vizita në Komuna të ndryshme me qëllim të njohjes për së afërmi me gjendjen në fushat që i mbulon Komisioni.

Vizita jashtë vendit – Komisioni në periudhën janar – dhjetor 2015 ka realizuar 4 (katër) vizita jashtë vendit, si vijon :

- Vizitë në Luginë të Preshevës nga 9 deri më 10 mars 2015,
- Vizitë në Mal të Zi nga 10 deri 12 maj 2015,
- Vizitë në Gjermani/Berlin nga 13 deri 20 qershor 2015 dhe
- Vizitë në Shqipëri nga data 17 deri më 19 nëntor 2015.

Po ashtu Komisioni ka marr pjesë në punëtorinë dyditore në Durrës të organizuar nga MASHT, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore.

h. Pritja e delegacioneve të huaja parlamentare

Me qëllim të njohjes së përafërt me legjislacionin në fushën e arsimit dhe të kulturës, Komisioni ka ftuar në vizitë pune Komisionin homolog të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Vizita e Komisionit homolog është realizuar nga 16-17 mars 2015.

i. Raportimi i udhëheqësve të institucioneve në Komision

Gjatë periudhës raportuese, në Komision kanë raportuar ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 7 (shtatë) herë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 2 (dy) herë, ministri i Diasporës 1 (një) herë, , ministri i Administratës Publike, 1 (një) herë dhe kryetarja e Këshillit Shtetëror të Cilësisë 1 (një) herë .

Raportimet e cekura me lartë janë realizuar si vijon :

1. **26.12.2014** – Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it dhe z.Valon Murati, Ministër MD-së, lidhur me prioritetet dhe sfidat gjatë mandatit të tyre qeverisës;
2. **21.1.2015** – Raportim i z. Kujtim Shala, ministër MKRS-së, lidhur me prioritetet dhe sfidat në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
3. **27.1.2015** – Raportim i zj. Ferdije Zhushi – Etemi, kryetare e KSHC, lidhur me procesin e Akreditimit të bartësve publikë dhe privatë të Arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
4. **18.3.2015** – Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it, lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
5. **15.04.2015** – Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it, lidhur me çështjen e diplomave të falsifikuara të lëshuara në Pejë;
6. **03.06.2015** – Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it dhe z. Mahir Yagcilar, ministër i MAP-së, lidhur me kolizionin e ligjeve që rregullojnë marrëdhënien e punës në fushën e arsimit;
7. **22.09.2015** - Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it, lidhur me fillimin e vitit shkollor 2015/2016 në arsimin parauniversitar;
8. **24.11.2015** - Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it, lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
9. **02.12.2015** - Raportim i z. Arsim Bajrami, ministër MASHT-it, lidhur me projektbuxhetin për vitin 2016, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
10. **02.12.2015** - Raportim i z. Kujtim Shala, ministër MKRS-së, lidhur me projektbuxhetin për vitin 2016, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

j. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të Komisionit

Gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur takime të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit me Përfaqësues të Bankës Botërore për sektorin e arsimit, takime të rregullta me përfaqësues të GIZ-it, KDI-së, NDI-së si dhe është mbajtur një takim me bartësit e Kolegjeve private që veprojnë në vend.

IV. Rezime

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	35
2	Numri i pikave të rendit të ditës	134
3	Procesverbale të hartuara	35
4	Projektligje në procedure të shqyrtimit	5
5	Numri i grupeve punuese të formuara	4
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	3
7	Numri i amendamenteve të propozuara	57
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	1
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje për miratim në parim	8
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	1
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	3
13	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	4
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	4
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	20
16	Dëgjime publike	11
17	Monitorimi i ligjeve	1
18	Punëtori jashtë vendit	1
19	Raportimi ministrave dhe udhëheqësve të institucioneve të pavarura	12

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

1	Zenun Pajaziti	kryetar	PDK
2	Sadri Ferati	zëvendëskryetar i parë	LDK
3	Kujtim Paçaku	zëvendëskryetar i dytë	GP 6+
4	Xhevahire Izmaku	anëtare	PDK
5	Alma Lama	anëtare	LDK
6	Shqipe Pantina	anëtare	VV
7	Pal Lekaj	anëtar	AAK
8	Jelena Bontic	anëtare	LS
9	Zafir Berisha	anëtar	Nisma

I. Hyrje

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me qëllim të pasqyrimin të punës së tij, ka hartuar raportin e tij, i cili përmban të dhëna informacione dhe shënime që tregojnë aktivitetet dhe punët që i ka realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

II. Fushëveprimi i Komisionit

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

- Shqyrtimin, përcaktimin dhe koordinimin e politikave të punës për një shërbim objektiv civil për të gjithë qytetarët, pa dallime, mbi bazën e objektivitetit, të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë;
- Projektet e aftësimit dhe të ngritjes profesionale të kuadrove për shërbimin civil;
- Propozimin e masave për ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë dhe të menaxhimit të ndërtesave;
- Propozimin e masave për administrimin e sistemit të pagesave dhe listën e pagave të shërbimit civil;
- Shqyrtimin e standardeve për shërbimet e teknologjisë informative, që duhet përdorur;
- Shqyrtimin e implementimit të politikës së punës për sigurimin e shërbimeve të furnizimit, në përputhje me rregullat dhe me procedurat e përcaktuara;
- Shqyrtimin e çështjeve për administrimin dhe regjistrimin e OJQ-ve;
- Shqyrtimin e çështjeve me rëndësi për mbledhjen, mirëmbajtjen, analizën dhe për publikimin e statistikave zyrtare;
- Shqyrtimin e çështjeve për administrimin dhe për mirëmbajtjen e sistemit kadastror;
- Mbikëqyrjen e administratës lokale dhe funksionimin e pushtetit lokal;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e listës së anëtarëve për Komisionin e Pavarur për Media dhe për Bordin e Mediave Publike;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimi i buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me rregullore dhe të çështjeve të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

a. Mbledhjet e Komisionit

Mbledhja konstituive e Komisionit është mbajtur më 26 dhjetor 2014. Komisioni ka miratuar Planin e punës, në bazë të cilit ka zhvilluar aktivitetet e tij dhe për këtë mund të shihet edhe numri i mbledhjeve të mbajtura dhe rezultatet e punës. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2015, Komisioni ka mbajtur gjithsej 30 mbledhje.

Me ftesë të Komisionit, në 10 takime, kanë prezantuar ministra, zëvendësministra.

Për të qenë sa më efektiv në punën e tij, Komisioni, gjatë mandatit të tij, ka formuar *grupe punuese*, nga një grup për secilën çështje.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare. Punën e Komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e OSBE-së, NDI-së, KDI-së, GIZ-it, GAP-it, BIRN-it, si dhe asociacione e organizata të tjera. Gjithashtu, puna e Komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe elektronike.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar Projektligjin për festat zyrtare.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka marrë vendim për plotësimin e Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision funksional, ka në procedurë të amendamentimit Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar raportet vjetore të organeve të pavarura si vijon:

- 1. Raporti vjetor i punës së Radiotelevizionit të Kosovës – nuk është miratuar nga Kuvendi.*
- 2. Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur të Mediave – është miratuar nga Kuvendi.*
- 3. Raporti vjetor i punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil – është miratuar nga Kuvendi.*
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës – është miratuar nga Kuvendi.*

d. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka mbajtur 5 dëgjime publike, 3 tryeza dhe një punëtori dyditore.

e. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni ka formuar grupet punuese për monitorimin e ligjeve:

- grupi punues për monitorimin e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave;
- grupi punues për monitorimin e Ligjit për OJQ;
- grupi punues për monitorimin e Ligjit për administratën shtetërore.

f. Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit

Komisioni ka realizuar një vizitë brenda vendit në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në Kuvendin Komunal në Junik, në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe një vizitë jashtë vendit, në

Shqipëri.

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	30
2	Numri i pikave të rendit të ditës	109
3	Procesverbale të hartuara	30
4	Projektligje të shqyrtuara	3
5	Numri i grupeve punuese të formuara	3
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	7
7	Numri i amendamente të propozuara	/
8	Numri i amendamente të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	1
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	4
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
13	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	1
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	3
16	Dëgjime publike	5
17	Monitorimi i ligjeve	3

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

I. Hyrje

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

III. Aktivitetet e Komisionit

- a. Mbledhjet e Komisionit
- b. Shqyrtimi i projektligjeve
- c. Nisma legjislative
- d. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese
- e. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private
- f. Mbajtja e dëgjimeve publike
- g. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
- h. Kontrolli parlamentar
- i. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit
- j. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit
- k. Aktivitet tjera
- l. Bashkëpunimi ndërparlamentar
- m. Buxheti i Komisionit

IV. Rezime e punës së komisionit

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Nr. rendor	Emri dhe mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
1	Muhamet MUSTAFA	kryetar	G/P – LDK
2	Visar YMERI	zëvendëskryetar i parë	G/P – VV
3	Sasha MILOSAVLEVIQ	zëvendëskryetar i dytë	G/P – LS
4	Besim BEQAJ	anëtar	G/P – PDK
5	Raif QELA	anëtar	G/P – PDK
6	Sala BERISHA – SHALA	anëtare	G/P – PDK
7	Fatmir REXHEPI	anëtar	G/P – LDK
8	Blerim GRAINCA	anëtar	G/P – LDK
9	Pal LEKAJ	anëtar	G/P – AAK
10	Enver HOTI ⁵	anëtar	G/P – NISMA
11	Duda BALJE	anëtare	G/P – 6+

I. Hyrje

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (në vijim Komisioni), është Komision Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës⁶. Qëllimi i tij është t'i shqyrtojë të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me ekonominë, infrastrukturën, tregtinë, industrinë, energjetikën, transportin, telekomunikacionin etj.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij për vitin 2015, në Legjislaturën V, është hartuar ky Raport, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe për punët që i ka realizuar Komisioni gjatë kësaj periudhe, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të marrëveshjes së grupeve parlamentare, Komisioni ka qenë i përbërë më anëtarë të të gjitha grupeve parlamentare, në bazë të numrit të votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin

⁵ Me vendim të Kuvendit të Kosovës nr.05-V-023 date 13.02.2015, deputetin Fatmir Limaj e ka zëvendësuar deputeti Enver Hoti nga GP NISMA.

⁶ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Neni 69 par. 4.3.

e Kosovës, të mbajtura më 8 qershor 2014⁷.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë i shqyrton të gjitha çështjet që përfshijnë:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të Kosovës, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore për mjedis më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike;
- Angazhimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë dhe të transportit;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive dhe agjencive rregullatorë që i raportojnë Komisionit, dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe agjencive rregullatorë të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni;

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

Komisioni parlamentar për të marrë informacione shtesë nga grupet e interesit apo aktorët kryesorë për zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjes efektive të politikave, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile organizon dëgjime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ku diskutohet legjislacioni në interes të zhvillimit ekonomik dhe mënyrat për të nxitur biznesin dhe prodhimin vendor në Kosovë, thithjen e investimeve të huaja, përmirësimin e mjedisit të biznesit, dhe për funksionimin dhe fuqizimin e agjencive dhe rregullatorëve që i raportojnë Komisionit.

III. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni gjatë këtij sesi ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të Planit të tij Vjetor të Punës, të hartuar gjithnjë duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë⁸. Këto aktivitete Komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, monitorimit të zbatimit të ligjeve, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse.

Duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë, Komisioni në fillim të vitit 2015, e ka miratuar Planin e Punës, në bazë të cilit edhe i ka zhvilluar aktivitetet e veta.

⁷Shih për këtë tabelën me përbërjen dhe strukturën e Komisionit.

⁸ Komisionet parlamentare në secilin fillimit, pasi ta marrin Strategjinë legjislativë nga Qeveria e hartojnë Planin e Punës për vitin vijues.

a) Mbledhjet e Komisionit

Komisioni gjatë sesionit pranveror të Legjislaturës V, i ka realizuar gjithsej 43 (dyzet e tri) mbledhje të rregullta. *Mbledhjen e tij të parë Komisioni e ka mbajtur më 23.12.2014*, që është aktiviteti i parë i tij dhe fillimi i funksionimit të tij si Komision Funkcional i Kuvendit të Kosovës për Legjislaturën V. *Ndërkaq, mbledhja e fundit e Komisionit në këtë vit është mbajtur më 21.12.2015*, që është aktiviteti i fundit i Komisionit për vitin 2015.

Gjatë punës së vet, Komisioni, ka zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit⁹. Gjithnjë në mbështetje të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i ka realizuar mbledhjet dhe takimet e tij të rregullta, në të cilat janë shqyrtuar 215 (dyqindpesëmbëdhjetë) pika të rendit të ditës¹⁰. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizataveqeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare¹¹. Punën e Komisionit e kanë monitoruar përfaqësuesit e OSBE-së, NDI-së, INDEP-it, GLPS-së, KDI-së, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e Komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

Në realizimin e punës së vet, Komisioni është mbështetur nga partnerë dhe ekspertë të ndryshëm. *Komisioni shprehë falënderim të posaçëm për Institutin INDEP*, që ka ndihmuar Komisionin me analizë të pavarur hulumtuese dhe po ashtu për ndihmën e dhënë në organizimin e aktiviteteve si tryeza, punëtori, etj.

Duke i marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij viti, Komisioni ka arritur të përmbushë Planin e Punës për këtë vit.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Gjithnjë në frymën e dispozitave kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Kosovës përfaqëson pushtetin ligjvënës¹². Komisioni si organ i Kuvendit, duke zbatuar mandatin e tij, miratimin e ligjeve apo bërjen e ligjeve, gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar të gjitha Projektligjet në kuadër të fushëveprimit e tij.

Gjatë këtij viti, Komisioni ka arritur që falë angazhimit të tij të shqyrtojë 14 (katërmëdhjetë) Projektligje, ndërsa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi gjithsej 10 (dhjetë) projektligje¹³; 1 (një) është tërhequr nga Qeveria; dhe 3 (tri) projektligje janë në procedurë të shqyrtimit në Komision.

Projektligjet e miratuara janë si në vijim:

1. Projektligji Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre - 19.01.2015¹⁴;

⁹Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

¹⁰ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 64.

¹¹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 65.

¹²Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 63 dhe 65

¹³ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

¹⁴ Data e miratimit të Projektligjit në seance plenare nga Kuvendi.

2. Projektligji Nr.05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike – 07.04.2015.
3. Projektligji Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore – 30.07.2015.
4. Projektligjit Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 026 për Markat Tregtare – 30.07.2015;
5. Projektligjit Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 029 për Patenta – 31.07.2015;
6. Projektligji nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës – 14.12.2015;
7. Projektligji nr.05/L-058 për Dizajnin industrial – 14.12.2015;
8. Projektligji nr.05/L-052 për Energjinë termike – 14.12.2015;
9. Projektligji nr.05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për garanci kreditore – 14.12.2015;
10. Projektligji nr.05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-115 – 14.12.2015;

Projektligji i tërhequr nga Qeveria është :

1. Projektligji Nr.05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike – 19.1.2015.

Projektligjet të cilat janë në procedurë në Komision janë 3 (tre) si në vijim:

1. Projektligji nr.05/L-064 për Patentë shofer (ka kaluar leximin e parë në seancë plenare);
2. Projektligji nr.05/L- 062 për Siguri në punë në veprimtarinë minerare (ka kaluar leximin e parë në seancë plenare);
3. Projektligji nr.05/L- 079 për Investimet strategjike (ka kaluar leximin e parë në Komision).

Në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të lartcekura, Komisioni ka formuar 15 (pesëmbëdhjetë) Grupe të punës, për secilin Projektligj, apo pako projektligjesh nga një Grup i punës. Në grupe punuese janë trajtuar Projektligjet nga aspekti profesional dhe teknik, për të cilat kryesuesi i grupit punues, ka ftuar ministrinë e linjës, ekspertë të ndryshëm si dhe ka marrë opinionet e shoqërisë civile.

Gjatë shqyrtimit të këtyre Projektligjeve, *Komisioni ka hartuar dhe miratuar 145 (njëqind e dyzet e pesë) amendamente*¹⁵. Komisioni ka shqyrtuar 8 (tetë) amendamente të propozuara nga Komisionet e përhershme.

c) Nisma Legjislative

Njëkohësisht, Komisioni ka marrë nisma edhe të hartimit të Projektligjeve dhe, gjatë këtij viti ka hartuar “Projektligjin për Sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”¹⁶. Grupi punues ka bashkëpunuar ngushtë dhe është koordinuar me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si dhe me ministrinë përkatëse në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ekspertë të fushës, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM dhe Inspektoratin e Punës. Projektligji i është dërguar Qeverisë për dhënien e mendimit lidhur me këtë projektligj. Pas kalimit të afatit ligjor për dhënien e mendimit nga Qeveria, Projektligji i është shpërndarë deputetëve për shqyrtim të rregullt dhe është miratuar në lexim të parë në seancë plenare. Projektligji është në fazën e shqyrtimit në Komision.

¹⁵ Këtu janë përfshirë amendamentet të cilat janë miratuar nga Komisioni për ato projektligje që e kanë kaluar atë fazë.

¹⁶ Kjo nisme legjislative është e deputetes Sala Berisha – Shala në mbështetje të Komisionit.

d) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij viti ka shqyrtuar edhe raportet vjetore të agjencive të pavarura, të themeluara nga Kuvendi¹⁷. Komisioni lidhur me këto raporte, në disa raste ka kërkuar raport shtesë. Komisioni ka hartuar Raport me Rekomandime, të cilat ishin temë diskutimi në mbledhje plenare të Kuvendit të Kosovës.

Në këtë vit raportet vjetore të punës të institucioneve raportuese, të cilat janë shqyrtuar nga ana e Komisionit janë si vijon:

1. Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil;
2. Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji;
3. Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
4. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Për këto raporte të shqyrtuara Komisioni ka miratuar 15 (*pesëmbëdhjetë*) Rekomandime, të cilat janë miratuar njëzëri nga Kuvendi.

Raportet vjetore të institucioneve raportuese në vijim, edhe pse institucionet e pavarura i kanë dorëzuar me kohë, nuk janë shqyrtuar nga ana e Komisionit për shkak të mungesës së Bordeve në këto institucione:

1. Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
2. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Hekurudhave;
3. Raporti vjetor i punës së Autoriteti të Konkurrencës së Kosovës.

e) Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Komisioni, gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar kërkesa dhe propozime të institucioneve publike dhe private dhe gjithat i ka adresuar në bazë të Rregullores së Kuvendit, si ne vijim:

- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Komisionit e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria;
- Shkrese nga AKP (Njoftim lidhur me Aktvendimin e DHPGJS-së, lidhur me Ndërmarrjen “TREPÇA”);
- Përfundim i Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, personat e pagjetur dhe peticione, lidhur me peticionin e Sindikatës së Grand Hotelit Prishtina;
- Përfundim i Kryesisë nr.05-P-025, datë 12.5.2015, Informatë lidhur me procesin e privatizimit të NSH “Amortizatorët”;
- Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë për emërim të kandidatëve për anëtarë në Bordin e Agjencisë Kosovare të privatizimit;
- Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë, për emërim të kandidatëve për anëtarë në Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji;
- Shqyrtimi i Propozim vendimit të Qeverisë, për emërim të kandidatëve për anëtarë në Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

¹⁷Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 72.

f) Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni gjatë vitit 2015 ka realizuar gjithsej 6 (gjashtë) dëgjime publike. Dëgjimet publike Komisioni i ka organizuar lidhur me projektligjet e veçanta dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Siç u cek edhe me lartë, dëgjimet publike legjislativë janë si në vijim:

1. Projektligji Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (27.2.2015);
2. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për investimet e huaja (23.3.2015);
3. Projektligjin Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore (13.5.2015);
4. Projektligji Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (28.10.2015);
5. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Standardizimin (23.11.2015);
6. Projektligji nr. 05/L-064 për Patentë Shofer (15.12.2015).

g) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni pati parasysh se një prej detyrimeve kushtetuese është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, e jo vetëm nxjerrja e tij. Për shkak se ligjet shpesh nuk zbatohen ashtu siç pritet ose synohet, qoftë për shkak të problemeve rreth zbatimit ose të ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike, mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit është imperativ për një legjislativ efektiv.

Gjatë vitit 2015, Komisioni ka mbikëqyrë zbatimin e dy ligjeve.

- *Ligji për investimet e huaja nr. 04/L-220 (Rekomandimet e Komisionit janë miratuar në seancë plenare);*
- *Ligji për standardizimin nr.03/L-144 (Komisioni ka miratuar Raportin me Rekomandime dhe është proceduar për shqyrtim në seancë plenare)*

h) Kontrolli parlamentar

Duke ushtruar mandatin e tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë/Ministrive që i raportojnë Komisionit, ministrat e dikastereve përkatëse janë ftuar për raportim dhe seanca dëgjimore në Komision, varësisht nga tema të cilën e ka trajtuar Komisioni.

Më poshtë kemi listën e raportimeve të ministrave në Komision gjatë kësaj periudhe, si vijon:

1. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 16.1.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-06 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike;
2. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 19.1.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-08 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
3. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 27.1.2015, lidhur me gjendjen në ndërmarrjet publike dhe telekomunikacionin;
4. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 3.2.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;

5. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 10.2.2015, lidhur me ambientin e biznesit dhe nxitjen e investimeve;
6. Raportim i z.Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit me datën 24.2.2015, lidhur me strategjinë e Zhvillimit të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale;
7. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 1.4.2015, lidhur me Raportin me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja;
8. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 28.4.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore;
9. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 26.5.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-039 për patenta;
10. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 2.6.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-040 për Markat Tregtare;
11. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik; z.Hanefi Muharremi zv.ministër i Infrastrukturës; z.Avni Kastrati, zv.ministër i Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 7.7.2015, lidhur me realizimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Progresit;
12. Raportim i z.Avni Kastrati, zv.ministër i Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 28.7.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;
13. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 15.9.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial;
14. Raportim i znj.Besa Zogaj – Gashi, zv.ministre e Zhvillimi ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 15.9.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;
15. Raportim i z.Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit me datën 24.9.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer;
16. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 20.10.2015, lidhur me zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Energjia, Minierat, Agjencitë e pavarura në fushëveprim dhe ndërmarrjet publike);
17. Raportim i z.Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit me datën 27.10.2015, lidhur me zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Infrastruktura rrugore, Trafiku, Hekurudhat);
18. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 3.11.2015, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në

realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Industria, Prodhimi, Eksporti, Sektori i naftës dhe Investimet e jashtme);

19. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit me datën 1.12.2015, mbi ecurinë e realizimit të Projektit TC “Kosova e Re”;
20. Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit me datën 21.12.2015, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.

i) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Vizitat brenda vendit

Gjatë vitit 2015, Komisioni i ka realizuar 6 (gjashtë) vizita brenda vendit, më qëllim që të shoh për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimtarinë e Komisionit, si vijon:

- Më 9, 17 dhe 19 mars 2015, në AKB; OEK; MTI, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për investimet e huaja;
- Më 14 prill 2015, në KEK;
- Më 23 qershor 2015, vizitë në Shoqatat e Industrisë së Qumështit në Prishtinë;
- Më 11 nëntor 2015, në MTI, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për standardizimin;

Vizitat jashtë vendit

Komisioni, në vazhden e punës së tij, e ka realizuar edhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë pjesë në Konferenca rajonale dhe në seminare të Parlamentit Evropian si dhe në punëtori të ndryshme etj. Gjatë këtij sesioni ka realizuar gjithsej 9 (nëntë) vizita jashtë vendit, si vijon:

- Më 5-6, në Ankara, Parlamenti Evropian – Kuvendi i Madh Turk;
- Më 19-21, në Tiranë, seminar EFD/NPC;
- Më 20-21 mars 2015, në Sofje/Bullgari- SECCP;
- Më 6.5.2015, në Bruksel – Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
- Më 29-30 shtator 2015, Podgoricë/ Mali i Zi- PIPS;
- Më 15-16 tetor 2015 Sarajevë – (Bosnje dhe Hercegovinë) - Parlamenti Evropian;
- Më 6-7 nëntor 2015 Sofje/Bullgari – SECCP;
- Më 14.12.2015, në Vjenë/Austri, – Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
- Më 17-18 dhjetor 2015, në Tiranë/Shqipëri – Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni homolog, Ministrinë e linjës.

j) Takimet e Komisionit dhe të kryetarit

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësisë në mënyrë më efektive, Komisioni ka organizuar takime dhe e ka shtrirë bashkëpunimin me të gjitha subjektet, siç janë: Kryetari i Kuvendit, komisionet parlamentare, Zyra e Kryeministrit, ministrinë përkatëse, institutet, pushteti lokal, përfaqësuesit e agjencive të pavarura, përfaqësuesit e odave ekonomike, ambasadat, si dhe me sindikata të punëtorëve etj.

Gjatë vitit 2015, kryetari i Komisionit ka realizuar 21 (njëzet e një) takime si në vijim:

- Më 13.1.2015, takim me GSJP-në;
- Më 16.1.2015, takim me GAP-in;

- Më 23.1.2015, takim me EFD/NPC;
- Më 2.2.2015, takim me ekspertë për Projektligjin nr.05/L- 09 NP e Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Më 3.2.2015, takim me ambasadorin e Zvicrës;
- Më 3.2.2015, takim me ambasadorin Britanik të Madhe;
- Më 10.2.2015, takim me përfaqësues të Sekretariatit të Energjisë;
- Më 24.2.2015, takim me MIM “Golesh”;
- Më 12.3.2015, takim me OJQ PIPS;
- Më 18.3.2015, takim me investitorin për energji, Kompaninë “BILFINGER” nga Gjermania;
- Më 28.4.2015, takim me KPMM-në;
- Më 29.4.2015, takim me ambasadorin e Turqisë;
- Më 13.5.2015, takim me USAID-in dhe INDEP-in;
- Më 30.4.2015, takim me ambasadorin e ri të Britanisë së Madhe;
- Më 7.7.2015, takim me EIC;
- Më 29.7.2015, takim me institucionet dhe palë lidhur me projektligjin për digjitalizim;
- Më 20.10.2015, takim me Sindikatën e KEK-ut;
- Më 23.10.2015, takim me USAID-in;
- Më 28.10.2015, takim me ambasadorin hungarez për tregti dhe industri;
- Më 10.11.2015, takim me ambasadorin e Hungarisë;
- Më 24.11.2015 takim me CEO/IPKO;

k) Aktivitetet tjera

Sipas Planit të punës për këtë vit, Komisioni ka paraparë që ndër çështjet më me prioritet të trajtohet krijimi i kushteve për një mjedis të përshtatshëm të të bërit biznes, për investitorë të brendshëm dhe të jashtëm, stimulimi i prodhimeve vendore, krijimi i infrastrukturës ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.

Në këtë frymë, Komisioni ka ndërmarr hapa të rëndësishëm për adresimin e çështjeve, duke i trajtuar përmes dëgjimeve, analizave dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete, si ne vijim:

1. Mbikëqyrja e Rekomandimeve të Komisionit Hetimor, lidhur me faturimin e shpenzimeve të rrymës elektrike (shkurt - mars 2015);
2. Raportimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me ambientin e biznesit dhe nxitjen e investimeve (mars - prill 2015);
3. Rekomandime lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata (të miratuara nga Kuvendi më 25.6.2015);
4. Rekomandime lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në Industrinë e Qumështit (të miratuar nga Kuvendi më 30.11.2015).

Komisioni si bashkëorganizues apo si i ftuar ka marrë pjesë edhe në ngjarjet në të cilat janë trajtuar çështje që janë në fushëveprimin e Komisionit, si në vijim:

1. Tryezë: Diskutim rreth amendamentimit të ligjit për Eficiencën e Energjisë (27 maj 2015) Instituti i Prishtinës për Studime Politike dhe Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
2. Tryezë: Lidhur me Agjencitë e pavarura (4 nëntor 2015) INDEP dhe Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

l) Bashkëpunimi ndërparlamentar

Komisioni ka bashkëpunuar me dy Komisionet e Kuvendit, si me Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, lidhur më Projektligjin për digjitalizim, si dhe më Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me kontestet e bizneseve dhe adresimi i tyre në gjykata, dhe janë nxjerrë rekomandime, të cilat janë miratuar nga Kuvendi.

Gjithashtu Komisioni ka realizuar vizitë në Tiranë/Shqipëri 17-18.12.2015, ku ka mbajtur mbledhje të përbashkët me Komisionin për Veprimtari Prodhuese, Tregti dhe Mjedis, komision homolog në Kuvendin e Shqipërisë, dhe në këtë takim janë dakorduar për vazhdimin e bashkëpunimit.

Komisioni ka zhvilluar edhe aktivitetet në ndërkombëtar, duke u anëtarësuar në dy organizata të rëndësishme, si SEECP – Sofje/Bullgari dhe Asamblenë Parlamentare të Komunitetit të Energjisë Vjenë/Austri. Në të dy organizatat Komisioni përfaqësohet me dy deputet.

m) Buxheti i Komisionit

Komisioni ka një buxhet prej pesëmijë (5.000) eurosh, i cili shfrytëzohet në bazë të Udhëzimit për administrimin e buxhetit të Komisioneve. Për vitin 2015, Komisioni ka shpenzuar shumën prej dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë (2560) euro, ku prej tyre një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë (1475) euro për ekspertiza, ndërkaq një mijë e tetëdhjetë e pesë euro (1085) euro për shpenzime reprezentative në mbledhje dhe takime të Komisionit.

IV. Rezime e punës së komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	43
2	Numri i pikave të rendit të ditës	215
3	Procesverbale të hartuara	42
4	Projektligje të shqyrtuara dhe të amendamentuara	10
5	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në Komision	3
6	Projektligje të tërhequra nga Qeveria dhe të pamiratuara nga Kuvendi	1
7	Numri i nismave legjislative	1
8	Numri i formuar i grupeve punuese	15
9	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	19
10	Numri i amendamenteve të propozuara	145
11	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	8
12	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	23
13	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	1
14	Numri i Rekomandimeve	60
15	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	4
16	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	15
17	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	16
18	Vizitat e realizuara jashtë vendit	9
19	Vizitat e realizuara brenda vendit	6
20	Dëgjime publike	6
21	Monitorimi i ligjeve	2
22	Punëtori/Workshop	3
23	Takime të Komisionit/kryetarit	21

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushëveprimtaria e Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit
 - a. Mbledhjet e Komisionit
 - b. Grupet e punës
 - c. Shqyrtimi i projektligjeve
 - d. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e agjencive të pavarura
 - e. Mbajtja e dëgjimeve publike
 - f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
 - g. Vizitat
 - h. Takimet dhe raportimet e ministrave në Komision
 - i. Tryezat dhe takimet e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit
- IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela

Perberja e Komisionit:

1	Flora Brovina	kryetare	PDK
2	Njomza Emini	zëvendëskryetar i parë	LDK
3	Fikrim Damka	zëvendëskryetar i dytë	6+
4	Fadil Beka	anëtar	PDK
5	Hatim Baxhaku	anëtar	LDK
6	Besa Baftiu	anëtare	VV
7	Time Kadrijaj	anëtare	AAK
8	Adem Hoxha	anëtar	LS
9	Shukrije Bytyçi	anëtare	NISMA

I. Hyrje

Ky raport është bazuar në të dhënat e mbledhura nga puna e komisionit, nga mbledhjet e mbajtura, vizitat e realizuara, dëgjimet publike, monitorimet e ligjeve dhe përfshinë periudhën kohore dhjetor 2014 - dhjetor 2015.

Sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë dhe procedojë pa vonesë çështjet që i adresohen atij.

Komisioni ka për detyrë t'i rekomandojë Kuvendit për diskutim dhe miratim, çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin e Komisionit, apo çështjet që i janë adresuar.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave, për zhvillimin dhe funksionimin efikas të shëndetësisë, të punës dhe të mirëqenies sociale;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme, për mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve të tjerë, që përkohësisht gjenden në Kosovë, duke e nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore të shëndetësisë;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme, për zhvillimin e marrëdhënieve të punës, duke e përfshirë në veçanti hapjen e vendeve të reja te punës;
- Angazhimin për sigurimin e një mirëqenieje të kënaqshme në Kosove, duke i përfshirë sigurimin dhe mbrojtjen sociale të qytetarëve të Kosovës, mbrojtjen sociale të invalidëve të luftës, të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të punës, të të burgosurve politikë dhe të familjeve të tyre, të të gjitha kategorive të paaftë për punë dhe ndërtimin e një sistemi të efektshëm pensional për të gjitha kategoritë.
- Angazhimin për shqyrtimin e programit të Qeverisë, të mënyrës dhe të nivelit të zbatimit të tij në fushën e shëndetësisë, të punës dhe të mirëqenies sociale dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Angazhimin për identifikimin e programeve specifike të Qeverisë, përkatësisht të ministrisë së resorit përkatës dhe në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, e bën shqyrtimin e hollësishëm, si është bërë financimi dhe menaxhimi i tyre;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit në vitin 2015 kanë qenë si vijon:

a. Mbledhjet e Komisionit

Në mbledhjet e Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale është punuar sipas Rregullores së Kuvendit.

Komisioni ka punuar në bazë të planit të punës, të miratuar nga ky komision me datën 28 janar 2015.

Komisioni ka mbajtur gjithsejtë 23 mbledhje. Mbledhjet e komisionit janë mbajtur një herë në javë. Mbledhja e parë e komisionit është mbajtur më 22 dhjetor 2014.

Në të gjitha mbledhjet e komisionit ka pasur kuorum. Mesatarja e pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhje është 8 deputetë. Kohëzgjatja e mbledhjeve, mesatarisht ka qenë 1:30 minuta.

Për mbledhjet e komisionit rregullisht është hartuar procesverbali nga zyrtarët e komisionit.

Mbledhjet e komisionit janë thirrur nga kryetarja e komisionit, e cila edhe ka përcaktuar rendin e ditës. Vendimet në mbledhjet e komisionit janë marrë me konsensus ose me shumicë votash. Mbledhjet e Komisionit çdoherë kanë qenë të hapura për publikun.

b. Grupet e punës

Komisioni ka formuar 5 grupe të punës:

- Grupi i punës për monitorimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko- Social: Time Kadrijaj, kryesuese, Flora Brovina, Fikrim Damka, Njomza Emini, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Shukrije Bytyçi dhe Besa Baftiu, anëtarë.
- Grupi i punës për amendamentimin e Projektligjit për Shëndetin Mendor: Shukrije Bytyçi, kryesuese, Flora Brovina, Fikrim Damka, Njomza Emini, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Time Kadrijaj dhe Besa Baftiu, anëtarë .
- Grupi i punës për amendamentimin e Projektligjit përmbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri: Besa Baftiu, kryesuese, Flora Brovina, Fikrim Damka, Njomza Emini, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Shukrije Bytyçi dhe Time Kadrijaj, anëtarë.
- Grupi i punës për amendamentimin e Projektligjit për Shërbimin Mjekësor Emergjent: Hatim Baxhaku, kryesues, Flora Brovina, Fikrim Damka, Njomza Emini, Fadil Beka, Time Kadrijaj, Shukrije Bytyçi dhe Besa Baftiu, anëtarë.
- Grupi i punës për Monitorimin buxhetor të skemave të asistencës sociale: Fikrim Damka, kryesues, Flora Brovina, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Adem Hoxha dhe Njomza Emini, anëtarë.

Grupet e punës kanë mbajtur gjithsej 19 mbledhje.

Raportet përfundimtare për Projektligjet e shqyrtuara nga Komisioni, janë përgatitur nga zyrtarët e komisionit, në bashkëpunim me kryetarin e komisionit- raportuesin.

Rekomandimet janë përgatitur nga zyrtarët e komisionit, në bashkëpunim me kryetarin e komisionit.

c. Shqyrtimi i projektligjeve

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL

Në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL, Komisioni ka shqyrtuar dhe proceduar për miratim në Kuvend 2 (dy) projektligje, për të cilat ka hartuar raportet me rekomandime.

Projektligjet e shqyrtuara janë:

- Projektligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri (*Raporti i Komisionit me amendamente është miratuar nga Kuvendi*);
- Projektligji për shëndetin mendor (*Raporti i Komisionit me amendamente është miratuar nga Kuvendi*);

Projektligjet në procedurë të shqyrtimit janë:

- Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent (*në procedurë të amendamentimit*).
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara (*kanë kaluar në parim në Komision, është proceduar për seancë*).
- Projektligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve (*ka kaluar në parim në Komision dhe është proceduar për seancë*).

d. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e agjencive të pavarura

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk ka në kompetencë të mbikëqyrë asnjë agjenci të pavarur.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë vitit 2015 ka mbajtur 2 (dy) dëgjime publike:

- *Më 16 qershor 2015, ka mbajtur dëgjim publik për Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent.*
- *Më 25 mars 2015, ka mbajtur dëgjim publik për monitorimin e Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.*
- *Më 4 mars 2015, ka marrë pjesë dëgjim publik të organizuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me të gjeturat e auditorit të përgjithshëm për Ministrinë e Shëndetësisë.*

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni e ka autoritetin të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose ministria përkatëse.

Në bazë të këtij autoriteti, në vitin 2015, Komisioni ka mbikëqyrur zbatimin e një Ligji.

- Gjatë periudhës shkurt-prill 2015, Komisioni ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit nr. 04/L-008, për Këshillin Ekonomiko-Social
- Komisioni gjithashtu, në muajin nëntor 2015, ka filluar monitorimin buxhetor të skemave të asistencës sociale.

g. Vizitat

- ***Vizitat brenda vendit***

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë kësaj periudhe, ka zhvilluar dy vizita në Spitalin e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare dhe në SHSKUK – kardiokirurgji, neonatologji dhe pediatri.

Komisioni ka realizuar edhe disa vizita monitoruese në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Asociacionet e Biznesit/punëdhënësve, si: Oda Ekonomike e Kosovës-OEK, Aleanca Kosovare e

Biznesit-AKB si dhe Organizatat e Punëmarrësve si: Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës-BSPK.

- **Vizitat jashtë vendit**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë vitit 2015, ka realizuar 2 (dy) vizita jashtë vendit:

- Komisioni më 4-6 tetor 2015, ka vizituar Republikën e Shqipërisë.
- Komisioni më 25-27 tetor 2015, ka vizituar Republikën e Malit të Zi.

h. Takimet dhe raportimet e ministrave në Komision

Me ftesë, para Komisionit kanë raportuar ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi dhe ministri i Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani. Po ashtu, para Komisionit kanë raportuar edhe z. Agim Çeku, kryetar i Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të Veteranëve të UÇK-së, z. Curr Gjocaj, drejtor i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, si dhe z. Arianit Jakupi, kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

- Ministri, Arban Abrashi, ka raportuar për prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Ministri, Arban Abrashi, ka raportuar për gjendjen sociale në Kosovë, e në mënyrë të veçantë, për problemet me skemën pensionale, punësimin, po ashtu ka raportuar për zbatimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti etj.
- Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka raportuar për prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka raportuar për gjendjen e shëndetësisë në Kosovë, për problemin e pronave të QKUK-së dhe objekteve rreth QKUK-së. Ka raportuar për Ligjin për Sigurimet Shëndetësore etj.
- Ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, ka raportuar për buxhetin e shëndetësisë për vitin 2016.
- Z. Agim Çeku, kryetar i Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të Veteranëve të UÇK-së, ka raportuar lidhur me punën e Komisionit.
- Z. Curr Gjocaj, drejtor i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, ka raportuar për pronat e QKUK-së dhe e objekteve rreth QKUK-së.
- Z. Arianit Jakupi, kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ka raportuar për çështjen e barnave në Kosovë.
- Z. Basri Ibrahim, kryeinspektor i punës, ka raportuar për rastin e suspendimit nga puna të sindikalistëve të RTK-së.
- Z. Ilmi Ramadani, kryetar i Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të të dënuarit, të burgosurit dhe të përndjekurit politik të Kosovës, ka njoftuar për procesin e kompensimit të ish- të burgosurit politik.
- Komisioni ka mbajtur edhe disa takime me sindikatat dhe me pensionistët.

i. Tryezat dhe takimet e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit

- **Tryezat :**
 - Tryezë e organizuar në bashkëpunim me OSBE –në, për mbikëqyrjen buxhetore të ministrive të linjës.
 - Tryezë me koalicionin e organizatave joqeveritare-KOMF, ku u diskutua për legjislacionin

- dhe të drejtat e fëmijëve në Kosovë.
- Tryezë e organizuar nga Banka Botërore, lidhur me zbatimin e Ligjit të Punës.

• **Takimet e kryetares :**

1. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me përfaqësuesin e D4D, Leon Malazogu.
2. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me ambasadoren e Ambasadës së Turqisë.
3. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me përfaqësuesin e KDI-së, Jetmir Bakia.
4. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me ambasadoren e Ambasadës së Zvicrës.
5. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me përfaqësuesit e UNICEF- it.
6. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina dhe anëtari Hatim Baxhaku, kanë takuar ministrin e Shëndetësisë, Imet Rrahmani.
7. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me Z. Basri Ibrahim, kryeinspektor i punës,
8. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me SBASHK-un.
9. Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, ka mbajtur takim me specialistët e pediatriisë.

IV. Rezime e punës së Komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	23
2	Numri i pikave të rendit të ditës	93
3	Procesverbale të hartuara	23
4	Projektligje të shqyrtuara dhe miratuara	2
5	Projektligje në procedurë	3
6	Numri i formuar i grupeve të punës	5
7	Numri i mbledhjeve të grupeve të punës	19
8	Numri i amendamenteve të propozuara	62
9	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	4
0	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	2
11	Dhënia e mendimeve për komisionet tjera	0
12	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	0
13	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	3
14	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	5
15	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2
16	Vizitat e realizuara brenda vendit	5
17	Dëgjime publike	2+1
18	Monitorimi i ligjeve	1+1
19	Tryeza	2+1
20	Takimet e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit	9

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushëveprimtaria e Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit
 - a. *Mbledhjet e Komisionit*
 - b. *Shqyrtimi i projektligjeve*
 - c. *Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese*
 - d. *Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve*
 - e. *Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim*
 - f. *Vizitat e komisionit brenda vendit*
 - g. *Vizitat e komisionit jashtë vendit*
 - h. *Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit*
- IV. Rezyme e punës së komisionit
- V. Shtojca

PËRBËRJA E KOMISIONIT:

1. Fikrim **DAMKA**, kryetar (G/P – 6+)
2. Salih **SALIHU**, zëvendëskryetar i parë (G/P – VV)
3. Srdjan **POPOVIC**, zëvendëskryetar i dytë (G/P – LS)
4. Shaip **MUJA**, anëtari (G/P – PDK)
5. Emilija **REDZEPI**, anëtare (G/P – PDK)
6. Murat **HOXHA**, anëtar 3 (G/P – LDK)
7. Adem **SALIHAIJ**, anëtar (G/P – LDK)
8. Lahi **BRAHIMAJ**, anëtar (G/P – AAK)
9. Haxhi **SHALA**, anëtar (G/P – NISMA)

I. HYRJE

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është një nga komisionet funksionale. Komisioni në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin rural dhe mjedisin e planifikimin hapësinor. Në Kuvendin e Kosovës deri më sot janë miratuar 59 ligje që lidhen ngushtë me punën e këtij Komisioni, prej tyre 27 ligje janë nga fusha e bujqësisë, pylltarisë e zhvillimit rural dhe 32 nga ajo e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

Komisioni me qëllim të pasqyrimin të punës së vet gjatë viti 2015, ka hartuar këtë raport i cili përmban të dhënat që tregojnë për aktivitetet e realizuara sipas planit të vet të punës. Bazuar në planin e punës për vitin 2015, Komisioni planifikoi shqyrtimin e 11 projektligjeve, prej tyre 10 projektligje bazuar në programin legjislativ të qeverisë për vitin 2015 dhe 1 projektligj të inicuar nga Komisioni. Nga programi legjislativ i Qeverisë asnjë projektligj nuk është proceduar në Kuvend, ndërsa Projektligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nismë e komisionit ka përfunduar, ndërsa është duke u shqyrtuar Projektligjin për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

Po ashtu Komisioni ka shqyrtuar 2 raporte, ndërsa 3 raporte, 2 strategji sektoriale dhe 3 plane të veprimit, që janë planifikuar për këtë sesion nuk janë proceduar në Kuvend. Ndërsa sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Komisioni ka përfunduar një mbikëqyrje dhe dy të tjera i ka në fazën përfundimtare.

Për të realizuar planin, Komisioni ka mbajtur 26 mbledhje të rregullta, ka formuar 7 grupe punuese, të cilat kanë mbajtur 20 takime pune si dhe janë realizuar 19 vizita në terren. Në mbledhjet e komisionit janë ftuar ministrat e resorëve përkatës, udhëheqës të agjencive dhe departamenteve përkatëse si dhe të agjencive të pavarura. Gjithashtu ka bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ndërkombëtare nga fusha e mjedisit dhe bujqësisë.

II. FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, është Komision Funkcional. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, me pylltarinë, me zhvillimin rural, me mjedisin dhe me planifikimin hapësinor.

Fushëveprimi i këtij komisioni përfshin:

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e politikave të zhvillimit të bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor, duke përcjellë modelet më të avancuara bashkëkohore nga këto fusha;
- Shqyrtimin e nivelit të zbatimit të programit të Qeverisë në fushën e bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Bashkëpunimin me komisionet e tjera të Kuvendit, në veçanti me Komisionin për Buxhet e Financa, kur është fjala për financimin dhe për menaxhimin e programeve nga Qeveria;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet e Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Për ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës, me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

III. AKTIVITETET E KOMISIONIT

Për të realizuar planin e vet të punës, Komisioni ka mbajtur 26 mbledhje të rregullta, ka formuar 7 grupe të punës të cilat kanë mbajtur 20 takime pune si dhe janë realizuar 19 vizita në terren. Komisioni ka përfunduar Projektligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nismë e komisionit, ndërsa jashtë planit të punës është duke e shqyrtuar Projektligjin për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obilicit dhe rreth tij. Po ashtu Komisioni ka shqyrtuar Raportin vjetor i punës së Agjencisë për

Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014 dhe Raportin për gjendjen e mjedisit 2015, ndërsa ka përfunduar një mbikëqyrje dhe dy janë në fazën përfundimtare. Gjithashtu, Komisioni ka realizuar konkursin për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

a) Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, mbledhjen e parë konstituive e ka mbajtur më 26 dhjetor 2014, ndërsa planin e punës për vitin 2015 e miratoi në mbledhjen e tretë më 26 janar 2015. Gjatë vitit 2015, Komisioni ka mbajtur 26 mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e Komisionit janë ftuar dhe kanë raportuar: ministrat e resorëve përkatës për bujqësi e mjedis dhe udhëheqës të agjencive e departamenteve përkatëse, si dhe udhëheqës të agjencive të pavarura.

- *Ministri i MBPZHR-së z. Memli Krasniqi*, ka prezantuar në dy mbledhje të Komisionit, më 2 shkurt 2015, në të cilën u diskutua për planet dhe prioritetet e ministrisë për vitin 2015, si dhe më 14 korrik 2015, ku temë e diskutimit ishin grandet dhe subvencionet në bujqësi.
- *Ministri i MMPH-së z. Ferid Agani*, ka prezantuar gjithashtu në dy mbledhje të Komisionit. Më 2 shkurt 2015, ku është diskutuar për planet dhe prioritetet e ministrisë për vitin 2015, si dhe më 29 prill 2015, për problemet e ndotjes së mjedisit dhe gjendjen e mjedisit në zonat ku operojnë ndotësit më të mëdhenj.
- *Drejtori i zyrës së rregullatorit për ujësjellës dhe kanalizim, z. Raif Preteni*, në lidhje me rëndësinë e hartimit të Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit (në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2015).
- *Kryeshefi i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës z. Ahmet Zejnullahu*, ka raportuar për gjendjen e pyjeve (në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2015).
- *Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, z. Idriz Blakaj*, ka prezantuar raportin vjetor të punës së Agjencisë dhe për gjendjen e Komplekseve Memoriale në Kosovë (në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2015).
- *Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, z. Naser Krasniqi*, zëvendëskryeshef, lidhur me cilësinë e grurit të importuar (në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2015).
- *Shoqata e përpunuesve të qumështit, z. Ramadan Memaj*, kryetar në lidhje me problemet e fermerëve të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit (në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2015).

- *Kryetari i Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi, në lidhje me Projektligjin për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij (në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2015).*

Grupet e punës të Komisionit

Komisioni gjatë këtij sesiioni ka ngritur 7 grupe të punës, të cilat kanë mbajtur 20 takime pune dhe 19 vizita në terren.

- Grupi i punës për hartimin e Projektligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e cilësisë së grurit të importuar ;
- Grupi i punës për plotësim ndryshimin e Ligjit për shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz, me interes të veçantë kombëtar;
- Grupi i punës për Monitorimin e mjedisit nga ndotja prej operatorëve të mëdhenj: Ferronikeli, KEK-u dhe Sharrcem-i.
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-029 për Inspektoratit Bujqësor;
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Bazuar në planin e punës për vitin 2015, Komisioni planifikoi shqyrtimin e 11 projektligjeve, prej tyre 10 projektligje bazuar në programin legjislativ të qeverisë për vitin 2015 dhe 1 projektligj të inicuar nga Komisioni. Nga programi legjislativ i Qeverisë asnjë Projektligj nuk është proceduar në Kuvend, ndërsa Projektligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nismë e komisionit ka përfunduar. Jashtë planifikimit, Komisioni është duke e shqyrtuar Projektligjin për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, nismë e 47 deputetëve.

- ***Projektligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit***, nisma legjislative e Komisionit u përkrah në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2015, me miratimin e planit të komisionit për vitin 2015, i cili fillimisht u emërtua si Projektligji për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujës-jellësit, Ujërave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë. Komisioni projektligjin e përfundoi më 27 mars 2015, ndërsa Kryesia e Kuvendit më 14 prill 2015 e dërgoi projektligjin për mendim në Qeveri. Pasi që Qeveria nuk dha mendim për këtë, Projektligji iu shpërnda deputetëve më 8 qershor 2015, ndërsa më 2 korrik 2015, u miratua në parim në seancë plenare. Projektligji është miratuar në seancë më 14 dhjetor 2015.

- **Projektligji për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij**, nismë lëgjislative e deputetit Raif Qela nga Lëvizja për Bashkim dhe grupi 47 deputetëve. Me përfundimin e kryesisë së Kuvendit të datë 20 korrik 2015, Komisioni është ngarkuar që të parqes raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 15.9.2015, i rekomandoi Seancës plenare t'a miratojë, ndërsa Seanca e miratoi më datë 8. 10. 2015. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më; 21.10.2015 ngriti grupin e punës për shqyrtimin e këtij projektligji. Grupi i punës pas vizitës në Komunën e Obiliqit dhe diskutimin me kryetarin e saj, është në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit.

c) **Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese**

Bazuar në planin e punës për vitin 2015, Komisioni kishte planifikuar të shqyrtojë 5 raporte vjetore. Vetëm 3 raporte kanë ardhë, prej tyre dy janë miratuar, një nuk është shqyrtuar akoma. Ndërsa, Raporti Vjetor Këshilli ndërministror i ujëravedhe Raporti për punën e Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore; nuk janë proceduar nga Qeveria në Kuvend.

- **Raporti vjetor i punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014.** Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2015, i propozoi seancës miratimin e këtij Raporti. Raporti u shqyrtua dhe u miratua më 21 maj 2015 në seancën plenare.
- **Raporti vjetor i Rregullatorit për Ujëra dhe kanalizime, për vitin 2014.** Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2015, e pati në rend dite këtë raport, mirëpo, nuk e miratoi për shkak të mungesës së drejtorit, të cilit i ka skaduar mandati më 16 prill 2015.
- **Raporti për gjendjen e mjedisit 2015,** Raporti është shqyrtu në mbledhjen e Komisionit të datës 29.9.2015 dhe i është rekomanduar seancës të mosmiratohet. Më 30 nëntor 2015 Raporti është miratur në seancën plenare.

Shyrtimi i Strategjive dhe Planeve

Bazuar në planin e punës për vitin 2015, Komisioni kishte planifikuar të shqyrtojë 3 strategji sektoriale: Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm; Strategjia shtetërore për ujëra; Strategjia për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore dhe 3 plane: Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis; Plani i veprimit për cilësinë e ajrit; Plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural. Mirëpo asnjëra nga këto dokumente nuk është proceduar nga Qeveria në Kuvend.

d) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Në kuadër të mbikqyrjes së zbatimit të ligjeve në fuqi dhe të institucioneve për zbatimin e politikave strategjike, Komisioni në planin e punës për vitin 2015, kishte planifikuar të mbikqyrë zbatimin e 2 ligjeve: *Ligjin Nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor* i cili është në fazën përfundimtare dhe *Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës*, monitorimi i të cilit nuk ka filluar akoma. Ndërsa jashtë planit të paraparë, Komisioni ka përfunduar *Mbikëqyrjen e cilësisë së grurit të importuar* dhe është në proces të *Monitorimit të mjedisit nga ndotja prej operatoreve të mëdhenj Ferronikel-i, KEK-u dhe Sharrcem-i*.

- **Mbikëqyrja e cilësisë së grurit të importuar.** Komisioninëmbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2015, inicioi mbikëqyrjen e kësaj çështjeje dhe formoi grupin e punës në përbërje: Salih Salihu, kryesues dhe anëtarët: Adem Salihaj, Lahi Brahimaj, Shaip Muja dhe Haxhi Shala. Grupi i punës, pas mbajtjes së disa takimeve dhe vizitave në terren përfundoi raportin me rekomandime, i cili u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen e Komisionit të mbajtur më 19 maj 2015, ndërsa Raporti me rekomandime i Komisionit për cilësinë e grurit të importuar u miratua në seancën e datës 4 qershor 2015.

Tabela 1 Agjenda e takimeve dhe vizitave për mbikëqyrjen e çështjes së cilësisë së grurit të importuar

DATA/ VENDI	AKTIVITETI	SHËNIM
10. 2. 2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Deputetët kanë ngritur në Komision çështjen e grurit dhe miellit të importuar në Kosovë nga Serbia. i cili dyshohet se nuk inspektohet dhe ka cilësi të dyshimtë.
25.2. 2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit bashkë me zyrtarët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë	Komisioni ka ftuar në mbledhje për raportim kryeshefin e AUV-it, në mungesë të tij në takim kanë raportuar zëvendëskryeshefi Naser Krasniqi dhe inspektorët fitosanitarë Izet Imeri dhe Naim Delijaj.
2. 3. 2015 Dogana e Kosovës, Prishtinë	Grupi i punës vizitë në Doganën e Kosovës	Grupi i punës i komisionit, i përbërë nga Sali Salihu, kryesues, Adem Salihaj dhe Haxhi Shala anëtarë, ka vizituar Doganën e Kosovës, me ç'rast është pritur dhe ka biseduar me Drejtorin e Doganës dhe stafin e tij përgjegjës, lidhur me çështjen e importit të grurit si dhe procedurat e importit të grurit. Takimi ka qenë publik dhe i përcjellur nga media.
9.3. 2015 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Prishtinë	Grupi i punës vizitë në AUV- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	Grupi i punës i Komisionit, në përbërje Fikrim Damka, kryetar i Komisionit, Sali Salihu, nënkryetar si dhe Adem Salihaj, anëtar, kanë vizituar AUV-in , me ç'rast janë takuar me kryeshefin ekzekutiv të këtij Agjencioni z.Valdet Gjinovci, si dhe me përgjegjësit e sektorëve të kësaj Agjencie.

10.3. 2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Shqyrtimi dhe analiza e takimit të Komisionit me zyrtarët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të Doganës së Kosovës.
11.3. 2015 Instituti Bujqësor i Kosovës, Pejë	Grupi i punës vizitë në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë	Grupi i punës ka pasur takim me drejtorin e këtij instituti z. Fehmi Geci, ku është njoftuar me të dhënat e nevojshme të analizave të grurit të importuar dhe me paisjet e laboratorit të këtij instituti.
18.3.2015 M&Sillosi Xërxë, Rahovec	Grupi i punës vizitë në M&Sillosi Xërxë, Rahovec	Grupi i punës në përbërje: Sali Salihu, Adem Salihaj dhe Lahi Brahimaj, gjatë vizitës u takua me menaxhmentin e kompanisë „M&Silosit“.
21.4.2015 Kuvendi	Mbledhja e Komisionit	Shqyrtimi i propozim rekomandimeve të Grupit punues lidhur me cilësisë së grurit të importuar
29.4.2015 Kuvendi	Mbledhja e Komisionit	Shqyrtimi i propozim rekomandimeve të grupit punues rreth çështjes së cilësisë së grurit të importuar
19.5.2015 Kuvendi	Mbledhja e Komisionit	Miratimi i rekomandimeve për cilësinë e grurit të importuar
4.6.2015 Kuvendi	Seanca plenare	Miratimi i rekomandimeve për cilësinë e grurit të importuar.

- **Monitorimi i mjedisit nga ndotja prej operatoreve të mëdhenj: Ferronikel-i, KEK-u dhe Sharrcem-i.** Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 19 maj 2015 ngriti grupin e punës për monitorim në përbërje: Shaip Muja, kryesues dhe anëtarët: Lahi Brahimaj, Emilija Redzeqi dhe Salih Salihu. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2015 Rifirmohet Grupi punues në përbërje: Shaip Muja, kryesues dhe Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Redzeqi, Srdjan Popovic, anëtarë. Grupi i punës ka përgatitë dhe ka dërguar pyetësorët për MMPH-në dhe operatorët: KEK, Sharrcem, Feronikel, dhe ka realizuar vizita në Komunën e Hanit të Elezit, Fabrikën e çimentos Sharrcem Titan Group, në Komunën e Drenasit dhe në kompaninë Ferronikeli si dhe në Komunën e Obiliqit dhe në KEK. Grupi i punës akoma nuk e ka përfunduar raportin me rekomandime.

Tabela 2 Agjenda e takimeve dhe vizitave për Monitorimin e mjedisit nga ndotja prej operatoreve të medhenj (Ferronikel, KEK dhe Sharrcem)

DATA/ VENDI	AKTIVITETI	SHËNIM
17.3.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Deputeti Shaip Mujainicoi çështjen së ndotjes së ajrit në komunat e rrezikuara Drenas, Obiliq, Hani i Elezit dhe Mitrovicë
29.4.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Shqyrtimi i gjendjes së mjedisit në rajonin e Drenasit për shkak të ndotjes së mjedisit nga Ferronikeli, me Ministrin e MMPH-së z. Ferid Agani, sekretarin e MMPH-së dhe kryeshefin e Agjencisë për Mbrojtjes së Mjedisit.
19.5.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Themelohet grupi i punes për Monitorimin e ndotjes së mjedisit nga opertaorët e mëdhenj: KEK, Trepca, Sharrcem dhe Feronikel, në përbërje: Shaip Muja, kryesues, Lahi Brahimaj, Emilija Redzeqi dhe Salih Salihu

10.6.2015 Kuvendi	Aktivitet i grupit të punës	<i>Përgatitja dhe dërgimi i pyetjeve sqaruese për MMPH-në dhe operatorët: KEK, Sharrcem dhe Ferronikel</i>
30.6.2015 Kuvendi	Takim i grupit të punës	<i>Njoftimi i kryesuesit të grupit të punës për aktivitetet e deritanishme të ndërmmara nga GP. U njoftuan për përgjegjësit në pyetjet nga ana e MMPH-së, KEK, Sharrcem, Ferronikel dhe Trepeca në lidhje me gjendjen e mjedisit . u vendos që mbledhja e radhës ku do të shyrtohen këto materiale të mbahet më 2.7.2015.</i>
2.7.2015 Kuvendi	Mbledhje e grupit të punës	<i>Shqyrtimi i përgjegjësive dhe materialeve të ardhura nga: MMPH, KEK, Sharrcem, Ferronikel në lidhje me gjendjen e mjedisit U vendos që të behen disa vizita ne terren javen tjeter. Sharrcemi, Ferronikeli, Obiliq dhe 2 operatore te tjere qe kane apliku per leje te integruar mjedisore. Pjesemarres Shaip Muja dhe Emilija Redzeqi. Paraprakisht vizitohen komunat. Do te mbahet nje degjim publik me te gjithë akteret pas perfundimit te kesaj faze.</i>
21.10.2015 Kuvendi	Mbledhje e komisionit	<i>Riformohet grupi i punës për monitorimin e mjedisit nga ndotja prej operatorëve të mëdhenj (Ferronikel, KEK dhe Sharrcem) në përbërje: Shaip Muja, kryesues dhe Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Redzeqi, Srdjan Popovic, anëtarë</i>
10.11.2015 Komuna Hani i Elezit	Vizitë pune e grupit të punës	<i>Pjesëmarrës nga grupi i punës: Shaip Muja, Emilija Redzeqi dhe Murat Hoxha. Pjesëmarrës nga komuna: Menduh Vlashi, nënkryetar, Miqail Vila, drejtor i urbanizimit, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit, Bashkim Sopa, zyrtar për informim</i>
10.11.2015 Fabrika e çimentos Sharrcem Titan Group, Hani i Elezit	Vizitë pune e grupit të punës	<i>Pjesëmarrës nga grupi i punës: Shaip Muja, Emilija Redzeqi dhe Murat Hoxha. Pjesëmarrës nga kompania: Enver Curri, menaxher i prodhimit dhe Halil Berisha menaxher për mjedis në Sharrcem, Pjesëmarrës nga komuna: Menduh Vlashi, nënkryetar dhe Miqail Vila, drejtor i urbanizimit, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit</i>
18.11.2015 Komuna e Drenasit	Vizitë pune e grupit të punës	<i>Pjesëmarrës nga grupi i punës: Shaip Muja, Murat Hoxha. Pjesëmarrës nga komuna: Nexhat Demaku, kryetar, Betim Berisha, Skender Hasi dhe Xheme Binaku, drejtore si dhe Xhavit Drenori, keshillatar komunal</i>
Fabrika e Ferronikelit	Vizitë pune e grupit të punës	<i>Pjesëmarrës nga grupi i punës: Shaip Muja, Murat Hoxha Zv.Drejtori i Ferronikelit, Gani Canolli, Agron Veliu</i>
25.11.2015 KEK	<i>Vizitë pune e grupit të punës</i>	<i>Pjesëmarrës nga grupi i punës: Shaip Muja, Murat Hoxha Takim me drejtorin e KEK-ut Arben Xhuka</i>

- **Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-029 për Inspektoratin e Bujqësisë.** Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2015 ngriti Grupin e punës për mbikëqyrjen e këtij ligji në këtë përbërje: Sali Salihu, kryesues, Lahi Brahimaj, Adem Salihaj dhe Haxhi Shala, anëtarë. Në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2015 bëhet riorganizimi i Grupit punues: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtar. Grupi i punës ka përgatitur planin e veprimit për mbikëqyrje si dhe ka hartuar pyetësorin për zbatimin e këtij ligji për MBPZHR-në dhe komunat. Janë vizituar 9 komuna, ndërsa pyetësori i'u është dërguar të gjitha komunave. MBPZHR-ja dhe 10 komuna janë përgjegjë në pyetësorin për zbatimin e këtij ligji. Grupi i punës është në fazën e përgatitjes së raportit me rekomandime.

Tabela 3 Agjenda e takimeve dhe vizitave për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor

DATA/ VENDI	AKTIVITETI	SHËNIM
26.1.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Miratohet plani i punës së Komisionit, në të cilin parashihet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor.
29.6.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Themelohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-029 për Inspektionin Bujqësor. Përberja e grupit të punës: Salih Salihu-kryesues, Adem Salihaj dhe Lahi Brahimaj
7.7.2015 Kuvendi	Aktiviteti i grupit të punës	Grupi i punës përgatiti planin e veprimit dhe një pyetësor për Minsitrinë e Bujqësisë.
7.9.2015		MBPZHR dërgon përgjegjet në pyetësorin e dërguar
21.10.2015 Kuvendi	Mbledhje e Komisionit	Në mbledhje bëhet riorganizimi i grupit të punës: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha, Emilija Redzeqi, anëtare
29.10.2015 Kuvendi	Mbledhje e grupit të punës	Pjesëmarrës: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi, anëtar U vendos per orarin e vizitave ne disa komuna
29.10.2015 Komuna e Prishtines	Takim me inspektoratin e bujqesise	Pjesëmarrës nga grupi punues: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtarë. Pjesëmarrës nga komuna: Avdush Gashi-inspektor i bujqesise (fitosanitar), Hafiz Halili- shef I sektorit sanitar veterinar dhe Haki Shala
4.11.2015 Komuna e Mitrovices	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues I Komisionit:: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtarë. Takim me z. Safet Kamberi, nënkryetar i Komunes, Nasuf Aliu drejtor per bujqesi dhe zhvillim rural, Naim Bajra drejtor per inspektorat, Sead Gashi, drejtor per mjedis e pylltari
4.11.2015 Komuna e Pejes	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues I Komisionit: Adem Salihaj-kryesues, Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtarë. Takim me z. Gazmend Muhaxheri,kryetar i Komunes, Demë Dashi drejtor i inspektionit, Mehdi Mulaj drejtor bujqësi dhe hidroekonomi
6.11.2015 Komuna e Mamushës	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues i Komisionit: Adem Salihaj-kryesues dhe Emilija Redzeqi anëtarë. Takim me z. Arif Bytyq, kryetarin e Komunes, Agim Morina, drejtor.
6.11.2015 Komuna e Gjakovës	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues i Komisionit: Adem Salihaj-kryesues dhe Emilija Redzeqi anëtarë. Takim me znj. Mimoza Kusari-Lila, kryetare e Komunes, Mentor Sylmeta drejtor i inspektoriatit, Bekim Ermeni, drejtor per bujqesi, pylltari dhe zhvillim rural
11.11.2015 Komuna e Prizrenit	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues i Komisionit: Adem Salihaj-kryesues , Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtarë Takim me kryetarin e Komunes Z. Ramadan Muja dhe drejtoret e bujqesisë dhe drejtori per inspektion
11.11.2015 Komuna e Shterpces	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues i Komisionit: Adem Salihaj-kryesues ,Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi anëtarë Takim me zv.kryetarin e Komunes dhe drejtorin per sherbime publik
13.11.2015 Komuna e Gjilanit	Vizitë pune e grupit të punës	Pjesëmarrës nga Grupi punues I Komisionit: Adem Salihaj-kryesues dhe Murat Hoxha anëtarë. Takim me z. Rexhep Kadriu Nënkryetar i Komunes, Ramiz Ramadani, drejtor i drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari
13.11.2015 Komuna e Ferizajit	Vizite pune e grupit të punës.	Pjesëmarrës nga Grupi punues I Komisionit: Adem Salihaj-kryesues dhe Murat Hoxha anëtarë Takim me kryetarin e Komunes z. Muharrem Svarqa dhe drejtorin për bujqësi

e) Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2015, mori vendimin për shpalljen e konkursit dhe caktoi kriteret për zgjedhjen e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim. Më 13 shkurt 2015 iu drejtua Kryesisë së Kuvendit me Kërkesën për lejimin e shpalljes së konkursit. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 16 shkurt 2015 shqyrtoi kërkesën e Komisionit dhe ngarkoi administratën e Kuvendit që të shpallë konkursin. Komisioni, pasi pranoi dhe shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve më 19 mars 2015 Komisioni në përbërje prej 7 anëtarëve, mbajti intervistën me 11 kandidatët. Në mbledhjen e mbajtur më 1 prill 2015 në bazë të vlerësimit vendosi që Kuvendit ti dërgojë kandidatin Sabrije Abazi, si kandidat më i suksesshëm sipas rezultateve të poentimit, e cila u zgjodh në seancën plenare të datës 16 prill 2015.

f) Vizitat e komisionit brenda vendit

Komisioni gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve ka realizuar gjithsejt 19 vizita brenda vendit. Në kuadër të mbikëqyrjes së çështjes së grurit të importuar, ka realizuar 4 vizita; në kuadër të Mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-029 për Inspektoratin e Bujqësisë ka realizuar 9 vizita; në kuadër të monitorimit të mjedisit nga ndotja prej operatoreve të mëdhenj: ka realizuar 5 vizita dhe 1 vizitë në kuadër të nismës për plotësim ndryshimin e Ligjit për shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz me interes të veçantë kombëtar.

g) Vizitat e komisionit jashtë vendit

Delegacioni i Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Republikës së Kosovës në përbërje: Fikrim Damka- kryetar, Adem Salihaj dhe Emilija Redzeqi anëtar, mori pjesë në seminarin inter-parlamentar të organizuar nga Parlamenti Evropian në Bruksel, më 9 dhjetor 2015. Temë e seminarit ishte “*Reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) e vitit 2013: implikimet për vendet e zgjerimit*”, me anëtarët e parlamenteve të vendeve të parantarësimit dhe të Parlamentit Evropian. Në seminar morën pjesë edhe delegacionet e parlamenteve nga: Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Turqia, Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian.

Seminarin e udhëhoqi Z. *Czesław Siekierski*, deputet i Parlamentit Evropian dhe kryetar i Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Për rolin e Parlamentit Evropian në reformat e Politikës së Përbashkët Bujqësore, referoi Znj. *Mairead McGuinness*, zëvendës kryetare e Parlamentit Evropian dhe anëtare

e Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Përmbajtjen dhe parimet kryesore të reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore e prezntoi Z. **Joost Korte**, zëvendës drejtor i Drejtorisë së përgjithshme të Bujqësisë nga Komisioni Evropian. Për pjesën e parë të reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore - pagesat direkte, referoi Znj. **Clara Eugenia Aguilera Garcia**, deputete e Parlamentit Evropian dhe zëvendës kryetare e Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Për pjesën e dytë të reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore - organizimi i tregut të përbashkët, referoi Z. **Michel Dantin**, deputet i Parlamentit Evropian dhe anëtar i Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Për pjesën e tretë të reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore –zhvillimi rural, referoi Z. **Nicola Caputo**, deputet i Parlamentit Evropian dhe anëtar i Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Për pjesën e katërt të reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore- Rregullimi i financimit, menaxhimit dhe monitorimit, referoi Z. **James Nicholson**, deputet i Parlamentit Evropian dhe anëtar i Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Për implementimin dhe perspektivën e reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore referoi Z. **Phil Hogan**, Komisioner për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Komisioneri Hogan dhe anëtarët e Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural, i'u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve në seminar, në të cilën edhe delegacioni i Kosovës ishte mjaft aktiv.

h) Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit

Kryetari i Komisionit, në kuadër të bashkëpunimit është takuar me ambasadorën e Zvicrës në Kosovë, znj. Krystyna Marty, me të cilën ka shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjes në sektorin e ujërave. Gjithashtu, ka takuar disa organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare siq janë: Qendra Rajonale e Mjedisit zyra në Kosovë (REC) për mbështetjen e mundshme në realizimin e planit të punës së Komisionit për sektorin e mjedisit, KDI dhe DfD, për mundësinë e mbështetjes së mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, me CNVP (Menaxhimi i Resurseve Natyrore), organizatë ndërkombëtare, për mbështetjen rreth projektligjit të pyjeve. Anëtarët e Komisionit janë takuar me dy profesorë nga SHBA-ja, ku kanë bashkëbiseduar për shërbimet këshillimore në bujqësi.

IV. REZYME - Pasqyrimi në formë tabelare i indikatorëve matës të punës së komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	26
2	Numri i pikave të rendit të ditës	103
3	Procesverbale të hartuara	25
4	Projektligje të shqyrtuara	1

5	Numri i grupeve të formuara të punës	7
6	Numri i mbledhjeve të grupeve të punës	20
7	Numri i amendamente të propozuara	14
8	Numri i amendamente të shqyrtuara	3
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	1
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	-
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	2
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	-
13	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	8
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	19
16	Dëgjime publike	-
17	Monitorimi i ligjeve	1
18	Nisma legislative e Komisionit, <i>Projektligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit,</i>	1
19	Raportimi i Ministrit të <i>MMPH-së</i>	2
20	Raportimi i Ministrit të <i>MBPZHR-së</i>	2
21	Raportimi i drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Përkujtimore të Kosovës	1
22	Raportimi i drejtorit të zyrës së Rregullatorit për ujësjellës dhe kanalizim	1
23	Raportimi i Kryeshefit të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës	1
24	Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës	1
25	Konkursi për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim	1

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Përbërja Komisionit:

1	Daut Haradinaj	kryetar	GP- AAK
2	Fadil Demaku	zëvendëskryetari parë	GP- PDK
3	Boajn Mitiq	zëvendëskryetar i dytë	GP- LS
4	Ganimete Musliu	anëtare	GP- PDK

5	Anton Quni	anëtar	GP- LDK
6	Nuredin Ibishi	anëtar	GP- LDK
7	Rexhep Selimi	anëtar	GP- VV
8	Zafir Berisha	anëtar	GP- Nisma
9	Qerim Bajrami	anëtar	GP- 6+

I. Hyrje

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë (më tutje Komisioni), është Komision Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjegjës për shqyrtimin e legjislacionit për sektorin e sigurisë dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar ndaj këtij sektori.

Me qëllim të pasqyrimin të punës së tij gjatë vitit 2015, Komisioni e ka hartuar Raportin vjetor, i cili pasqyron aktivitetet që i ka realizuar gjatë këtij viti.

II. Fushëveprimi Komisionit

Çështjet kryesore të fushëveprimit të Komisionit përfshijnë:

- shqyrtimin e ligjeve, strategjive dhe dokumenteve të politikave të sigurisë, që paraqiten nga institucionet e sigurisë;
- ushtrimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar të institucioneve të sigurisë;
- seanca dëgjimore dhe raportuese, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, vizita në terren;
- kontrollin e buxhetit të sektorit të sigurisë sipas mënyrës së paraparë me ligj;
- shqyrtimin e çështjeve tjera, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit, i barten Komisionit për shqyrtim.

III. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të planit të tij vjetor të punës, të miratuar në fillim të vitit. Aktivitetet janë realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, monitorimit të zbatimit të ligjeve, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre.

Plani i punës së Komisionit ka paraparë këto objektivat kryesore:

- shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve përkatëse;
- dëgjime publike dhe forma të tjera të komunikimit dhe të bashkëpunimit, me qëllim të miratimit të ligjeve sa më cilësore;
- mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve (së paku një ligj brenda vitit kalendarik);
- të trajtojë tema aktuale nga fusha e sigurisë dhe nga fushat e tjera përkatëse që i përcjell Komisioni;

- ngritjen e cilësisë së punës dhe të bashkëpunimit të brendshëm, dhe shkëmbimet e përvojave me komisionet homologe.

1. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë periudhës janar-dhjetor 2015, ka realizuar gjithsej 25 (njëzet e pesë) mbledhje të rregullta. *Mbledhjen e tij të parë e ka mbajtur më 23.12.2014*, që është aktiviteti i parë i tij dhe fillimi i funksionimit të tij, si Komision Funkcional i Kuvendit të Kosovës për legjislaturën V. Gjatë punës së vet, Komisioni ka zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare. Punën e Komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e OSBE-së, NDI-së, KDI-së DCAF-it, EULEX-it dhe QKSS-ja. Po ashtu, puna e Komisionit është pasqyruar edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

2. Tryezat e punës

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka mbajtur 4 (katër) tryeza të punës, i mbështetur nga OSBE-ja dhe DCAF-i:

- Tryeza lidhur me shqyrtimin e planit vjetor të punës dhe planifikimit të aktiviteteve, më 27 janar 2015, Pejë, e mbështetur nga OSBE.
- Tryezënmbi çështjet dhe sfidat në llogaridhënien e shërbimeve të inteligjencës në shoqëritë demokratike– klasifikimi i informacioneve dhe verifikimi sigurisë, më 1 prill 2015, Prishtinë, mbështetur nga DCAF.
- Siguria Kibernetike-sfidat e qeverisjes demokratike dhe implikimet për mbikëqyrjen parlamentare dhe roli i Kuvendit të Kosovës, 6 tetor 2015, mbështetur nga DCAF.
- Tryeza lidhur me integritetin e policisë, 10 dhjetor 2015, Prishtinë, mbështetur nga DCAF.

3. Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar 4 (katër) projektligje, që janë miratuar nga Kuvendi.

- Projektligjin nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;
- Projektligjin nr.05/L-22 për armë;
- Projektligjin nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri;
- Projektligjin nr. 05/L-15 për letërnjoftim.

4. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar 3 (tri) raporte të institucioneve përkatëse:

- Raportin vjetor të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës për vitin 2014;
- Raportin vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014;

- Raportin e Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2014.

5. Seancat raportuese/dëgjimore:

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka organizuar 12 seanca raportuese:

- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme në 2 (dy) raportime;
- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në 3 (tre) raportime;
- Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në 1 (një) raportim;
- Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës në 2 (dy) raportime;
- Kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (një) raportim;
- Kryeshefi i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave 1 (një) raportim;
- Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës 1 (një) raportim;
- Mbikëqyrësi kryesor shtetëror i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 1 (një) raportim.

6. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka realizuar 3 (tri) dëgjime publike:

- më 2 shkurt 2015, dëgjimi publik me Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- më 21 prill 2015, dëgjimin publik lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, me akteret e përfshirë në zbatim dhe organizatat e shoqërisë civile;
- më 15 dhjetor 2015, dëgjimin publik lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.

7. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2015, bërë mbikëqyrjen e 1 (një) ligji.

- Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.

8. Vizitat e Komisionit brenda vendit

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka realizuar katër (4) vizita në terren:

- Vizitë punë në Komandën e Brigadës së Reagimit të Shpejt të FSK-së, Istog, më 10 mars 2015;
- Vizitë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (30 qershor);
- Vizitë në Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës të FSK (29 qershor);
- Vizitë në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren (8 nëntor).

9. Vizitat e Komisionit jashtë vendit

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka realizuar 4 (katër) aktivitete jashtë vendit:

- Vizita në Turqi e kryetarit të Komisionit për pjesëmarrjen në sesionet e Komisionit të Përgjithshëm për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Sigurinë në Asamblenë

Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp), datë 08-10 shkurt 2015.

- Pjesëmarrja e kryetarit të Komisionit në vizitën studimore në Slloveni, me temën: “Qasja në dokumente publike dhe mbrojtja e të dhënave personale”, më 12-15 prill 2015.
- Vizita studimore e Komisionit në Kroaci, datë 5-8 korrik 2015, mbi qeverisjen dhe llogaridhënien e sektorit të sigurisë.
- Pjesëmarrje në konferencën, rajonale, të mbajtur në Beograd, me temën: ”Bashkëpunimi rajonal parlamentar rreth krizës së migrimit”.

10. Takimet e Komisionit dhe kryetarit

Komisioni dhe kryetari, gjatë vitit 2015, kanë realizuar shumë takime dhe ato më kryesoret janë si vijon:

- Takimi i Komisionit me komisionarin e Parlamentit Gjerman për Forcat e Armatosura, dr. Hans-Peter Bartels, më 23 qershor 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, më 23 janar 2015.
- Takimi i kryetarit me përfaqësues nga DCAF (Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik), më 26 janar 2015.
- Takimi i kryetarit me përfaqësues nga kolegji ISPE, më 20 janar 2015.
- Takimi i kryetarit me përfaqësues nga OSBE- Kosovë, më 16 janar 2015.
- Takimi i kryetarit me përfaqësues nga KDI (Instituti Demokratik i Kosovës), më 24 dhjetor 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me përfaqësues të Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik (DCAF), më 3 shkurt 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me drejtorin e Ekipit Këshillues të NATO-s në MFSK, më 12 shkurt 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me studentët ndërkombëtarë, më 16 shkurt 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, më 22 shkurt 2015.
- Takimi i kryetarit me ambasadorin e Zvicrës, më 27 shkurt 2015.
- Takim i kryetarit me ambasadorin e Turqisë, më 11 mars 2015.
- Takimi i kryetarit të Komisionit me përfaqësuesit nga OSBE-ja, më 27 shkurt 2015

IV. Rezime e punës së Komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	25
2	Numri i pikave të rendit të ditës	96
3	Procesverbale të hartuara	25
4	Projektligje të shqyrtuara	4

5	Numri i grupeve punuese të formuara	5
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	18
7	Numri i amendamente të propozuara	74
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	85
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	4
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	3
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	1
13	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	7
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	4
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	6
16	Dëgjime publike	3
17	Monitorimi i ligjeve	1
18	Seanca dëgjimore/raportuese	12
19	Tryeza pune	4
20	Takimet kryesore të Komisionit dhe kryetarit	20

Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit¹⁸

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të marrë në mbledhje plenare, datë 18 dhjetor 2014, për formimin e komisioneve parlamentare, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, ka këtë përbërje dhe strukturë:

1. Haxhi Shala,	GP-NISMA
kryetar i Komisionit	
2. Rrustem Berisha,	GP-AAK
zëvendëskryetar i parë i Komisionit	
3. Duda Balje,	GP-6+
zëvendëskryetare e dytë e Komisionit	
4. Nuredin Lushtaku,	GP-PDK
anëtar i Komisionit	
5. Rafet Rama,	GP-PDK
anëtar i Komisionit	
6. Milazim Haliti,	GP-LDK
anëtar i Komisionit	
7. Melihate Tërmkollli,	GP-LDK
anëtare e Komisionit	

¹⁸ Me Vendimin nr. 05-V-035, datë 27 mars 2015, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, deputetja Melihate Tërmkollli emërohet anëtare e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, kurse me Vendimin nr. 05-V-190, datë 30 nëntor 2015, të Kuvendit të Kosovës, deputeti Nenad Rashiq emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në vend të deputetit Slavko Simiq.

8. Aida Dërguti, anëtare e Komisionit	GP-VV
9. Nenad Rashiq, anëtar i Komisionit	GP-LS

I. Hyrje

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, (më tutje Komisioni) është Komision Funkcional i Kuvendit të Kosovës, përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, (më tutje AKI).

Komisioni është themeluar me vendim të mbledhjes plenare, të datës 18 dhjetor 2014. Themelimi dhe funksionimi i Komisionit bazohet në dispozitat e Rregullores së Kuvendit, respektivisht kreu XIV, ku përcaktohen rregullat për funksionin e komisioneve. Për me tepër, gjatë procedimit apo trajtimit të një çështje në Komision, e cila proceduralisht, nuk është mbuluar me dispozitat e lartpërmendura, atëherë në mënyrë analoge zbatohen dispozitat për mbledhjen plenare.

Dinamikën e aktiviteteve për vitin 2015, Komisioni i ka përcaktuar dhe realizuar në përputhje me planin e tij të punës, të cilin e ka miratuar në fillim të vitit, ku përfshihen të gjitha aktivitetet në formë tabelore, objektivat, fushëveprimi dhe rregullat për funksionimin e brendshëm.

II. Fushëveprimi i Komisionit

Komisioni, në cilësinë e Komisionit Funkcional, është përgjegjës:

- për mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- për shqyrtimin e raporteve të Kryeministrit për çështjet në kuadër të kompetencave të tij, që lidhen me Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, duke përfshirë veprimet e ndërmarra për korrigjimin e çfarëdo problemi në Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, të vënë në pah nga ndonjë inspektim, auditim ose hetim;
- për shqyrtimin e raporteve të drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, përkitazi me operacionet dhe shpenzimet e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës;
- për shqyrtimin e raporteve të inspektorit të përgjithshëm;
- për sigurimin e një mendimi mbi propozim buxhetin e detajuar për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës;
- për kërkim dhe hetim të informatave, përkitazi me punën e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në përputhje me nenin 37 të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit gjatë vitit 2015, kanë qenë si vijon:

a. Mbledhjet e Komisionit

Mbledhja e parë konstituive e Komisionit është mbajtur më 26 dhjetor 2014. Më tej, Komisioni ka vazhduar me realizimin dhe mbajtjen e mbledhjeve të rregullta, në përputhje me planin e punës për vitin 2015 dhe në bazë të çështjeve që ndërliken drejtpërsëdrejti me fushëveprimin e Komisionit, gjithnjë duke zbatuar procedurat e parapara me Ligjin për AKI dhe Rregulloren e Kuvendit. Në

përgjithësi, që nga konstituimi e deri në përfundim të vitit 2015, Komisioni ka mbajtur 14 (katërbëdhjetë) mbledhje të rregullta.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

Gjatë këtij viti, Komisioni, në cilësinë e Komisionit kryesor, nuk ka pasur në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit ndonjë projektligj.

Në cilësinë e Komisionit Funkcional, Komisioni, bazuar në dispozitën e nenit 62, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e një akti nënligjor - Rregulloren e punës së tij.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Gjatë vitit 2015, Komisioni nuk ka pasur për shqyrtim ndonjë raport vjetor për punën e institucionit të cilin e mbikëqyrë, përveç raportimeve gojore të stafit drejtues të Agjencisë, në bazë të *kërkesës specifike*, që përcaktohet me nenin 5, paragrafi 7, pika (XIV), nenin 9, paragrafi 6 dhe nenin 37, paragrafi 5, që ndërlihet me ndonjë aktivitet të AKI-së.

Në përgjithësi, raportime të këtij lloji, raportime gojore të stafit menaxhues të AKI-së, gjatë vitit 2015, kanë qenë 5 (pesë). Një raportim i zëvendës drejtorit të AKI-së, më 6.2.2015, 3 (tre) raportime të drejtorit të AKI-së, më 3.3.2015, 8.6.2015 dhe 18.11.2015, si dhe 1 (një) raportim i inspektorit të përgjithshëm të AKI, datë 5.10.2015.

d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Në këtë vit, Komisioni nuk ka pasur për shqyrtim kërkesa të ndonjë institucioni publik apo privat.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Gjithashtu, Komisioni gjatë vitit 2015, nuk ka pasur të organizuar dhe të realizuar ndonjë dëgjim publik.

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2015, në planin e tij të punës ka pasur të përcaktuar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, mirëpo në mbledhjen e Komisionit, të datës 12 maj 2015, procesi i mbikëqyrjes së zbatimit është shtyrë për sesionin vjeshtor.

Për më tepër, në mbledhjen e Komisionit, të datës 29 shtator 2015, Komisioni ka marrë vendim për fillimin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë. Lidhur me këtë, mbikëqyrja e zbatimit të këtij Ligji është ende në proces.

g. Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit

Brenda vendit, Komisioni ka realizuar vizitat, si në vijim:

- Vizitë zyrtare në selinë qendrore të AKI-së, më 23 mars 2015 dhe 2 dhjetor 2015.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Gjilan, më 15 prill 2015.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Pejë, më 27 maj 2015.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Prizren, më 21 shtator 2015.

Jashtë vendit, Komisioni, respektivisht një numër i anëtarëve të Komisionit, në mbështetje të Qendrës së Gjenezës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), kanë realizuar një vizitë studimore me temën: **“Qeverisja dhe llogaridhënia e sektorit të sigurisë”**. Vizita studimore është realizuar në Zagreb, Kroaci, nga data 5-8 korrik 2015.

Gjithashtu, me ftesë të Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), një delegacion prej 3 (tre) anëtarësh të Komisionit ka qenë i caktuar që të marrë pjesë në **tryezën e parlamenteve të rajonit për mbikëqyrjen e inteligjencës në Ballkanin Perëndimor**, e organizuar nga DCAF në Lubjanë, më 15 dhjetor 2015, mirëpo nuk është realizuar pjesëmarrja, për shkak të zhvillimit të punimeve të seancës plenare, më 14 dhjetor 2015.

h. Pjesëmarrja e Komisionit në tryeza të rumbullakëta brenda vendit

Gjatë vitit 2015, Komisioni për AKI ka marr pjesë në 2 (dy) tryeza të rumbullakëta brenda vendit të cilat janë, si me poshtë:

- Tryezë e rumbullakët me temë: **“Çështjet dhe sfidat në llogaridhënien e shërbimeve të inteligjencës në shoqëritë demokratike”**, e realizuar nga data 31 mars – 1 prill 2015, në Prishtinë.
- Tryezë e rumbullakët me temë: **“Siguria kibernetike - sfidat për qeverisjen demokratike, implikimet e mbikëqyrjes parlamentare dhe roli i Kuvendit të Kosovës”**, realizuar më 6 tetor 2015, në Prishtinë.

i. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Në këtë vit, Komisioni nuk ka pritur ndonjë delegacion të huaj parlamentar, në cilësinë e homologut.

j. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit

Kryetari i Komisionit ka realizuar një takim individual me përfaqësuesit e UNDP-së në Kosovë, më 23 janar 2015. Ndërsa, takime individuale të anëtarëve të tjerë të Komisionit gjatë këtij viti, nuk ka pasur, përveçse një takim i përbashkët i Komisionit me përfaqësuesit e Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), realizuar më 3 shkurt 2015.

IV. Rezume e punës së Komisioni

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	14
2	Numri i pikave të rendit të ditës	52
3	Procesverbale të hartuara	13
4	Projektligje të shqyrtuara	/
5	Numri i grupeve punuese të formuara	2
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	3
7	Numri i amendamenteve të propozuara	/
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	/
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	/
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
13	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	5
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	5
16	Dëgjime publike	/
17	Monitorimi i ligjeve	/
18	Raportimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të AKI-së	4

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Hyrje

Fushëveprimtaria e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit

- b. Mbledhjet e Komisionit
- c. Shqyrtimi i Projektligjeve
- d. Shqyrtimi i Raporteve të auditimit të organizatave buxhetore
- e. Rekomandimet e Komisionit për organizatat buxhetore
- f. Mbajtja e dëgjimeve publike
- g. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit
- h. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)
- i. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit

Rezyme e punës së komisionit

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2015, të Legjislaturës V, ka punuar në këtë përbërje, siç është paraqitur në tabelë:

1	Besnik Bislimi	kryetar	GP- VV
2	Ali Sadriu	zëvendëskryetar i parë-	GP- LDK
3	Duda Balje	zëvendëskryetaree dytë	GP- 6+
4	Naim Fetahu	anëtar	GP- PDK
5	Adem Grabovci	anëtar- deri me 14 dhjetor 2015	GP- PDK
6	Hajdar Beqa	anëtar	GP- PDK
7	Synavere Rysha	anëtare	GP- LDK
8	Bali Muharremaj	anëtar	GP- AAK
9	Fatmir Limaj	anëtar – deri me 13 shkurt 2015	GP- NISMA
	Valdete Bajrami	anëtare- prej 13 shkurt 2015 deri me 24 tetor 2015	
	Enver Hoti	anëtar – prej 24 tetor 2015	

I. HYRJE

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është Komisioni Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i tij është të mbikëqyrë shpenzimin e parasë publike nga Organizatat Buxhetore të cilat në mënyrë direkte ose indirekte financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij në Legjislaturën V, Komisioni e ka hartuar Raportin vjetor për vitin 2015, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe për punët që i ka realizuar gjatë këtij viti, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

II. FUSHVEPRIMI I KOMISIONIT

Fushëveprimtaria dhe kompetencat e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, janë të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, si në vijim:

- mbikëqyrja e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë publike në bazë të raporteve dhe pasqyrave vjetore dhe periodike të audituara si dhe raportet e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrja të gjitha raporteve të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike;
- mbikëqyrja e raporteve të performancës, të hartuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- mbikëqyrja e raporteve të audituara dhe të performancës së shpenzimeve financiare të hartuara nga institucionet mbikëqyrëse të fondeve publike, agjencive publike, ndërmarrjeve publike, dhe institucioneve publike të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike përmes raporteve të Njësisë Qendrore Harmonizuese (NjQH), të cilat përmes Ministrisë së Financave i dërgohen Kuvendit dhe këtij Komisioni;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike, nëpërmjet raporteve të agjencive buxhetore, me kërkesë të veçantë të Komisionit;
- shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- kryerja e veprimeve në procedurën e përzgjedhjes së auditorëve të jashtëm, të cilët do të bëjnë auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- shqyrtimi i nevojave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa;
- mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i tij;

Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

III. AKTIVITETET E KOMISIONIT

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka punuar sipas Rregullores së Kuvendit, sipas Rregullave të Procedurës të Komisionit dhe sipas Planit të Punës së Komisionit.

Këto aktivitete Komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit, më qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre.

a) Mbledhjet e Komisionit

Komisioni gjatë vitit 2015, të Legjislaturës V, i ka realizuar gjithsej 21 (njëzetënjë) mbledhje të rregullta. Mbledhjen e tij të parë në Legjislaturën V e ka mbajtur më 24 dhjetor 2014. Ndërkaq mbledhja e fundit e Komisionit për vitin 2015, është mbajtur më 10 dhjetor 2015.

Në shumicën e mbledhjeve të Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, përveç kur Komisioni ka vendosur ndryshe dhe janë mbikëqyrur nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e Komisionit e kanë mbështetur dhe vëzhguar përfaqësuesit e GIZ-it, OSBE-së, KDI-së, GLPS, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni gjatë vitit 2015, të Legjislaturës V i ka shqyrtuar:

1. Ka shqyrtuar dhe ka miratuar në parim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, (është në shqyrtim të dytë).

c) Shqyrtimi i Raporteve të auditimit të organizatave buxhetore

Gjatë vitit 2015, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ka proceduar në Kuvend gjithsej 114 Raporte të Auditimit, një Auditim të Performancës së ZAP-it dhe Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit për vitin 2014.

Nga gjithsej 114 raporte, 100 prej tyre janë raporte të auditimit të pasqyrave vjetore financiare, ndërsa 14 prej tyre janë raporte të performancës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka shqyrtuar Raportet e Auditimit të Organizatave Buxhetore, si vijon:

1. Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2013.
2. Raporti i Auditimit për sistemet e prokurimit në sektorin e shëndetësisë.
3. Raporti i Auditimit të Performancës mbi aktivitetet e Policisë së Trafikut dhe Sigurisë në trafikun rrugor.
4. Raporti Vjetor i Performancës së ZAP-it, për vitin 2014.
5. Raporti Vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2014.
6. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014.
7. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integritetit Evropian, për vitin 2014.
8. Raporti i Auditimit të Performancës për Mirëmbajtjen dhe Riparimin e Automjeteve Zyrtare.
9. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Administratës Publike, për vitin 2014.
10. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2014.
11. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Administratës Tatimore të

Kosovës, për vitin 2014.

12. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2014.

13. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2014.

14. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2014.

15. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2014

16. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil.

17. Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014.

18. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për vitin 2014.

19. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vitin 2014.

20. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Gjilanit, për vitin 2014.

21. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2014.

22. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2014.

23. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2014.

24. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Shtërpçës, për vitin 2014.

25. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Novobërdës, për vitin 2014.

26. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Klllokotit, për vitin 2014.

27. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2014.

28. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2014.

29. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Podujevës, për vitin 2014.

30. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Zubin Potok, për vitin 2014.

31. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Graçanicës, për vitin 2014.

32. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Parteshit, për vitin 2014.

33. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Zveçanit, për vitin 2014.

34. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Leposaviqit, për vitin 2014.

35. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Dragashit, për vitin 2014.

36. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2014.

37. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Deçanit, për vitin 2014.

38. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2014.

39. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2014.

40. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2014.

41. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Ranillugut, për vitin 2014.

42. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2014.

43. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2014.

44. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin 2014.

45. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2014.

46. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin 2014.

47. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Vitisë, për vitin 2014.

48. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2014.

49. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin 2014.

50. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Mamushës, për vitin 2014.

51. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Fushë- Kosovës, për vitin 2014.

52. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Rahovecit, për vitin 2014.

53. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Suharekës,për vitin 2014.
54. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit,për vitin 2014.
55. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Mitrovicës,për vitin 2014.
56. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Istogut,për vitin 2014.
57. Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Mitrovicës Veriore,për vitin 2014.
58. Raporti i Performancës Financiare dhe Shërbimeve të ofruara në Komuna në vitin 2014.

d) Rekomandimet e Komisionit për organizatat buxhetore

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatëvitit 2015 të Legjislaturës V, ka nxjerr rekomandime për 12 (dymbëdhjetë) organizata buxhetore:

1. Rekomandim për Kryesinë e Kuvendit për Përzgjedhjen e kompanisë audituese, për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2014.
2. Rekomandim në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për aprovimin e auditorit të jashtëm për auditimin e BQK-së për periudhën 2014-2016.
3. Rekomandim për raportin e auditimit të sistemeve të prokurimit në sektorin shëndetësor.
4. Rekomandim për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.
5. Rekomandim lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2013.
6. Rekomandim për vendimin me propozim të zonjës Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për Kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.
7. Rekomandim për Raportin Vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike të Kosovës për vitin 2014.
8. Rekomandim për Raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare.
9. Rekomandim për Raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Integriteteve Evropiane për vitin 2014.
10. Rekomandim lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014.
11. Rekomandim për Raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,për vitin 2014.
12. Rekomandim për Raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,për vitin 2014.
13. Rekomandim për Kryesinë e Kuvendit për Auditimin e Raporteve Financiare dhe Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës të Subjekteve Politike.

e) Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë vitit 2015 të Legjislaturës V, ka mbajtur tri dëgjime publike:

1. Dëgjim Publik, i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me ministrin e Shëndetësisë, për Raportin e Auditimit të Sistemeve të Prokurimit në Sektorin Shëndetësor.
2. Dëgjim Publik, me ministrin e Financave z.Avdulla Hoti dhe ministrin e Administratës Publike z.Mahir Yagcilar, për Raportin Vjetor të Auditimit,për vitin 2013.
3. Dëgjim Publik,Shqyrtimi i Raportit të Performancës Financiare dhe Shërbimeve të ofruara në Komuna në vitin 2014 dhe Raporteve të auditimit të PVF-ve të Komunave për vitin 2014.

f) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Gjatë vitit 2015 të Legjislaturës V, komisioni i ka pasur dy vizita jashtë vendit:

1. Konferencën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, me temë: “ Parlamentet dhe Mbikëqyrja Buxhetore Financiare në Ballkanin perëndimor”, e mbajtur në Tiranë, me datën 19-22 shkurt 2015.
2. Vizitë studimore në Berlin të Gjermanisë, ku komisioni është njoftuar me sistemin dhe punën e Bundestagut Gjerman, prej datës 7 deri me 12 shtator 2015.

g) Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Gjatë vitit 2015 të Legjislaturës V, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me datën 23.01.2015, ka pasur një takim, me delegacionin e Bundestagut Gjerman, i kryesuar nga znj. Bettina Hagedorn, deputete dhe kryetare e komisionit Parlamentar për Auditim në Parlamentin Gjerman.

h) Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë vitit 2015 të Legjislaturës V, ka pasur disa takime tjera në kuadër të punës së komisionit:

- Më 21.01.2015, Tryezë “Transparenca Buxhetore në Kosovë”, organizuar nga GIZ-i.
- Më 23.01.2015, takim i kryetarit të komisionit, me përfaqësuesit e West Minister Foundation for Democracy.
- Më 03.02.2015, takim i kryetarit me kryetarët e tri komisioneve tjera të Kuvendit, z.Naser Osmani, znj Teuta Sahatçija dhe Muhamet Mustafa.
- Më 12.02.2015, takim me përfaqësuesit e OECD/SIGMA
- Më 13.02.2015, takim i kryetarit me Ambasadorin e Zvicrës znj. Krystyna Marty Lang.
- Më 25.02.2015, Punëtori e organizuar nga ZAP-i, për komisionin me z.Ian Rogers, përfaqësues nga zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar.
- Më 03.03.2015, Punëtori e organizuar nga OSBE, tema: “ Prezentimi i të gjeturave nga monitorimi i punës së KMFP-së nga ana e OSBE-së”.
- Më 26.03.2015, Punëtori e organizuar nga GIZ-i, tema:”Punëtorja me misionin vlerësues në kuadër të evaluimit të projektit të GIZ-it”.
- Më 19.05.2015, tryezë, e organizuar nga GIZ-i, tema:” Reforma në financa publike, krijimi i një sistemi të raportuesve për punën e komisioneve”.
- Më 05.06.2015, zv.kryetari i komisionit, ka marr pjesë në Konferencën përmbyllëse të projektit të binjakëzimit në ZAP.
- Më 9.06.2015, zv.kryetari është takuar me ekipin e PEFA-s.
- Më 09-10 korrik, zv.kryetari, ka marr pjesë në Konferencën e shtatë vjetore të ZAP-it.
- Më 24.06.2015, zv.kryetari ka marr pjesë në Konferencën e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, tema:” Plotësimi i vendeve të lira në bordet e Institucioneve dhe agjencive të pavarura”.
- Më 13.10.2015, komisioni ka marr pjesë në punëtorinë një ditore, të organizuar nga GIZ-i, me temën „Mbështetja e mëtejshme ndaj Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve publike“,
- Komisioni para të gjitha mbledhjeve të rregullta të tij, mban takime përgatitore me përfaqësuesit e ZAP-it.

V. Rezume e punës së komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore të indikatorëve matës të punës së komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhjeve të mbajtura	21
2	Numri i pikëve të rendit të ditës	102
3	Procesverbale të hartuara	20
4	Projektligje të shqyrtuara	1
5	Numri i grupeve punuese të formuara	1
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	/
7	Numri i amendamenteve të propozuara	/
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	/
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	/
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	1
13	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	1
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	/
16	Dëgjime publike	3
17	Raportet e auditimit	58
18	Rekomandimet e komisionit	84

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit:

1. Hyrje,
2. Fushëveprimtaria e Komisionit,
3. Aktivitetet e Komisionit:
 - a) Mbledhjet e Komisionit,
 - b) Shqyrtimi i projektligjeve,
 - c) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese,
 - d) Shqyrtimi i Peticioneve,
 - e) Mbajtja e dëgjimeve publik,
 - f) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve,
 - g) Aktivitetet lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit,
 - h) Aktiviteti për nxjerrjen e Udhëzuesit për Peticione,
 - i) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit,
 - j) Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të komisionit.
4. Rezume e punës së komisionit.

Përbërja e Komisionit:

1	Lirije Kajtazi	Kryetare	(GP- LDK)
2	Salihe Mustafa	Zëvendëskryetare e parë-	(GP- PDK)
3	Slavko Simiq	Zëvendëskryetar i dytë-deri më 30 nëntor 2015	(GP-LS)
	Nenad Rashi	Zëvendëskryetar i dytë-nga 30 nëntori 2015	
4	Mexhide Mjaku-Topalli	Anëtare	(GP- PDK)
5	Etem Arifi	Anëtar	(GP- LDK)
6	Mytaher Haskuka	Anëtar	(GP- LVV)
7	Teuta Haxhiu	Anëtare	(GP- AAK)
8	Valdete Bajrami	Anëtare	(GP- NISMA)
9	Kujtim Paçaku	Anëtar	(GP-6+)

I. Hyrje

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione është Komisioni Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Aktiviteti i Komisionit bazohet në Kushtetutë, ligjet e veçanta dhe Rregulloren e Kuvendit.

Raporti i punës së Komisionit për vitin 2015, përmban aktivitetin e Komisionit brenda fushëveprimit të tij, të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit.

Plani vjetor i punës së Komisionit dhe rendi i ditës së mbledhjeve, janë agjendat ekzekutive të punës së Komisionit.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Çështjet kryesore të fushëveprimit të Komisionit:

- Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione angazhohet për ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij.
- Komisioni mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve, konventave ndërkombëtare dhe rekomandimeve të tjera, nga fushëveprimi i tij.
- Komisioni shqyrton raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe shqyrton zbatimin e rekomandimeve të IAP në fushën e përgjegjësive të Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, në lëmin e zbatimit të ligjeve dhe standardëve, në fushëveprimin e Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare mbështetëse të Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me ekspertë të fushave përkatëse, me qëllim të marrjes së ekspertizave të nevojshme, për çështjet me interes nga fusha e Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me shoqërinë civile dhe mediat, në interes të punës publike dhe transparente dhe të zhvillimit të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut

Zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konventave dhe standardeve ndërkombëtare:

- Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut,
- Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollet e saj,
- Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike të njeriut dhe protokollet e saj,
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor,
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit gjuhësor,
- Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,
- Konventën Evropiane për gjuhë rajonale,
- Konventën Evropiane për gjuhë rajonale dhe minoritare,
- Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare,
- Shqyrtimi i projektligjeve në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimi në baza ligjore,
- Monitorimi i institucioneve ndëshkimore lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut,
- Shqyrtimi i rasteve të shkeljes së të drejtave të qytetarëve gjatë marrjes në pyetje në polici,
- Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në qasje e tyre në institucionet – publike- private lidhur me realizimin e të drejtave të tyre.

Barazia Gjinore

Në pajtim me Ligjin për Barazinë Gjinore, ushtron këto veprimtari:

- Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit për barazi gjinore,
- Mbikëqyrë punën Agjencisë për barazi gjinore,
- Merr nisma për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit dhe të amendamentimit të tij,

- Monitoron marrëveshjet e lidhura ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore,
- Përgatit raporte për kuvend në fushën e barazisë gjinore,
- Bashkëpunon me Ministrinë dhe Zyrat Komunale,
- Monitoron aktet nënligjore dhe përcjell zbatimin e tyre,
- Bashkëpunon me OJQ- të dhe institucionet publike,
- Propozon nisma për kërkime dhe analiza në fushën e barazisë gjinore,
- Ndihmon në ngritjen e vetëdijes mbi barazinë gjinore dhe
- Raporton Kuvendit për punën e Komisionit.

Personat e Pagjetur

Fushëveprimi i Komisionit në këtë fushë është përcaktuar me Vendim të Kuvendit:

- Shqyrton Raportet e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur.
- Zhvillon aktivitete sensibilizuese, mbështetëse dhe koordinuese për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.
- Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Personat e Zhdukur.

Peticionet

Komisioni vepron konform Rregullores së Kuvendit lidhur me:

- Të drejtën e parashtrimin të Peticionit;
- Shqyrtimin e Peticionit;
- Mbledhjen dhe vërtetimin e provave;
- Rekomandimin e Peticionit;
- Nxjerrjen e përfundimit lidhur me Peticionin;
- Përgjigjen në Peticion.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit, gjatë vitit 2015, në pikëpamje substanciale dhe kohore, janë bazuar në Planin e punës, të miratuar në fillim të vitit. Aktivitet janë realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta të Komisionit, mbledhjeve të grupeve punuese, tryezave, vizitave monitoruese në terren, punëtorive dhe takimeve individuale të anëtarëve të Komisionit.

a. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë vitit 2015, ka mbajtur 27 mbledhje të rregullta. Mbledhjen e parë gjatë këtij vitit e ka mbajtur, më 20 janar 2015. Ndërkaq mbledhja e fundit e Komisionit është mbajtur më 22 dhjetor 2015.

Mbledhjet janë mbajtur sipas planit të punës, janë organizuar mirë dhe kanë pasur rrjedhë demokratike.

Mbledhjet janë proceduar sipas Rregullores së Kuvendit dhe kanë përmbajtur 80 pika substanciale të

rendit të ditës.

Në mbledhjet e Komisionit, janë ftuar dhe kanë marrë pjesë Avokati i Popullit, përfaqësuesit e Qeverisë, respektivisht ministrive përkatëse dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera relevante, në vartësi prej agjendës së mbledhjeve të Komisionit.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë përcjellë nga përfaqësuesit e organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare.

Punën e Komisionit e kanë përcjellë mediat e shkruara dhe elektronike.

b. Shqyrtimi i Projektligjeve

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e komisionit funksional.

Komisioni gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar Projektligjet:

1. Projektligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit,
2. Projektligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore,
3. Projektligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
4. Projektligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë,
5. Projektligji Nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Komisioni për secilin projektligj, i ka mbajtur shqyrtimet në parim, konform Rregullores së Kuvendit. Në shqyrtimet në parim, kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Qeverisë dhe përfaqësuesit e ministrive përkatëse, respektivisht udhëheqësit e zyrave të tyre ligjore.

Komisioni, në fund të shqyrtimit në parim, i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e projektligjeve në parim.

Komisioni për secilin projektligj ka formuar grupin e veçantë punues.

Në shqyrtimin e dytë, grupet punuese i kanë propozuar amendamentet, konform Rregullores së Kuvendit. Amendamentet i ka miratuar Komisioni dhe janë proceduar në Kuvend.

Komisioni, për këto tri projektligje, Projektligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Projektligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Projektligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka propozuar 24 amendamente.

Amendamentet e propozuara janë miratuar në Kuvend.

Projektligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë dhe Projektligji Nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Komisioni i ka shqyrtuar në parim dhe i ka propozuar Kuvendit për miratim në parim.

Projektligji Nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është miratuar në parim në Kuvend. Komisioni ka formuar Grupin Punues dhe është në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit.

Projektligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, nuk është miratuar në parim në Kuvend dhe i është kthyer Qeverisë.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese

Komisioni duke u bazuar në fushëveprimin e tij, gjatë këtij viti, ka shqyrtuar:

1. Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për 2014.

Komisioni ka vlerësuar se Raporti i IAP ka qenë përmbajtjesor dhe gjithëpërfshirës. Sfida kryesore për IAP është shkalla e pakënaqshme e zbatimit të rekomandimeve. Raporti i IAP është shqyrtuar dhe miratuar në Kuvend.

2. Raportin e Agjencisë për Barazi Gjinore

Agjencia nuk është institucion raportues i Kuvendit, por Komisioni e ka shqyrtuar raportin për t'u njoftuar me rezultatet dhe sfidat në fushën e barazisë gjinore dhe për të orientuar kahet e mëtejme të aktivitetit të Komisionit.

d. Shqyrtimi i Peticioneve

Gjatë këtij sesioni, Komisioni ka shqyrtuar 9 (nëntë) peticione, të parashtruara në formë të kërkesës ose ankesës. Nga këto nëntë peticione, gjashtë kanë qenë individuale, kurse tri kanë qenë grupore. Dy peticione i janë afruar Kuvendit për miratim të rekomandimeve. Komisioni për çdo peticion, se pari ka formuar grupin punues, i cili ka shqyrtuar pranueshmërinë e peticionit dhe aktivitetet që duhet t'i ndërmerret Komisioni.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni nuk ka mbajtur dëgjime publike, përkundër faktit se kanë qenë të parapara me Planin e punës, për shkak se tri Projektligjet që janë miratuar, kanë kaluar me procedurë të shpejtë.

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni ka bërë mbikëqyrjen zbatimin të Ligjit, konform Planit të punës për 2015.

- Ligji 04/L-092 Për Personat e Verbër.

Komisioni ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe substanciale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, konform Rregullores. Është formuar grupi punues, janë kërkuar aktet nënligjore nga ministritë përkatëse dhe janë zhvilluar vizitat monitoruese në terren. Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-092 Për Personat e Verbër, është miratuar në Kuvend me dt.30.11.2015. Komisioni është në proces të monitorimit të ligjit për Mbrojtje nga dhuna në familje nr. 03 / L – 182.

Aktivitetet lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit

1. Shqyrtimi i ecurive për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Komisioni ka shqyrtuar në një mbledhje të veçantë ecuritë aktuale në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Kosovë.

2. Zhvillimi i procedurave për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit.

Komisioni ka zhvilluar procedurat për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit, konform ligjit dhe Rregullores, dy herë, respektivisht deri në zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Paneli rekrutues për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit ka mbajtur 4 (katër) mbledhje dhe 2 (dy) seanca intervistuese me aplikantët për Avokat të Popullit.

3. Hartimi i Rregullores, për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Komisioni ka formuar Grupin punues për hartimin e Rregullores, për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Komisioni me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm ka votuar, Projektregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit, e cila do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Aktiviteti lidhur me Agjencinë për Barazi Gjinore

Komisioni në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët me temën Promovimi i Ligjit për Barazi Gjinore.

Aktiviteti për nxjerrjen e Udhëzuesit për Peticione

Komisioni është duke përgatitur një Udhëzues për parashtrimin e Peticioneve dhe mënyrën e procedimit të tyre në Komision dhe në Kuvend. Komisioni ka mbajtur 2 (dy) punëtori të veçanta, në Rugovë dhe në Gjakovë, për nxjerrjen e Udhëzuesit për Peticione dhe formularëve përcjellës.

Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit

Vizitat brenda vendit në:

1. Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
2. Shoqatën e Personave të Verbër të Kosovës,
3. Ministrinë e Shëndetësisë,
4. Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë,
5. Ministrinë e Infrastrukturës,
6. Ministrinë e Financave,
7. Shoqatën e Personave të Verbër në Gjilan,
8. Shoqata për Personat e Verbër në Pejë,
9. Shkollën Speciale për Personat e Verbër në Pejë,
10. Kuvendin e Komunës në Pejë,
11. Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetin për Komunitete në Gjakovë,
12. Njësinë për të drejtat e njeriut dhe komitetin në Graçanicë,
13. Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetin për Komunitete në Gjilan,
14. Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetin për Komunitete në Ferizaj,
15. Agjencinë për Barazi Gjinore,
16. Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
17. Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,,
18. Policinë e Kosovës.

Vizitat jashtë vendit:

Komisioni gjatë këtij viti ka bërë një vizitë jashtë vendit.

Dy anëtarë të komisionit kanë marrë pjesë në Konferencën e tretë Rajonale parlamentare për të drejtat e njeriut, organizuar në Sarajevë, më 23-25 nëntor 2015.

g. Takimet individuale të kryetares dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit

Gjatë vitit 2015, janë realizuar këto takime dhe pjesëmarrje:

1. Takim i kryetares së Komisionit me përfaqësuesit e Ambasadës së Zvicrës, në zyrën e kryetares, më 03.03.2015.
2. Takim i kryetares së Komisionit me shefin e UNICEF –it në Kosovë, në zyrën e kryetares, më 10.03. 2015.
3. Pjesëmarrja e Komisionit në Tryezën e organizuar nga UNICEF-i, për prezantimin e gjendjes së fundit të fëmijëve, grave dhe burrave në Kosovë, mbajtur në hotel AFA në Prishtinë, më 31.03.2015.
4. Takim i kryetares së Komisionit me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në zyrën e kryetares, më 07. 04. 2015.
5. Takimi me përfaqësuesit e shoqatave familjare të personave të zhdukur dhe institucioneve e organizatave të angazhuara për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur, ka marrë pjesë Mexhide Mjaku-Topalli- anëtare e Komisionit. Sirius-Prishtinë, më 21.04. 2015.
6. Takim i Komisionit dhe kryetares së Komisionit me shefin e Misionit të OSBE- së në Kosovë, në Kuvend, më 13.05.2015.
7. Pjesëmarrja në mbledhjen e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, Mutaher Haskuka- anëtar i Komisionit, më 08.06.2015.
8. Pjesëmarrja e Komisionit në konferencën e organizuar nga KOMF, në Rings- Prishtinë, më 24.06.2015,
9. Takimi i Grupi punues për shqyrtimin e Peticionit për Mr. Ukshin Hoti me Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur, në zyrën e komisionit qeveritar, më 20.02.2015.
10. Takimi në Ministrinë e Integrimit Evropian,(DPSA), ka marrë pjesë Mexhide Mjaku-Topalli,anëtare e Komisionit, më 06.07 2015.
11. Takim në Ministrinë e Integrimit Evropian(DPSA), ka marrë pjesë Salihe Mustafa, nënkryetare e Komisionit, më 08.07.2015.
12. Takim në Ministrinë e Integrimit Evropian(DPSA), ka marrë pjesë Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, 14.07.2015.
13. Pjesëmarrja në mbledhjen e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Mytaher Haskuka, anëtar i Komisionit, më
14. Takimi me zyrtarët e Agjencisë për Barazi Gjinore, Lirije Kajtazi-kryetare e komisionit, më .29.04.2015.
15. Pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga ABGJ-ZKM, lidhur me Udhëzimin administrativ për regjistrimin e pronës, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, më 09.03.2015.
16. Takim me z. Thomas Melia, ndihmës sekretar i Shtetit (SHBA), Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, 06.02.2015.

17. Takim me përfaqësuesit e USAID, lidhur me programin për të drejtat pronësore, Lirije Kajtazi kryetare e Komisionit, më 02.02.2015.
18. Takimet e deputetëve në Beograd, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, më 01.06.2015.
19. Pjesëmarrja në Punëtorinë dyditore në Prishtinë, për identifikimin dhe arritjen me konsensus për çështjet kryesore që strategjia ndërkombëtare duhet të adresojë- Programi për të Drejtat Pronësore, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, më 22-23.06.2015.
20. Takim me Raportuesen speciale të OKB për strehim adekuat- zonja Leilan Farha, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, 26.05.2015.
21. Vizitë studimore në Kroaci, për Qeverisjen dhe Llogaridhënien në Sektorit Sigurisë, Lirije Kajtazi-Kryetare e Komisionit, më 5-8.07.2015.
22. Takim, Java e Gruas, lidhur me të drejtat pronësore të grave, organizuar nga USAID, Lirije Kajtazi-Kryetare e Komisionit, më 23.03.2015.
23. Pjesëmarrja në Qendrën George Marshall në Gjermani, tema: “Politika dhe Siguria Nacionale”, 18-19-maj 2015.
24. Takim me shoqatat e familjarëve të personave të pagjetur në Gjilan, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit.
25. Takim me personat me sindromin Daun në Kosovë, Lirije Kajtazi-kryetare e Komisionit, më 21 maj 2015,
26. Takim i Komisionit me përfaqësuesit e NDI-së nga Beogradi me temën: Prezantimi i Raportit për komunitetit LGBT në rajon, 6. 10. 2015,
27. Pjesëmarrja e Komisionit në Konferencën e organizuar nga UNICEF-i dhe Enti i Statistikave me temën: Investimi për fëmijët, 19. 10. 2015,
28. Takim i Kryetares me përfaqësuesin e Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë, tema Ligji për Lirinë fetare në Kosovë, 19. 10. 2015,
29. Takim i kryetares me përfaqësuesit e Ambasadës së Shqipërisë, tema: Personat e zhdukur, 23. 10. 2015,
30. Takimi i Komisionit me të dërguarin special të Departamentit të shtetit Amerikan z. Randy Berry, tema: Komuniteti LGBT,
31. Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit në tryezën e rumbullakët të organizuar nga DCAF, tema: Siguria kibernetike- sfidat e qeverisjes demokratike. Implikimet për mbikëqyrjen parlamentare dhe roli i Kuvendit të Kosovës, 6. 10. 2015,
32. Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit në takimin e organizuar nga Ambasada e SHBA-ve, tema: Përkrahja e të drejtave të viktimave, 19. 10. 2015,
33. Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit në takimin e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, tema: Hartimi i Strategjisë Kombëtare për të drejtat pronësore, 23. 10. 2015,
34. Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit në takimin e organizuar UNKT, tema: Lansimi dhe jetësimi i objektivave për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë, 24. 10. 2015,
35. Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit në mbledhjen e Komisionit Qeveritar për personat e zhdukur, 26. 11. 2015,
36. Takim i Komisionit me fëmijët nga OJQ Syri Vizion, tema: Prezantimi i Raportit të monitorimit të zbatimit të Konventës ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, 20. 11. 2015,
37. Takim i kryetares me konsulentin e UNICEF-it, tema: diskutim për pozitën dhe të drejtat e fëmijëve në Kosovë, 7. 10. 2015,

38. Pjesëmarrja e Komisionit në tryezën e organizuar nga IAP, tema: Bashkëpunimi i IAP me njësitet për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, 11. 11. 2015.

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela - Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	27
2	Numri i pikave të rendit të ditës	80
3	Procesverbale të hartuara	26
4	Projektligje të shqyrtuara	5
5	Numri i grupeve punuese të formuara	10
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	18
7	Numri i amendamente të propozuara	24
8	Numri i amendamente të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	3
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	1
12	Shqyrtimi i Peticioneve dhe ankesave	9
13	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	14
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	18
16	Dëgjime publike	/
17	Monitorimi i ligjeve	1
18	Mbledhjet e Panelit rekrutues	4
19	Punëtori për shqyrtimin e Udhëzuesit për Peticione	2
20	Seanca intervistuese me aplikantë për Avokat të Popullit	2
21	Takimet dhe pjesëmarrjet individuale të kryetares dhe anëtarëve	38

Komisionet ad-hoc

Përmbajtja

- I. Hyrje
 - a. Mbledhjet e komisioneve
- II. Rezyme e punës së komisioneve
 - Tabela A

I. HYRJE

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi mund ta formojë një komision ad-hoc, që e ka autoritetin e Komisionit funksional. Komisioni ad-hoc është komision i përkohshëm, i cili merret me shqyrtimin e një çështjeje të veçantë.

Nëse Kuvendi e formon një komision ad- hoc, në vendimin e formimit duhet të përfshihet përbërja e komisionit, në përputhje me nenin 63 të Rregullores.

III. MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Në mbledhje, komisionet kanë shqyrtuar listat e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për anëtarë dhe kanë ftuar për intervistë kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore për të qenë anëtarë. Gjatë intervistimit të kandidatëve, anëtarët e komisionit kanë vlerësuar me pikë, secilin kandidat në fletëvlerësimet e tyre, secili anëtar i komisionit ka pasur një fletë- vlerësim dhe poentimi ka qenë i fshehtë.

Gjatë vitit 2015, janë mbajtur mbledhjet si vijon:

- Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ka mbajtur 2 mbledhje.
- Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka mbajtur 3 mbledhje.
- Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, ka mbajtur 3 mbledhje.
- Komisionet ad-hoc kanë hartuar rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në organet e pavarura.

Tabela - Pasqyra e përgjithshme e punës së komisioneve gjatë vitit 2015

Aktivitetet:	2015	Totali
Mbledhjet e mbajtura	8	8
Kandidatët e propozuar për anëtarë	116	116
Rekomandimet e komisioneve	6	6

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015, është formuar Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, i cili komision është në procedurë për përzgjedhjen e kandidatëve.

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 14 dhjetor 2015, është formuar Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesave të Mediave, i cili komision është në procedurë për përzgjedhjen e kandidatëve.


Aktivitetet:	2015	Totali
Mbledhjet e mbajtura	/	/
Kandidatët e propozuar për anëtarë	32	2
Rekomandimet e komisioneve	/	/

Hulumtimet legjislative

Për mbështetjen e punës së komisioneve parlamentare dhe deputeteve individual, në procesin ligjvënës, shërbimi për hulumtime legjislative i Kuvendit, ka përgatitur tridhjetenëntë (39) hulumtime parlamentare.

Poashtu, me mbështetjen e USAID-të amerikan është duke u realizuar projekti “Përkrahje për Hulumtime Parlamentare dhe Përfshirje qytetare” ref: [RFA-167-14-000007](#), i cili implementohet nga KDI, bazuar në MM nënshkruar ndërmjet Kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli dhe Shefit të USAID-të në Kosove James Hope. Qellimi i këtij projekti të financuar nga USAID amerikan është rritja e pjesëmarrjes qytetare/shoqërisë civile, me kontribut substancial në agjendën legjislative të Kuvendit. Me përkrahjen e këtij projekti në mbështetje të punës së Komisioneve parlamentare gjatë vitit 2015, janë hartuar gjashtëmbëdhjetë (16) hulumtime, të cilat janë përgatitur nga hulumtues nga shoqëria civile (ekspert individual dhe OJQ).

Hulumtimet e përgatitura gjatë vitit 2015	Nr. hulumtimeve
Hulumtime të përgatitura nga Shërbimi për hulumtime legjislative i Kuvendit të Kosovës	39
Hulumtime të përgatitura nga Projekti i financuar nga USAID: hulumtues nga shoqëria civile (ekspertë individualë dhe OJQ)	16
Gjithsej:	55



Raportet preliminare

Për mbështetjen e punës së komisioneve parlamentare, në procesin ligjvënës, Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim ligjor ka hartuar pesëdhjetë e dy (52) raporte preliminare për përmbajtjen e projektligjit, harmonizimin me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, verifikimin e deklaratës së Ministrisë së Integritimit Evropian për përputhshmërinë e projektligjit me Legjislacionin e Bashkimit Evropian, për standardizimin formalo-juridik, aspektin e teknikës juridike, terminologjisë, standardizimit gjuhësor të tekstit në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze.

Hartimi i deklaratës së pajtueshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së për projektligjet e propozuara nga Kuvendi i Kosovës

Për mbështetjen e punës së komisioneve parlamentare Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim ligjor ka hartuar pesë (5) deklarata të pajtueshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në aktivitetet e Kuvendit dhe Komisioneve parlamentare

Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazohet në parimin e transparencës, llogaridhënies dhe qasshmërisë, parime këto të cilat ngërthejnë qasjen në dokumente publike. Kuvendi i Kosovës, gjatë vitit 2015 ka institucionalizuar partneritetin me shoqërinë civile përmes përgjegjësive të përbashkëta në çdo hap të procesit politik dhe vendimarrës në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave duke përfillur me: *“Deklaratën për Partneritet mes Kuvendit dhe Shoqërisë Civile Kuvendi dhe Deklaratën Globale për Transparencë”*.

Kuvendi i Kosovës, ka themeluar **Forum për Transparencë Parlamentare**, Vendimi 05-P-024, datë 4 maj 2015, që t’iu përgjigjet deklaratës së Kuvendit për partneritet me shoqëri civile dhe Deklaratës globale për hapje dhe transparencë e njohur si Deklarata për Transparencë.

Forumi për Transparencë Parlamentare, përbëhet nga deputetë, përfaqësues të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, ka për detyrë të kontribuoj në avancim dhe sigurojë anagzhimin më të madh qytetar duke promovuar kulturën parlamentare përmes informatave, çasjes në informata si dhe duke fuqizuar qytetarët në procesin legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies.

Komisionet parlamentare, gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre (mbledhje, dëgjime publike, takime të grupeve punuese, mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve), ka ftuar përfaqësuesit e shoqërisë civile për të marr pjesë në aktivitetet e komisioneve parlamentare.

Vlen të theksohet se ka pasur raste, edhe pse janë ftuar, përfaqësuesit e shoqërisë civile nuk kanë marr pjesë në aktivitetet e komisioneve parlamentare.

AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjatë viti 2015, Legjislaturës V, veprimtaria e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kuadër të marrëdhënieve me jashtë, ka qenë mjaft intensive, duke ngritur dhe forcuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndërparlamentare, në përputhje me synimet e institucioneve të Kosovës për integritet euro-atlantike, ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërparlamentare me vendet mike, thellimin e marrëdhënieve të mira me vendet e rajonit, zhvillimin e diplomacisë parlamentare dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërparlamentar me parlamentet e shteteve që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

AKTIVITETET E KRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, SH.T.Z. KADRI VESELI, DHE NËNKRYETARVE

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2015, vizita zyrtare të realizuara jashtë vendit të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, SH.T.Z. Kadri Veseli, janë: Pesë (5)

1. Prej dt. 09-11 Shkurt 2015, vizitë zyrtare në Shqipëri;
2. Prej dt. 15-20 Mars 2015, vizitë zyrtare në Panama;
3. Prej dt. 28 Prill – 03 Maj 2015, vizitë zyrtare në Strasbourg, Francë;
4. Prej dt. 22 – 24 Maj 2015, vizitë zyrtare në Shqipëri;
5. Prej dt. 08 – 10 Shtator 2015, vizitë zyrtare në Poloni.

Pritje/takime nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, me delegacione dhe zyrtarë të lartë ndërkombëtar: Njëqind e pesë (105)

Pritje/Takime me delegacione dhe zyrtarë të lartë ndërkombëtar nga Nënkryetaret e Kuvendit, Kryetarët e Komisioneve apo Deputetët: Tridhjetë e katër (34).

BASHKËPUNIMI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME PARLAMENTIN EVROPIAN

- Takimet e përbashkëta ndërparlamentare Parlamenti Evropian – Kosova: Një (1)

Prej dt. 28 Prill – 03 Maj 2015, në Strasbourg, Francë, është mbajtur takimi ndërparlamentar Parlamenti Evropian - Kosova i udhëhequr nga Kryetari i Kuvendi të Republikës së Kosovës, Sh. T. Z. Kadri Veseli në bashkëpunim me z. Tonino Picula, Kryesues i Delegacionit të Parlamentit Evropian me Bosnjë dhe Hecegovinën dhe Kosovën. Takimi u përmbyll me deklaratën e përbashkët të miratuar nga dy bashkë-udhëheqësit.

- Pjesëmarrja e delegacioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në aktivitetet e organizuara nga Parlamenti Evropian në: **Seminare – Konferenca: Tetë (8)**

Prej datës 04 - 06 shkurt 2015, u realizua pjesëmarrja në seminarin ndër-parlamentar, “**Siguria e energjisë, energjia efikase dhe ndërlidhja në Ballkanin Perëndimor**”, në Ankara, Turqi. Pjesëmarrës deputet nga Kuvendi i Kosovës ishin: Muhamet Mustafa, Visar Ymeri, Raif Qela, Pal Lekaj dhe nga administrata Armend Ademaj.

Prej datës 03 - 06 mars 2015, u realizua pjesëmarrja në konferencën dhe takimin ndër-parlamentar, “**Pjesëmarrja Politike e Grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi**” dhe “**Fuqizimi i grave dhe vazhdate përmes edukimit**”, në Bruksel, Belgjikë. Pjesëmarrës deputetet nga Kuvendi i Republikës

së Kosovës: Luljeta Veselaj-Gutaj, Alma Lama, Aida Dërguti dhe Mufera Sinik, nga administrata Merita Drenori.

Prej datës 22 - mars 2015, u realizua pjesëmarrja në seminarin ndërparlamentar me temë **“Zhvillimi i kulturës politike dhe rritja e dialogut politik për demokraci të qëndrueshme”**, në Bruksel, Belgjikë. Pjesëmarrës deputetët nga Kuvendi i Kosovës: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Nand Rasic, nga administrata Sekretari Ismet Krasniqi dhe Snoudon Daci.

Prej datës 24 - 25 shtator 2015, u realizua pjesëmarrja në seminarin ndërparlamentar me temë, **“Shërbimi Publik i Mediave dhe Parlamentet në Shtetet në Zgjerim”**, në Zagreb, Kroaci. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishin: Xhevahire Izmaku, Shqipe Pantina dhe nga administrata Drita Morina.

Prej datës 15 - 16 tetor 2015, u realizua konferenca ndër-parlamentare, **“Qeverisja Ekonomike dhe Krijimi i Vendeve të Punës në BE dhe në Vendet Kandidate Potenciale për Zgjemrim të BE-së”** Pjesëmarrës nga Kuvendi i Kosovës ishin: Muhamet Mustafa, Fatmir Rexhepi dhe Besim Haliti, zyrtar në mbështetje të delegacionit.

Me datë 22 tetor 2015, u realizua takimi i Kordinatorëve Nacional të Parlamentit Evropian në Bruksel. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ishte Shaban Selimi - Drejtor i DPMN-së.

Me datë 8 - 10 dhjetor 2015, u realizua seminari me temë, **“2013 Reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP): Implikimet për vendet e zgjerimit”**, në Bruksel. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishin: Fikrim Damka, Kryetar, Salih Salihu, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, nga administrata Ylber Sherifi.

- Pjesëmarrje në Programin Fellowship të Parlamentit Evropian dhe vendeve të Para – Anëtarësimit për zyrtarët e administratës së Kuvendit të Kosovës: **Një (1)**

- Pjesëmarrje në Takimin vjetor të Departamentit për Programe të Para-anëtarësimit - Parlamenti Evropian me Koordinatorë/Koordinatorët Nacional të vendeve të Para – Anëtarësimit (Ballkanit Përendimor dhe Turqisë): **Një (1)**

Ky takim i koordinatorëve/ koorospodentëve nacional të vendeve të Para – Anëtarësimit është mbajtur në Bruksel me dt. 22 Tetor 2015, për të diskutuar rreth aktiviteteve të përbashkëta dhe planit të punës së vitit 2016. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Kosovës ishte Shaban Selimi- Drejtor i Drejtorisë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

BASHKËPUNIMI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-SË

Gjatë punimeve të Sesionit Pranveror të Asamblesë Parlamentare të NATO-së, të mbajtur në Vilnius të Lituaniës nga data 29 maj - qershor 2014, është marrë vendimi zyrtar për ndryshimin e statusit të

Republikës së Kosovës nga statusi i mysafirit në **statusin e vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të NATO-së**.

Në punimet e këtij Sesionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-së, Kuvendi i Republikës së Kosovës është përfaqësuar nga Nënkrjetaro i Kuvendit të Republikës së Kosovës Xhavit Haliti, Kryesues i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-së.

- Pjesëmarrja e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Sesione të rregullta të Asamblesë Parlamentare të NATO-së: **Një (1)**

Sesioni Vjetor i 61-të, Stavanger, Norvegji 10-12 tetor 2016. Pjesëmarrës ishin: Xhavit Haliti, Slobodan Petrovic, dhe Tringa Lila nga administrata e Kuvendit.

- Pjesëmarrja e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Seminare Rose Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-së: **Dy (2)**

- Prej datës 31 mars - 2 Prill 2015, delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka marrë pjesë në Seminarin e 88 - të Rose Roth të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-së, në bashkëpunim me Parlamentin e Serbisë. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishin deputetet: Zenun Pajaziti, Nenad Rasic dhe nga administrata Tringa Lila.

- Prej datës 11 - 13 nëntor 2015, delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës mori pjesë në Seminarin e 90-të Rose Roth të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-së në bashkëpunim me Parlamentin e Moldavisë. Pjesëmarrës: Xhavit Haliti, dhe Slobodan Petrovic.

- Pjesëmarrja e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Takime/seminare të Komisioneve Parlamentare të NATO-së: **Një (1)**

Nga data 25-29 nëntor, 2015 është mbajtur takimi i përbashkët i Nën-Komisionit për Marrëdhënie Ekonomike dhe Transatlantike të AP të NATO-s, Firencë, Itali.

BASHKËPUNIMI I KUVENDIT TË KOSOVËS ME ASAMBLËNË PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS (AP- KE) DHE KE-se

Kuvendi i Republikës së Kosovës prej vitit 2011 është ftuar në cilësinë e mysafirit nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për pjesëmarrje në punimet e Sesioneve të Rregullta dhe takimet e Komisioneve Parlamentare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Me datë 15 Maj 2013, është pranuar njoftimi me shkrim nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës drejtuar ish - Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me

pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në takimet e AP të Këshillit të Evropës.

Gjithëashtu, byroja e Këshillit të Evropës ka marrë vendim që përfaqësuesit e Kuvendit të Republikës së Kosovës të marrin pjesë në të gjitha takimet e Komisioneve Parlamentare (*me të drejtë fjale dhe pa të drejtë vote*) me përjashtim të Komisionit për Monitorim dhe Komisionit për Rregulla Procedurale, Imunitete dhe Çështje Institucionale, si dhe mund të përcjellin punimet e seancave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (*pa të drejtë fjale dhe pa të drejtë vote*).

- Prej datës 5 - 7 Tetor 2015, është realizuar vizita në Kosovë e Agustin Conde, Raportues për Kosovën në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.
- Pjesëmarrja e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Sesione/Mbledhje të komisioneve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës: **Pesë (5)**

Prej datës 26 - 30 janar 2015, u realizua pjesëmarrja në Sesionin e Parë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg, Francë. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës: Enver Hoxhaj, Teuta Shatqija, Glauk Konjufca dhe nga administrata Shaban Selimi dhe Tringa Lila.

Prej datës 20 – 24 prill 2015, u realizua pjesëmarrja në Sesionin e Dytë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg, Francë. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, dhe nga administrata Shaban Selimi dhe Tringa Lila.

- Prej datës 3 - 06 qershor 2015, u realizua pjesëmarrja në takimin e Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Romë, Itali. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Kosovës ishin: Xhavit Haliti dhe Glauk Konjufca, nga administrata Snoudon Daci.

- Prej datës 1 - 5 nëntor 2015, u realizua pjesëmarrja në mbledhjen e Komisioneve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Paris, Francë. Pjesëmarrës ishin: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti si dhe Snoudon Daci nga administrata e Kuvendit.
- **Prej datës 6 - 8 Dhjetor 2015** në Bruksel është realizuar pjesëmarrja në punimet e Mbledhjes së Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të AP të Këshillit të Evropës. Pjesëmarrës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës : z. Xhavit Haliti, z. Ilir Deda dhe nga administrata Shaban Selimi.

**BASHKËPUNIMI I KUVENDIT TË KOSOVËS ME ASAMBLENË PARLAMENTARE TË
PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE AP PBEJL- (SEECF):
PESË (5)**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, mori ftesë nga Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë, për të marrë pjesë në takimin e Komisionit të Përgjithshëm për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim me Sigurinë në Asamblenë Parlamentare të SEECF-së, i cili u mbajt me 8 - 10 shkurt 2015. Pjesëmarrës ishin: Daut Haradinaj, Kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Merita Drenori, Zyrtare e lartë për Marrëdhënie Dypalëshe në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar me PBEJL- (SEECF).

Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk mori ftesë nga Rumania, për të marrë pjesë në Komisionin e Përgjithshëm për Zhvillimin Social, Edukimin, Kërkimin dhe Shkencën, mbajtur nga data 26 - 27 shkurt 2015, me arsyetimin se pjesëmarrja e përhershme e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionet Përgjithshme duhet të vendoset me votim në Sesionin Parlamentar të Kryetarëve të Kuvendeve të SEECF-së, që pritej të mbahet në Tiranë (me datë 22 maj 2015).

Kuvendi i Republikës së Kosovës, mori ftesë nga Parlamenti i Republikës së Bullgarisë për të marrë pjesë në punimet e Komisionit të Përgjithshëm për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energji, të cilat u mbajtën në Sofje, me datë 21 - 22 mars 2015. Pjesëmarrës në këtë delegacion ishin: Muhamet Mustafa, Kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe nga administrata Merita Drenori.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, është ftuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në Grupin Punues të SEECF-së, si dhe në Komisionin e Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të SEECF-së, me datë 16 - 18 prill 2015. Pjesëmarrës në këtë delegacion ishin Blerta Deliu, deputete dhe nga administrata Merita Drenori.

Me datë 22 - 23 maj 2015 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë organizoi seancën plenare si Kryesuese e radhës e Asamblesë Parlamentare të SEECF- së. Ftesë zyrtare për pjesëmarrje mori Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Z. Kadri Veseli, nga Sh.T.Z. Ilir Meta. Në këtë seancë, siç edhe u prit, shtetet pjesëmarrëse të SEECF-së nxorën Deklaratën e Seancës Plenare për vitin 2015, në të cilën përfshihej edhe anëtarësimi i Kosovës në AP të SEECF-së. Me mbështetjen e plotë të Shqipërisë, dhe me përpjekje të mëdha paraprake që bëri Kuvendi i Republikës së Kosovës¹⁹, në bazë të Deklaratës se nxjerrë nga Seanca Plenare e 23 majit 2015, pika

¹⁹ Duke pasur parasysh që anëtare të SEECF-së janë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, siç janë Serbia, Greqia, Rumania, Bosnjë e Hercegovina, para seancës së majit 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës Shkëlqesia e Tij, Z. Kadri Veseli, përmes një shkrese drejtuar znj. Frederica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, i ka kërkuar asaj që të ushtroj ndikim tek vendet pjesëmarrëse të SEECF-së, për të mos e penguar anëtarësimin e Kosovës në SEECF. Poashtu, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës Sh.T.Z. Kadri Veseli ka bërë kërkesë zyrtare për anëtarësim të Kosovës në SEECF, me datë 25 mars 2015, të cilën ia ka adresuar Sh.T. Z. Ilir Meta, Kryesues i radhës i Asamblesë Parlamentare të SEECF-së.

10 e saj, Kosova u bë anëtare e plotë e AP të SEECP-së.

Pika 10: “Duke pasur parasysh përkushtimin ndaj parimit të "gjithë përfshirjes", i shprehur në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të SEECP-së në Ohër, në maj të vitit 2013, si një element i rëndësishëm i stabilitetit rajonal dhe zhvillimit afatgjatë, dhe duke pranuar Deklaratën nga Samiti i Kryetarëve dhe Qeverive të shteteve pjesëmarrëse të SEECP –së (Bukureshtit, qershor 2014) të cilat vendosen “të ftojnë Kosovën* për të marrë pjesë në mënyrë të përhershme në aktivitetet dhe takimet e SEECP-së, në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta, në të cilën deklarohet se "Karta e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës së Juglindore duhet të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me rrethanat në mënyrë që të lejojë pjesëmarrjen e Kosovës (e shënuar me fusnotë) në aktivitetet dhe takimet e SEECP-së, në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta " (**AP e SEECP-së ‘Deklarata e Seancës Plenare për vitin 2015, Pika 10-të’, (Tiranë, 23 maj 2015).**

¹ Sipas rregullores së punës së SEECP-së, vendimet në SEECP merren me konsensus të plotë nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

Mbledhje të Komisioneve të Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit të Evropës Jug Lindore (APBEJL ose SEECP)

Prej datës 5 - 7 nëntor 2015, u realizua konferenca ndërkombëtare me temë “Sinergjitë Rajonale, Bashkëpunimi Strategjik dhe Diplomacia Parlamentare” Pjesëmarrës në konferencë ishin: Besim Beqaj dhe Muhamet Mustafa, në shoqërim të delegacionit nga administrata Armend Adema.

TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2015, në kuadër të angazhimeve të saj të rregullt i ka kushtuar një kujdes të veçantë informimit të publikut të gjerë për të gjitha aktivitetet në fushën legjislative të Kuvendit, si dhe proceset e ngjarjet që janë zhvilluar në Kuvend.

Hartimi dhe shpërndarja e informacioneve për aktivitetet e Kuvendit të Kosovës

Punonjësit e kësaj drejtorie, rregullisht dhe në kohë të duhur, ua ka shpërndarë mediave të shkruara dhe atyre elektronike, paralajmërimet për aktivitetet dhe ngjarjet e pritura në Kuvend. Ata njëkohësisht kanë hartuar informacione për ngjarjet në Kuvend, si: mbledhjet e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës, mbledhjet e Kryesisë, vizitat e Kryeparlamentarit, të anëtarëve të Kryesisë, deputetëve të komisioneve të Kuvendit, për mbledhjet dhe dëgjimet publike të këtyre komisioneve, për aktivitetet e Grupit të Grave Deputete, si dhe ngjarjet të tjera nga fushëveprimtaria e Kuvendit. Informacionet e hartuar u janë shpërndarë mediave të akredituara në Kuvendin e Kosovës, OJQ-ve dhe të interesuarve të tjerë.

Publikimet në Ueb-faqen e Kuvendit

Gjatë vitit 2015 në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës, janë publikuar 972 lajme e raporte më të gjera, pjesa dërrmuese e të cilave iu ka dërguar edhe mediave, si dhe janë publikuar 19 fjalime të kryekuvendarit.

Në ueb-faqen e Kuvendit publikohen, të dhënat (biografite) e deputetëve, të dhënat e grupeve parlamentare, të dhënat e komisioneve, transkriptet nga seancat plenare, procesverbalet nga mbledhjet e Kryesisë, procesverbalet nga mbledhjet e komisioneve të Kuvendit, botimet e revistës “Kuvendi”, si dhe të gjitha dokumentet e tjera, si: rezolutat, memorandumet, deklaratat, raportet vjetore, programet e punës, udhëzimet, rezultatet e punës, vendimet dhe materialet e tjera.

Në ueb-faqen e Kuvendit publikohen projektligjet që vijnë në Kuvend për miratim, ligjet e miratuara nga Kuvendi, si dhe rezultati i votimit elektronik në Kuvend (kush si ka votuar) për ligjin e dhënë apo ndonjë çështje tjetër me rëndësi.

Akreditimi i mediave për të ndjekur punën e Kuvendit

Një segment i rëndësishëm i punës së zyrtarëve të Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, gjithsesi ka qenë bashkëpunimi dhe kontakti me gazetarët, fotoreporterët dhe xhiruesit e mediave të shkruara dhe elektronike nga vendi dhe bota.

Gjatë vitit 2015, Kuvendi i ka dhënë akreditim njëvjeçar 308 përfaqësuesve të mediave: gazetarë, fotoreporterë dhe xhirues, të cilët kanë ndjekur aktivitetet e zhvilluara në Kuvend, si dhe ka lëshuar dhjetëra akreditime njëditore, për shkak të interesimit shumë të madhe të mediave për të përcjellë zhvillimet në Kuvend, sidomos gjatë Sesionit vjeshtor.

Publikimi i revistës “Kuvendi”

Drejtorja për media dhe Marrëdhënie me Publikun, ka vazhduar publikimin e revistës “Kuvendi” në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. Kurse, është publikuar edhe një numër i revistës me alfabetin e Brajlit (për të verbër) në gjuhën shqipe dhe serbe.

Vizitat e qytetarëve në Kuvend gjatë vitit 2015 (189 grupe të ndryshme vizitorësh me mbi 3242 vizitorë).

Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2015 në funksion të rritjes së transparencës para publikut, ka ngritur pjesëmarrjen qytetare në jetën parlamentare.

Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me publikun ka vazhduar të lehtësojë qasjen e qytetarëve në punën e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, duke mundësuar vizita të shumta të grupeve të ndryshme në mjediset e Kuvendit dhe takime me deputetë. Dhjetëra grupe qytetarësh janë pritur në takime të veçanta nga Kryetari i Kuvendit z. Kadri Veseli, duke krijuar një standard të ri në komunikimin e drejtpërdrejtë të bartësve të përgjegjësive shtetërore me publikun e gjerë.

Kështu, gjatë vitit 2015, Kuvendin e Republikës së Kosovës, e kanë vizituar 189 grupe të ndryshme vizitorësh, të vendit e të huaj, të grup-moshave dhe etnive të ndryshme, apo me shifra mbi 3242 vizitorë. Përveç vizitave të përditshme dhe shënimit, tashmë tradicional, të Ditës së Demokracisë, kur Kuvendi hap dyert për të gjithë qytetarët dhe organizon aktivitete të ndryshme, një rëndësi të veçantë Kuvendi i ka kushtuar 1 Qershorit – Ditës së Fëmijëve, duke hapur dyert për qindra fëmijë dhe nxënës nga qendra të ndryshme të Kosovës.

Po me vizita të tilla Kuvendi ka shënuar edhe 5 Qershorin – Ditën e Ambientit, ndërsa, gjatë verës ka organizuar, për herë të parë aktivitetin “Mërgimtarët në Kuvend”, duke qëndruar i hapur për dy ditë rresht, për të gjithë mërgimtarët të cilin kishin shprehur interesimin e tyre për të vizituar ndërtesën e Kuvendit.

Qasje në dokumente publike

Si rëndom, edhe gjatë vitit 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka kushtuar rëndësi të veçantë zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike. Gjatë periudhës 12-mujore, Kuvendit i janë adresuar gjashtë (6) kërkesa për qasje në dokumente publike. Në të gjitha kërkesat, Kuvendi është përgjigjur pozitivisht dhe brenda afatit ligjor, me përjashtim të njëjës prej tyre, e cila për shkak të paqartësive, ka mbetur pa përgjigje.

Të dhënat lidhur me kërkesat:

Tabela nr. 1

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
6	5	1	

Tabela nr. 2

Qasja e lejuar	Numri
Në afat, sipas ligjit	5
Me pagesë	
Pa pagesë	5

Tabela nr. 3

Qasja e refuzuar	Numri
E plotë	
E pjesshme	
Pa përgjigje	1

Tabela nr. 4

Kërkesat për rishqyrtim	Numri
<u>Numri total i rishqyrtimeve</u>	0
E lejuar	
E refuzuar	
E pjesshme	

Tabela nr. 5

Numri i aktvendimeve të lëshuara për refuzim: 0

Refuzimet dhe qasjet e kufizuara	Numri
----------------------------------	-------

1. Përfshirjet nga neni 12 :	
(specifikoni cila pikë, nga lista e mëposhtme)	
1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;	
1.2. sigurisë publike;	
1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;	
1.4. hulumtimeve disiplinore;	
1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;	
1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;	
1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;	
1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;	
1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;	
1.10. mjedisit, apo,	
1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.	
2. Neni 10. (Pa përgjigje)	
3. Dokumentet e klasifikuara	
4. Të dhënat personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	
5. Arsye tjera të refuzimeve, (ju lutem specifikoni)	

Kërkesat dhe përgjigjet

Tabela nr. 6

Kërkesat e paraqitura	Numri
Në mënyrë elektronike	6
Kopje fizike	
Elektronike dhe kopje fizike	

Tabela nr. 7

Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	Numri
Në mënyrë elektronike	4
Kopje në letër	1
Elektronike dhe kopje	
CD	

Profili i aplikuesve dhe dokumentet e kërkuara

Tabela nr. 8

Profili	Numri

Gazetarë	1
Shoqëri civile	1
Organizata buxhetore	
Individë	1
Studentë	3
Parti politike	
Tjera (specifiko)	

Tabela nr 9

Dokumenti	Numri
Buxhet, shpenzime	1
Vendime	
Projektligje	4
Statistika	
Kontrata	
Projekte	
Konkurse	
Raport vlerësimi	1

RAPORTI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN 2015

Raporti i buxhetit për viti 2015 sipas Ligjit nr. 05-L-001, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-046 për vitin 2015 për programet 1 .Deputetët e Kuvendit, 2. Administrata e Kuvendit, dhe 3. Stafi mbështetës politik. Shpenzimet për vitin 2015 për tri programet e lartcekura janë 7,951,987.42€

Në tabelën e mëposhtme paraqitet buxheti vjetor sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2015 nr. 05/L-001, buxhetin e ndryshuar me rishikim (Ligji 05/L-046) dhe buxhetin përfundimtar në SIMFK, ku do të japim edhe sqarimet e nevojshme për ndarjet.

Raport buxheti

	Buxheti vjetor	Buxheti i rishikuar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet	Progresi vjetor
Përshkrimi	Ligji nr. 05/L-001	Ligji nr. 05/L - 046	SIMFK		%
	a	b	c	d	f=d/c
Gjithsej	8,731,365	8,643,440.77	8,361,474.94	7,951,987.42	95.10%
Pagat dhe mëditjet	6,398,365	6,250,641.77	6,060,091.32	6,060,091.32	100%

Mallrat dhe shërbimet	1,758,000	1,578,759.00	1,534,146.18	1,124,772.46	73.31%
Shpenzimet komunale	221,000	241,000.00	180,322.44	180,279.57	99.98%
Subvencione dhe transfere	30,000	100,000.00	120,000.00	120,000.00	100%
Shpenzimet kapitale			466,915,00		99.98%
	324.000,00	473,040.00		466,844.07	

Nga tabela e mësipërme shihet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit 05/L-001 , buxheti i rishikuar sipas ligjit 05/L-046, buxheti përfundimtar në SIMFK, shpenzimet e bëra si dhe raporti në mes shpenzimeve dhe buxhetit përfundimtar nëSIMFK. Raporti në mes të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor në SIMFK tregon një shpenzim të buxhetit për 95.10 %.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet raporti i buxhetit dhe shpenzimeve sipas programeve

Përshkrimi	Buxheti përfundimtar SIMFK	Deputetët e Kuvendit (Shpenzimet)	Administrata e Kuvendit (Shpenzimet)	Stafi mbështetës politik(shpenzimet)	Totali i Shpenzimeve
	a	b	c	d	e=b+c+d
Gjithsej	8,361,474.94	4,146,325.68	3,272,253.13	481,454.59	7,951,987.42
Pagat dhe mëditjet	6,060,091.32				6,060,091.32
Mallrat dhe shërbimet	1,534,146.18	3,641,010.54	1,937,626.19	340.511,74	1,124,772.46
Shpenzimet komunale	180,322.44	385,315.14	687,503.30	51,954.02	180,279.57
Subvencione dhe transfere	120,000.00		180,279.57		120,000.00
Investimet kapitale	466,915,00	120,000.00			466,844.07

Në kolonën “a” paraqitet buxheti i përfundimtar në SIMFK, ne kolonat “b,c,d”, paraqiten shpenzimet sipas programeve dhe kolona e paraqet shpenzimin total për të gjitha programet .

Ndersa, në mënyrë të hollësishme për secilin program, buxhetin dhe shpenzimet, paraqiten në tabelat në vijim.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Deputetët e Kuvendit

	Buxheti	Buxheti i rishikuar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet	Progresi vjetor
Përshkrimi	Ligji nr. 05/L-001	Ligji 05/L-046	SIMFK		%
	a	b	c	d	e=d/c
Pagat dhe mëditjet	3,701,755	3,812,624.95	3,641,010.54	3,641,010.54	100%
Mallrat dhe shërbimet	565,000	523,982.00	483,982.00	385,315.14	79.62%

Subvencione	30,000	100,000.00	120,000.00	120,000.00	100%
Gjithsej	4,296,755	4,436,606.95	4,244,992.54	4,146,325.68	97.67%

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin e rishikuar sipas ligjit 05/L-046, në kolonën **c** shofim buxhetin përfundimtar në SIMFK, ndërsa në kolonën **d** paraqiten shpenzimet vjetore.

Raporti në mes të shpenzimeve të bëra gjatë vitit 2015 dhe buxhetit përfundimtar tregon një shpenzim të buxhetit për **97.67%**.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Administrata e Kuvendit

	Buxheti vjetor	Buxheti i rishikuar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet	Progresi nëntëmujor
Përshkrimi	Ligji nr. 05/L-001	Ligji 05/L-046	SIMFK		%
	<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	e = d/c
Pagat dhe mëditjet	2,084,410	1,838,017	1,937,626.19	1,937,626.19	100%
Mallrat dhe shërbimet	1,145,000	994,777	994,442.28	687,503.30	69.13%
Shpenzime komunale	221,000	241,000	180,322.44	180,279.57	99.98%
Investime Kapitale	324,000	473,040	466,915	466,844.07	99.98%
Gjithsej	3,774,410	3,546,834	3,274,067.17	3,272,253.13	91.42%

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin e rishikuar sipas ligjit 05/L-046, në kolonën **c** shofim buxhetin përfundimtar në SIMFK, ndërsa në kolonën **d** paraqiten shpenzimet vjetore.

Raporti në mes të shpenzimeve të bëra gjatë vitit 2015 dhe buxhetit përfundimtar tregon një shpenzim të buxhetit për **91.42%**.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Staf mbështetës politik

	Buxheti vjetor	Buxheti i rishikuar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet	Progresi vjetor
Përshkrimi	Ligji nr. 05/L-001	Ligji nr. 05/L-046	SIMFK		
	<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	e = d/c
Pagat dhe mëditjet	612,200	600,000	481,454.59	481,454.59	100%
Mallrat dhe shërbimet	48,000	60,000	55,721.90	51,954.02	93.24%
Gjithsej	660,200	660,000	537,176.49	533,408.61	99.30%

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin e rishikuar sipas ligjit 05/L-046, në kolonën **c** shohim buxhetin përfundimtar në SIMFK, ndërsa në kolonën **d** paraqiten shpenzimet vjetore.

Raporti në mes të shpenzimeve të bëra gjatë vitit 2015 dhe buxhetit përfundimtar tregon një shpenzim të buxhetit për **99.30%**.

TË DHËNAT PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN E KUVENDIT TË KOSOVËS NË LEGJISLATURËN V-TË, VITI 2015

Puna e Kuvendit të Kosovës mbështetet nga Administrata e Kuvendit, e cila ofron shërbime profesionale, si dhe shërbime tekniko – administrative për nevojat e Kuvendit dhe organeve që veprojnë në kuadër të tij. Të gjithë këta të punësuar, duke filluar nga Sekretari i Kuvendit, si zyrtari më i lartë, janë nëpunës civilë të trajtuar sipas Ligjit të Shërbimit Civil.

Të dhënat për të punësuarit në Legjislaturën V, viti 2015 është:

<i>Viti</i>	<i>Të pranuar:</i>	<i>Të larguar:</i>	<i>Të pensionuar:</i>
2015	6	0	5

Numri i përgjithshëm i të punësuarve si shërbyes civilë në Administratën e Kuvendit të Kosovës, është 172.

RAPORTI I PROKURIMIT TË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË VITIN 2015

Furnizimi me material për mirëmbajtjen e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës Lot-2: Material sanitarie	4,433.50 €
Furnizimi i bllokave me logo të Kuvendit	300.00 €
Furnizimi me tonerë për printerë	2,106.00 €
Mbikëqyrja e punëve të projektit Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës	2,624.00 €
Lot-1 - servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve VW touareg dhe shkodra rapid	21,000.00 €
Lot-2 - servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit mitsubish	18,000.00 €
Lot-3 - servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit toyota	42,000.00 €
Lot-4 - servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të llojit landrover	9,000.00 €

Furnizimi ujë të pijshëm (për aparate) për Kuvendin e Republikës së Kosovës	30,700.00 €
Furnizimi, servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit në Kuvendin e Republikës së Kosovës	3,000.00 €
Furnizimi i raftit prej qelqi për Kuvendin e Republikës së Kosovës	176.90 €
Shtypja dhe dizajnimi i Revistës "Kuvendi"	18,570.00 €
Përzgjedhja e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave të ZAP-it për vitin 2014	2,300.00 €
Mirëmbajtja e rregullt, ndërrimi i tonerëve dhe i pjesëve harxhuese për aparatet fotokopjuese të tipit Nashuatec-Ricoh në Kuvendin e Kosovës	12,795.00 €
Furnizimi me dhurata për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës	900.00 €
Pastrimi gjeneral (brenda) i automjeteve të Kuvendit	542.00
Furnizimi me goma vere për automjete në Kuvendin e Republikës së Kosovës	3,000.00 €
Liferimi, testimi dhe implementimi në tërësi i sistemit me pajisje portative (mobile) për qasje dhe punë në distancë për nevoja të deputetëve të Kuvendit të Kosovës	87,960.00 €
Sigurime shëndetësore në udhëtim për deputetët, stafin politik dhe administratën e Kuvendit të Kosovës	5,100.00 €
Blerja e orëve të dorës për zyrtarë të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës	792.00 €
Shërbime të udhëtimit me autobus për Shqipëri	798.00 €
Shërbime të udhëtimit me autobus për 1 Qershor	995.00 €
Ftesa dhe zarfe me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës	2,000.00 €
Mirëmbajtja mujore dhe servisimi i liftave në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	20,000.00 €
Blerja e vëllimeve të Monografisë "Feniksët e Lirisë"	900.00 €
Furnizimi me material promovues për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës	930.00 €
Furnizimi dhe montimi i rafteve metalike për arkivin e Kuvendit të Republikës së Kosovës	1,860.00 €
Furnizimi dhe montimi i fst 33 (fankollera) me regjim ftohje/ngrohje	3,948.00 €
Furnizim me paketa të kartonit për bartjen e dokumentacionit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	630.00 €
Mirëmbajtja dhe përkrahja e softuerit për buxhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës	6,300.00 €
Furnizimi me dhurata për nevoja të protokollit	6,070.00 €

Dita Ndërkombëtare e Demokracisë Lot - 2 : Sigurimi i tendave dhe realizimi i aktivitetit tjetër promovues	6,950.00 €
Dita Ndërkombëtare e Demokracisë transportit të nxënësve	Lot- 1: Sigurimi i 1,220.00 €
Furnizimi me pajisje digjitale për sallat konferencave N205, N409 dhe kabinet	99,931.10 €
Furnizimi me pajisje multimediale dhe pajisje për evidencën hyrje/dalje	4,388.80 €
Shërbime të transportit për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës	404.25 €
Furnizimi me shtyp ditor, për Kuvendin e Republikës së Kosovës	5,000.00 €
Furnizimi me pajisje për evidencën hyrje/dalje	1,986.50 €
Furnizimi dhe montimi i rollo perdeve	800.75 €
Furnizimi dhe montimi i pjesëve për hapje-mbyllje të dyerve me qasje të kontrolluar	993.55 €
Shërbime të transportit me autobus për Shqipëri	820.00 €
Botimi i revistës “Kuvendi” në alfabetin Braj (braille)	975.80 €
Furnizimi me pajisje për evidencën e hyrje/daljes	1,974.90 €
Furnizim me material për zyre-material pastrues për pajisje të TI-së për Kuvendin e Kosovës	975.55 €
Furnizimi me kompresor të ajrit të për nevojat e transportit	968.00 €
Furnizimi me Pano për Kuvendin e Republikës së Kosovës	493.78 €
Furnizimi me librin "Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare"	1,919.50 €
TOTALI:	439,532.88 €

Shënim: Kontratat me ngjyrë të kuqe janë ndërprerë pas nënshkrimit të tyre (nuk janë realizuar).

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RAPORTI PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN 2015

LEGJISLATURA V

**PËRGADITUR NGA:
DREJTORIA PËR HULUMTIME, BIBLIOTEKË DHE ARKIV
KUVENDI I KOSOVËS**